

BIBLIOTEKA

804-2
L 14

Teodor Laço

Qyteti i akuzuar

Një det helmi



SSH-2

L 14

Teodor Laço

Qyteti i akuzuar Një det helmi

Drama



Botimet TOENA

Tiranë, 1996

Parafjalë për "Qyteti i akuzuar"

Në fillim të vitit 1982, teatri i Fierit ku punoja prej 7 vjetësh, pas atij "qarkullimi" të detyruar nga Lidhja e Shkrimtarëve, që s'ishte gjë tjetër veçse një formë e lazdruar e dëbimeve, gjendej ngushtë me repertor dhe unë si libretist i tij, diçka duhej të bëja. Deri atëherë i kisha dhënë atij teatri katër pjesë teatrale, po vetëm "Gjëmimi i atij dimri" me regji të Dhimitër Pecanit, kishte patur një sukses të vërtetë, të tjerat kishin folur me gjysmë zëri. Isha krejt i zbrazët dhe mendova se do të ishte më lehtë të dramatizoja ndonjë vepër nga letërsia e Kosovës. Kishin ndodhur demonstratat e përgjakshme dhe kudo kishte një ndjenjë ankthi, kureshtjeje e admirimi për Kosovën, siç nuk besoj të ketë qenë kurrë ndonjëherë.

Lexova "Fëmijët e lumit tim" të Hivzi Sulejmanit, "Toka e Përgjakur" të Nazmi Rrahmanit dhe "Plagët" të Murat Isakut.

Më tërhiqte romani i H. Sulejmanit. Aty shtrohej problemi i demokracisë dhe i dhunës, lindja e një shtrese autokratike në socializëm që tradhton idealet e luftës dhe kundër tyre, një prokuror, i cili nuk e pranon këtë tjetërsim. A. Istrefi dhe A. Gjakova më thanë se romani ka shumë elementë autobiografikë. Por nuk isha i sigurtë në do të "gëlltitej" si dramë. Ndryshe nga romani, veprat skenike kanë rezonanca të çuditshme dhe syri vigjilent për to ishte ku e ku më i mprehtë. Kështu pra, "larg sherrit", kam shënuar në ditarin tim. Zgjodha "Plagët" të M. Isakut, një roman me nota romantike, por me karaktere të skalitura.

Vajta në shtëpinë e pushimit në Vlorë, në fillim të marsit për të qenë i vetëm, por doli se aty më njihnin shumica e pushuesve. Ishte edhe Moisi Zaloshnja si dhe dy a tre "kuadro" afër nivelit të

lartë, që rrinin mjaft fodullë e të pashoqërueshëm me grupin gazmor të të rinjve. Ata më dhanë “lëndë” për një tregim që e botova më vonë me titullin “Ftesë për shah”.

Ndërsa shkruaja dramën sipas “Plagët”, mendja më bridhte në një mënyrë gati obsesive tek një dramë tjetër, e cila po konturohej brenda meje çdo ditë e më shumë. Kjo do të ishte një dramë për Kosovën, pa Kosovën. Përndryshe, nëse do të flisje drejtpërdrejt, s’kishte asnjë shans të vihej në skenë. Fakti dramatik ishte përmendur kalimthi në shtyp. Në Mitrovicë ishte zhdukur pllaka prej bronz, që u vu në hyrje të qytetit me emrin e ri “Titovska Mitrovica”. Forma e dramës, - një hetim . Arrestohet poeti, shoferi, fshatari.

Kjo do të ishte një simbolikë e dyfishtë. E para - si leje kalimi do të ishte çështja nacionale në vendet ku jetojnë kombësi të përziera (të drejtat e tyre për gjuhët, zakonet, ritet, botën shpirtërore në përgjithësi) dhe e dyta si nënshtresë , kundërshtimi i dhunës dhe i diktaturës në përgjithësi që do të pasqyrohej me zhdukjen e bustit të një strategu ushtarak të cilit i atribuohet merita e bashkimit të këtij qyteti me mbretërinë. Natyrisht në subkoshiencën time, pllaka e Mitrovicës s’mund të pluskonte ndryshe, veçse si një bust njeriu, sepse figura zgjon te shpirti i njeriut një protestë shumë herë më të madhe se sa një emër i shkruar mbi bronz.

Kështu zuri të ngjizej “Qyteti i akuzuar”. Duke udhëtuar për në Kaninë, ia tregova subjektin Shefqet Tiganit. Ai është me origjinë kosovare. Mbeti i befasuar. Më tha se kjo është gjetja ime më e mirë dramaturgjike. Një vit më vonë, në mars ’83 gati isha ftohur prej saj me përdhunë. Ia kisha premtuar teatrit të Korçës dhe subjektin ia bëra të njohur me letër njeriut - censor të rrethit që vetëkuptohet, ishte sekretari i propagandës i Komitetit të Partisë, një bashkënxënës imi i vjetër, i cili s’di pse qe ngritur në atë rang. Ishte një njeri me pamje të butë, por që sigurisht i dinte mirë kompetencat e veta. M’u përgjigj se për arsye koniunkturale, këto lloj veprash zor se mund të botohen, ose të vihen në skenë. Ishte si një rrebesh në një ditë vere. Iu riktheva tharmit të komedisë “Shi

në plazh” që gjithashtu më vinte në ngasje. Megjithatë, “Qyteti” s’më linte të qetë. Në mesin e shkurtit ’84, në ditarin tim kam shkruar: “Mbarova dramën “Qyteti i akuzuar”. Jam i kënaqur nga ajo që kam bërë, ndonëse fati i kësaj pjese është krejt i papërcaktuar. Të parët që e lexuan, miqtë e mi P. Kulla, L. Bungo, R. Pulaha, Xhavit Abazi e Ilir Bezhani, më folën mirë”.

Në qershor e kishin lexuar dy-tre trupa. Më të guximshëm u shfaqën durrësakët. Vangjel Heba, mori përsipër të nxirrte “lejen” nga “Olimpi”, por përgjigjia erdhi se i plotfuqishmi i marrëdhënieve ndërkombëtare S. Lazri, nuk ishte dakord, gjithë për arsye “koniunkturale”. Megjithatë ishte prapë Korça dhe regjisori Dh. Orgocka që e morën përsipër vënien në skenë. Premiera u dha të enjten e parë të nëntorit.

Por sukcesi i vërtetë ishte shfaqja e së dielës, të cilën e ndoqën edhe mjaft kolegë të mi nga Tirana. Kanë qenë disa nga ditët më të ethshme të jetës sime. Në llozhë rrinin autoritetet e rrethit e të Tiranës. Unë e ndiqja shfaqjen nga radha tetë, me time shoqe, djalin e vogël dhe me Xhuvanin e N. Lerën pranë. Ndihesha i dërrmuar, apatik dhe nervoz njëherit, një nga mpleksjet më të pamundura. Në një çast i thashë Nasit:” Mos shkruaj dramë kurrë në s’do të shkatërroresh emocionalisht”. Kurse ai, duke parë reagimet e sallës, tha :” Tani do të shkruaj me siguri”. Pastaj u mbylla në dhomë dhe lexova deri vonë “Lëkura” të Malapartes.

Në konkursin e atij viti, “Qyteti”- fiton çmimin e parë, por sërish jo pa peripeci. Unë isha kandidat për çmime edhe me komedinë “Shiu...” edhe në përmbledhje tregimesh. Meqë, sipas rregullores së atij viti, s’mund të jepej më shumë se një çmim, m’u ofrua të zgjidhja “Shiu...”. Nga miku im V. Koreshi e dija se edhe në dramë “Qyteti...” ishte propozuar për çmim. Ngula këmbë duke hedhur në lojë zarin e fundit: ose “Qyteti”, ose mos më jepni asnjë çmim.

Pas kësaj u duk sikur dramës iu hap drita jeshile , mirëpo s’qe e thënë. Një transmetim radiofonik, i dëgjuar s’di se prej kujt, ngriti sërish problemin e koniunkturave me Jugosllavinë. (Dhe thonë pastaj se kemi bërë ”diplomaci” të pavarur). Botimi në “N. Frashëri”

u ndërpre, drama e filmuar u mbyll në arkiv. "Mbase vjen ndonjë kohë që kjo dramë na shërben shumë", - më ngushëllonin drejtuesit e atëhershëm të RTV.

Duhej të kalonin disa vjet, të shembej monumenti i E.Hoxhës që drama e filmuar të delte nga arkivi. Nga të gjitha mbresat pas transmetimit, nuk më është shuar biseda me një grua të thjeshtë, shitëse në lagjen tonë: "Kur e shkrojte kaq shpejt ti", - tha ajo. "Jo, është pjesë e vjetër" - i thashë. "Ah, po si është e mundur që e parashikove se monumentin e atij qelbësirës do ta rrëzonin?". E kishte kuptuar alegorinë e dramës sipas mënyrës së saj, por ndoshta zhdukja e bustit të një njeriu që e urrejnë në dramë bënte një farë rezonance me kohën e përmbysjeve të mëdha të vitit 1991.

Më pas drama u shfaq edhe dy- tri herë në TV, u vu në skenë në Maqedoni nga një trupë shqiptare e qytetit të Kërçovës, megjithatë teksti i saj s'është botuar asnjëherë.

Ky është botimi i parë dhe unë i jam mirënjohës botuesit të saj, i cili guxon të botojë letërsi dramatike duke e ditur paraprakisht se këto lloj librash nuk hyjnë te grupi i komercit.

Autori

Tiranë më 14 shkurt 1996

Teodor Laço

QYTETI I AKUZUAR

Dramë

Tiranë 1984 -1991

Personazhet

Poeti

Shoferi i autovinçit

Babai i shoferit

E fejuara e shoferit

Mësuesja

Djali i mësueses

Inxhinieri plak

Nëpunësja

Mekaniku i garazhit

Studenti

Fshatari

Dy të papunë

Kryetari i qytetit

Hetuesi nga kryeqyteti

Kapiteni i policisë

Ndihmësi i kapitenit

Roja e garazhit

Sekretarja

Kronisti i televizionit

Gazetari i gazetës qendrore

Mjeku ligjor i burgut

Kameramani

Policë

Ngjarjet zhvillohen në një vend e kohë të papërcaktuar.

Pjesa e parë

Epilog

Poeti:

Shikues të dashur, ju ndoshta e keni dëgjuar legjendën për një fis njerëzish që adhuronin mjellmën. Këtij zogu të bukur, ata i faleshin e i këndonin këngë, figurën e saj e gdhendnin në gurë e në drurë.

Pastaj erdhi një kohë e egër dhe ata u gjendën të pushtuar prej një fisi barbar. Shërbyesit e kultit të këtij fisi, pasi thyen e dogjën të gjithë veprat e artit me simbolin e mjellmës, shpallën dënimin me vdekje për ata që dhe më tej do t'i thurnin vjersha e do ta qëndisnin nëpër teshat e trupit.

Pas këtij terrori, u duk sikur fisi e harroi mjellmën e tij. Kishte rrjedhur koha dhe këtë harresë barbarët e morën si një shenjë të mirë se po zhdukej vetë fisi, kryeneç e rebel.

Por një ditë, në gjoksin e zbuluar të një fëmije, ata panë figurën e mjellmës, shpuar me gjilpërë. U bënë hetime të hollësishme, dhe befasi u zbulua se prej kohërash që s'mbaheshin mend, banorët e fisit të vogël kishin krijuar një rit tjetër, vizatimin e mjellmës në gjoks.

Legjenda mbi shpendin e qytetit tim fillon kështu:

Na ishte një qytet i largët, që për disa teka të historisë, kishte mbetur brenda një mbretërie të madhe. Me mund e sakrificë, qyteti arriti të ngrinte në hyrje të tij, skulpturën monumentale të një shpendi të bukur që e adhuronin të parët e tij. Ky simbol ishte një nga dëshmitë e kulturës

se tij të lashtë

Një ditë erdhën disa arkitektë nga kryeqyteti i mbretërisë. Ata thanë se monumenti i shpendit ishte aq i dëmtuar e i ronitur nga vjetërsia, sa mund të shembej e të rrežikonte jetën e njerëzve, prandaj duhej hequr që të ribëhej. Mirëpo, për çudi të qytetarëve, të nesërmen në piedestalin bosh të monumentit, u vendos busti i një strategu ushtarak, të cilit historianët zyrtarë i jepnin meritën e bashkimit të qytetit me mbretërinë.

Seç ndodhi më pas me këtë bust, me qytetin, me qytetarët e tij dhe me mua, do ta shohim në këtë pjesë.

Tabloja I

Zyra e kryetarit të qytetit ka një mobilim modern. Nga dritarja përballë duken konturet e qytetit me një arkitekturë tekanjoze. ku përzihet tradita me ndërtimet e larta Në tryezën e punës dy telefona. Sekretarja merret me sistemin e zyrës.

- Kryetari* - (*Hyn me nxitim*). Mos telefonuan nga qendra?
- Sekretarja* - Jo, zoti kryetar. Netët e kryeqytetit janë të lodhshme. Zyrtarëve u del gjumi vonë.
- Kryetari* - Sot ata do të telefonojnë patjetër. Përrurimi i bustit të strategut ishte një ngjarje historike. E patë kronikën në televizion?
- Sekretarja* - E pashë, sigurisht.
- Kryetari* - (*ngacmues*). Si të mos e shikoni, kur kronisti është dashnori. Dashnori apo i fejuari.
- Sekretarja* - (*shmanget*). Zoti kryetar, në dhomën e pritjes janë ata që keni kërkuar.
- Kryetari* - Le të vijmë. (*Sekretarja del dhe hyn e shoqëruar nga gazetari, kapiteni dhe kronisti*). Ejani pëllumba, hyni brenda shërbyes të devotshëm të mbretërisë. (*Hyjnë të hutuar. Kapitenit*). Përrurimi i djeshëm na vajti mirë, s'pati asnjë protestë, asnjë parullë armiqësore. Jeni i kënaqur besoj?
- Kapiteni* - Nuk e fsheh, zoti kryetar. Pas revoltave të vjeshtës, urtësimi

- i djeshëm i qytetarëve ishte një befasi e këndshme.
- Gazetari* - Druri ka dalë nga xheneti. thonë!
- Kapiteni* - Në këtë qytet proverbat marrin kuptime të kundërta. Gjithësesi masat ishin marrë. Kodra që rrethuar nga forcat tona.
- Kryetari* - Për fajt të mirë kamera e tij nuk i pa.
- Kronisti* - (Ndahet nga biseda me sekretaren). Syri profesionist shikon vetëm atë që duhet parë, zoti kryetar.
- Kryetari* - Me ty, më vonë. (*Kapitenit*). Po ato lehje qensh?
- Kapiteni* - Lehje qensh?
- Kryetari* - Në mes të fjalimit tim.
- Kapiteni* - Disa lehje tepër të largëta, ndoshta ...
- Kryetari* - Larg, afër, lehjet e qenve, janë lehje qensh.
- Kapiteni* - Aty është udhëkryq, rrotull ka disa fshatra dhe fshat pa qen...
- Kryetari* - Po pse të lehin pikërisht gjatë fjalimit tim? Nuk të duket se dikush i ndërrente qëllimisht?
- Kapiteni* - Unë zoti kryetar vëzhgoja pjesëmarrësit.
- Kryetari* - Posi, se mos kishte ndonjë turmë të madhe për të vëzhguar. Ky ishte një provokacion. Në ato fshatra të bëhen hetime. Qentë të vriten.
- Kapiteni* - Me ç'pretekst?
- Sekretarja* - Sepse kanë lehur gjatë fjalimit.
- Kryetari* - Ja edhe një idiot tjetër. Me pretekstin e rrezikut të tërbimit. (*kapiteni del*).
- Kronisti* - (*Me kënaqësi*). Besoj se e vutë re, zoti kryetar, në kronikën televizive ato zhurma të huaja ishin mënjauar.
- Kryetari* - Zhurma? Për kë e ke fjalën ti?
- Kronisti* - Për ato angullima apo lehje ç'qenë?
- Kryetari* - E keqja është se në atë kronikë që mënjauar çdo zhurmë.
- Kronisti* - (*I hutuar*) S'ju kuptoj...
- Kryetari* - Ku ishte zhurma e popullit? Entuziazmi, thirrjet, duartrokitjet, breshëritë e duartrokitjeve? Fytyrat e qeshura e të gëzuara? E përqendruat kamerën në fytyrën time sikur të isha Marlon Brandoja!

- Kronisti* - Ç'është e vërteta, s'kishte fytyra për të qenë. Të ngrysurat si në funeral.
- Kryetari* - Ti je usta apo çirak në zanatin tënd? Pse nuk montoje ca kuadro nga ndeshja e boksit, kur ata duartrokisnin boksierët e tyre?
- Kronisti* - E pamundur! Ajo ishte një kronikë në interior, brenda...
- Kryetari* - Mjaft! Sikur në kryesi të jenë të pakënaqur bashkë do të flasim ndryshe (*gazetari*): Tani të shohim ç'ke qullosur ti.
- Gazetari* - Për fat të mirë, pena si shpikje e vjetër na bindet më mirë.
- Kryetari* - (*Lexon*) "Pas përrurimit të bustit, ky qytet ka marrë plotësisht fytyrën e së nesërme. Në të ardhmen, atëherë kur bota ta ketë zgjidhur siç duhet bashkëjetesën harmonike në një kulm të vetëm të njerëzve prej kombësish të ndryshme..."
- Gazetari* - (*Vijon*). "Do të shfletojë historinë dhe do t'i ndalet shikimi këtu, tek kjo mbretëri dhe tek ky qytet, ku çështja nacionale ..."
- Kryetari* - "Ka gjetur një zgjidhje ideale! Nën kujdesin e kombit mëmë. Jo, jo! Ç'është ky budallallëk. Kjo tingëllon keq. Shtypit tonë i kanë shpëtuar disa herë shprehje të tilla të pakujdesshme dhe gazetatat e huaja gjejnë fije ku të kapen. Prisheni, fshijeni.
- Sekretarja* - Në sallon po pret poeti.
- Kryetari* - Të vijë menjëherë. (*Kryetari e pret krahëhapur*). Ja dhe një nga krenaritë e qytetit tonë. (*Me humor*) Miku im, pushteti është arrogant. Ai jep urdhra dhe urdhri e nxjerr poetin prej tempullit të tij në një kohë të papërshtatshme.
- Gazetari* - Ai nuk i vë re këto vogëlsira, sepse është një artist për - masave të mëdha. Këtë ua them unë, një gazetar modest nga provinca, që dikur ka ëndërruar të bëhet poet.
- Kryetari* - Përpara lisit drurët e tjerë duken shkurre.
- Poeti* - Kjo qenka një metaforë tepër e përshtatshme për sferën e hierarkisë shtetërore.
- Gazetari* - Goditje në shenjë zoti kryetar!
- Kryetari* - E pranoj! Ironi e hollë!
- Gazetari* - Fatëkeqësia e tij e vetme është se shkruan në gjuhën e kombësisë së tij. Poezia e tij është përkthyer pak në gjuhën

- tonë.
- Kryetari* - Fare pak dhe tepër keq. (*Gazetari*). Madje, po të mos tre - mbesha nga thumbat tuaja, unë do të thosha sinqerisht se disa prej vjershave të tij, më janë dukur të pakuptueshme.
- Poeti* - Siç duket diçka errësohet gjatë përkthimit. (*Pauzë*).
- Kryetari* - Miqtë e mi. Mjaft me këtë gjuhë plot figura. Bukuria e saj është e lodhshme për mua. (*Poetit*). Si ju duk ceremonia e përirimit?
- Poeti* - Siç duhej dhe siç pritej.
- Kryetari* - Për këtë eveniment do të flasë e ardhmja. Ç'është e drejta, këto simbolet e vjetra me shpendë apo kafshë duken tepër anakronike. Tani njerëzimi kërkon simbole të reja, të për - bashkëta. (*Pauzë*) Pjesëmarrja juaj ra në sy menjëherë. Ai kronisti ynë i televizionit është idiot (*Sekretares*). Mos të të vijë keq. Në kronikën e mbrëmshme, bashkë me autoritetet duhej të kishte përmendur edhe emrin e poetit.
- Poeti* - (*Sekretares*). Mund ta siguroni se nuk kam mbetur i fyer nga kjo harresë.
- Gazetari* - Në reportazhin që do të botojë shtypi qendror, ky gabim është ndrequr.
- Poeti* - Mos harroni të shkruani se mora pjesë bashkë me nxënësit. Pjesëmarrja e shkollës ishte e programuar dhe e detyruar. (*Kryetari dhe gazetari shohin njëri - tjetrin të zhgënjyer*). Pasi më shprehët kënaqësinë për pjesëmarrjen, besoj se do të më jepni leje të largohem. Më presin nxënësit e mi.
- Kryetari* - Por... si është e mundur të mendoni se ju kam thirrur për këtë. Unë kam për ju një lajm tjetër, të rëndësishëm. (*Nxjerr një letër*). Drejtori i shtëpisë më të madhe botuese të kryeqytetit, më kërkon një përmbledhje me poezitë tuaja të zgjedhura. Do të jetë një botim luksoz, që më pas do të përkthehet në gjuhët kryesore të botës. Unë dëshiroj që zgjedhjen ta bëni ju vetë. Hë, si thoni? (*Poeti duket i befusuar*). Ah, si jeni ju njerëzit emocionalë!... Përlotenimënjëherë nga gëzimi. Pikërisht kur duhen, fjalët ju ikin. Pra, zgjedhjen do ta bëni vetë?
- Poeti* - (*I turbulluar*) Besoj se ashtu është më mirë. Mirupafshim.

- (Del)
- Gazetari - Pëh. ç'njeri. As që denjoi t'ju falënderonte.
- Kryetari - S'prish punë.
- Gazetar - Kot e keni, zoti kryetar. Njerëz si ai nuk bëhen kurrë plotësisht tanët.
- Kryetari - Në fillim le të bëhet yni pjesërisht. Prania e tij në përirim...
- Gazetari - Prania e tij është e detyruar.
- Kryetari - Nuk më pëlqen kur më japin mend.
- Gazetari - Më falni.
- Kryetari - Për njerëzit e artit, grepi më i sigurtë është ai i lavdisë. Uluni, bëni redaktimet e fundit! Shtoni entuziazmin. Për mendni dy-tre herë emrin e tij, por mos bëni budallalëk të shkruani se ai u frymëzua për ndonjë poemë. (*Hyn me rëmbim dhe i shqetësuar kapiteni*).
- Kapiteni - (*Tepër i turbulluar*) Zoti kryetar... na mori lumi. Gjithçka. Katastrofë. Na mori lumi.
- Kryetari - Çfarë thua more idiot! Fol qartë!
- Kapiteni - Busti i strategut është ... nuk është më... E kanë zhdukur.
- Kapiteni - E kanë zhdukur? Kush? Si? (*kapiteni ngre supet*). Kapeni, gjejeni. Vendoseni menjëherë në vendin e vet.
- Kapiteni - E kërkua kudo. Dërgova të vijnë dhe palombarë që të zhyten në fund të kënetës aty pranë, por deri sa të vijnë ata...
- Kryetari - (*Shpërthen*) Idiotë! Syleshë! Të paaftë!. Derra te ndyrë që zhgryheni nëpër pijetore. Miopia juaj politike është e pafalshme. (*Vjen rrotull nëpër dhomë*).
- Kapiteni - Ç'të bëjmë zoti kryetar?
- Kryetari - Të mbyteni.
- Kapiteni - Si urdhëron...për të mbytur jemi (*bën të ikë*).
- Kryetari - Hajde, mblidhe veten dhe mos u qaj si lavirë. Arrestoni ata që keni në listat e të dyshimëve. Të gjithë, menjëherë, brenda ditës së sotme. (*Kapiteni del. Ulet i dërmuar*). Kjo është vërtet katastrofë!

Tabloja e dytë

Po ajo zyrë. Kryetari. kapiteni. ndihmësi i kapitenit, sekretarja. Më vonë edhe hetuesi nga kryeqyteti.

- Kryetari* - Ju kam thirrur t'ju paraqes te njeriu që do të marrë përsipër hetimin e mëtejshëm të krimit të natës së 27 dhjetorit.
- Kapiteni* - Zoti kryetar!.. ne dëshirojmë që ju, si autoriteti më i lartë i këtij qyteti që jeni... (*ngatërrohet*), të shprehim, domethënë, të themi, se nga ardhja e tij, ne ndihemi ca të prekur në sedër.
- Kryetari* - Pse të fyheni? Deri tani ju jeni treguar të paaftë për të ngritur atë proces gjyqësor që na duhet për këtë rast.
- Kapiteni* - Ne kemi rrasur brenda gjithë ata njerëz ...
- Kryetari* - (*Ironik*). Punë të vështirë keni bërë! Çështja ishte që nga ata njerëz të fabrikoni disa të akuzuar të dobishëm, disa robotë njerëzorë, nga ata që ia nxijnë pa të keq faqen vet-vetes. Këtë nuk e bëni dot, mos më shisni mend. Prandaj e kërkuam hetuesin nga kryeqyteti. Ai erdhi mbrëmë dhe unë do t'ju njoh me të...
- Ndihmësi i kapitenit* - Zoti kryetar... në qoftë se më lejoni, ne e njohim pak atë njeri. Domethënë e kemi në sy.
- Kryetari* - Si? Qysh?
- Ndihmësi i kapitenit* - Ai ka katër ditë që ka ardhur, rri gjoja "inkonjito" po ne e vëzhgojmë!
- Kryetari* - Hm... paske qenë qerrata i madh!
- Kapiteni* - Prandaj nuk ia vlen që ju ta sajdisni kaq shumë.
- Kryetari* - Mjaft tani. Deri sa e kam marrë vetë përsipër t'ju paraqit me të, kuptohet që është njeri shumë i rëndësishëm. Ju duhet t'i bindeni për çdo gjë. (*Sekretares*). Ka ardhur?
- Sekretarja* - Po, s'ka një minutë.

- Kryetari* - (Hap derën e sjell me vete). Miku im. Dëshiroj t'ju njoh me kolegët e mi dhe bashkëpunëtorët tuaj të ardhshëm. Po të doni mund të flasim pak këtu. (Ulen të dy. Hetuesi ka këmbyer vetëm përshëndetje zyrtare me kapitenin dhe ndihmësin).
- Hetuesi* - Po uluni kolegë, s'ka nevojë për një respekt të tillë. Mund t'ju drejtoj disa pyetje kolegëve zoti kryetar?
- Kryetari* - Atyre dhe mua po të doni. E kemi për detyrë t'ju ndihmojmë.
- Hetuesi* - Sa vetë keni arrestuar deri tani?
- Kapiteni* - Disa dhjetra... afro dyqind.
- Hetuesi* - Mbi ç'baza u bënë këto arrestime?
- Kapiteni* - Ne kishim lista të plota të personave që ishin treguar aktivë në demonstratat e vjeshtës.
- Hetuesi* - Demonstrata? A nuk ua vret veshin kjo fjalë, zoti kryetar?
- Kryetari* - Në ç'kuptim?
- Hetuesi* - Është shumë e vrazhdë.
- Kryetari* - Përkundrazi. Për ato ngjarje është shumë e butë. Ka qenë një rebelim, një kryengritje e vërtetë.
- Hetuesi* - Jo, jo. Duhet të mësojmë opinionin publik me një fjalë më të lehtë, disi më të përcaktuar.
- Ndihmësi i kapitenit* - Në qoftë se më lejoni ... trazira.
- Hetuesi* - Trazira? S'është keq.
- Sekretarja* - A nuk do të ishte më mirë t'i quanit turbullira?
- Hetuesi* - Turbullira? Pse pikërisht?
- Sekretarja* - Nga fjala trazirë të vjen të përzjerë...
- Hetuesi* - E drejtë. Turbullimi nënkupton kthjellimin. Turbullohet, pastaj kthjellohet. (Sekretares). Zonjushë, ju falemnderit. Pra ju kishit lista të plota për personat aktivë të turbullirave të vjeshtës. I arrestuat të gjithë?
- Kapiteni* - Dy studentë u arratisën. (Pauzë).
- Hetuesi* - Dyqind! S'mund t'ju qortoj. Sidoqoftë metoda ime është ndryshe. Pa zhurmë, pa bujë. (Shkon tek një panel i errët pranë perdes. Vizaton me shkumës një rreth të madh). E thjeshtë, si një mësim gjeometrie. Ky është grupi i të arrestuarve që dyshohen si pjesëmarrës të krimit. Rrethi duhet të vijë gjithnjë duke u zvogëluar. (Brendashkruan rrethë gjithnjë e më

të vegjël). Deri në një bërthamë. Ky është grupi i krimit. Kjo metodë, ka dy të mira; e para, e përqendron akuzën tek faktorët kryesorë dhe duke lirur disa nga të arrestuarit, qetëson psikozën e frikës tek banorët e qytetit.

*Sekretarja
Kryetari*

- Qenka një metodë mjaft humanitare.

- (Qortueshëm)- Vogëlushe. I kam dhënë zotit kryehetues rekomandime të mira për ty.

*Hetuesi
Kapiteni*

-Pse e qortoni?! Zonjusha qëllon vazhdimisht në shenjë.

- (Ndhimësit mënjanë) - Qenka i trashë. Nuk e kupton fare talljen e saj.

*Ndhimësi i
kapitenit*

- Ose e kupton, por e pranon sepse i pëlqen ajo që e përdor.

Kapiteni

- Ky do të na fryjë kokën me dëngla.

Hetuesi

- (Kapitenit) - Ngulni këmbë se kishit lista të plota?

Kapiteni

- (Me një farë padurimi).- Po...

Hetuesi

- Gabim. Listat s'mund të jenë kurrë të plota. Vazhdimisht dikush i shpëton syrit të policisë. Pra ka diku në qytet një grup të panjohurish, që nuk janë arrestuar për arsye të ndryshme. Qysh tani unë i kam disa emra. Një farë poeti, përshembull paska pyetur: "sa i rëndon dheut ky bust". Këtë e ka dëgjuar një polic.

Kryetari

- Për atë njeri do të bisedojmë më vonë.

Hetuesi

- Pastaj do të na duhet të gjejmë edhe disa njerëz të tjerë të papërlyer me krimin, por që dinë diçka mbi krimin dhe kriminelët. Shpirtërisht ata mund të mos jenë me ne, por duke qenë natyra të frikshme, lakohen dhe thyhen, bëhen pra dëshmitarë të dobishëm për hetuesin. Këta janë... janë si mund të gjejmë një emër...

Kapiteni

- Informatorë të fshehtë.

Hetuesi

- Gabim. Shumë e ashpër kjo.

Sekretarja

- Kolonë e pestë.

Hetuesi

- Kolonë e pestë? Këtë herë nuk qëlluat. Bashkëpunëtorë vullnetarë, ky është emri i përshtatshëm. Ju duhet të më ndihmoni të gjej disa të tillë midis qytetarëve të kësaj kombësie. (Largohet nga paneli). Kjo do të jetë metodologjia e

- këtij hetimi. (*Ulet. Kapitenit*). Flisni.
- Kapiteni* - (*Disi i habitur*) - Përse dëshironi t'ju flas?
- Hetuesi* - Për rrethin.
- Kapiteni* - Për ... rrethin?
- Hetuesi* - Ju më dëgjuat, apo i rashë teneqes kot?
- Kapiteni* - Sigurisht, zoti hetues. I kam mbajtur shënim të gjitha. (*Shfleton bllokun*).
- Hetuesi* - Të lirojmë ca të arrestuar, t'i provojmë opinionit publik se në themel të politikës sonë ndaj këtij qyteti të pagdhendur dhe rebel, mbetet toleranca dhe shpirtmadhësia. Si ju duket?
- Sekretarja* - Përderisa kozmetika e zbukuron njeriun, s'ka përse të mos përdoret edhe në politikën që bën njeriu.
- Kryetari* - Vogëlushe...
- Hetuesi* - Cili ka qenë ai budalla që ka thënë se femrat e bukura nuk janë të zgjuara? Hë pra, kë do të lirojmë?
- Kapiteni* - Asnjë s'do të lirojmë! Ne mezi i futëm brenda.
- Ndihmësi i kapitenit* - Ndoshta ata pesë punëtorët e fabrikës së ventilatorëve. Natën e ngjarjes kanë qenë në punë.
- Hetuesi* - Alibi e pakundërshtueshme.
- Kapiteni* - Janë pjesëmarrës aktivë të demonstratave. Më falni, të turbullirave të vjeshtës.
- Kryetari* - Lirojini.
- Ndihmësi i kapitenit* - Janë pastaj nja njëzet femra.
- Hetuesi* - S'është punë grash kjo.
- Kryetari* - Lirojini.
- Hetuesi* - Dhe tani me lejen tuaj, zoti kryetar, do të doja të shkoja në burg dhe të merrja në pyetje atë që ju e mbani si të dyshuarin kryesor.
- Kryetari* - Zelli juaj është i admirueshëm, miku im. (*Takohen. Dalin kapiteni, ndihmësi, sekretarja. Hetuesi kthehet nga rruga*).
- Hetuesi* - Sekretarja juaj personale është kjo, zoti kryetar?
- Kryetari* - Njëra nga sekretaret.
- Hetuesi* - Goxha pelë. Paskeni shije të hollë.
- Kryetari* - (*Me humor*). Më mjafton ime shoqe.

- Hetuesi* - Sidoqoftë... A e di ajo stenografinë?
Kryetari - E di.
Hetuesi - Ma lini mua për ndihmë gjatë hetimit. Pamja e saj e qeshur do të bëjë përshtypje të mirë tek dëshmitarët.
Kryetari - Është e sertë dhe ka gjuhë të gjatë. E dëgjuat vetë.
Hetuesi - Zbutja është profesioni im. Mirupafshim dhe ju faleminderit.
(Del. Dëgjohet zhurma e makinës).

Tablo e tretë

(Në hetuesi. Dhomë me pajisje dhe ndriçim të përshtatshëm për këto rast. Kanë sjellë shoferin. Ndihmësi ulet tek makina e shkrimit.)

- Hetuesi* - A e dini pse jeni arrestuar?
Shoferi - Atë duhet ta dijë kapiteni më mirë.
Hetuesi - Domethënë... Ju nuk e dini shkakun e arrestimit tuaj?
Shoferi - Këtu në qytet çarkullon një fjalë e urtë për arrestimet. Po të mos e shënoni në proçes - verbal, mund t'juja them.
Hetuesi - Nuk do ta shënoj. Derisa qenka një proverb, s'mund të shërbejë si akuzë.
Shoferi - Thonë se këtu i fundit që e merr vesh shkakun e burgosjes, është vetë i burgosuri.
Hetuesi - Hëm,... qenka një akuzë mjaft e rëndë për ju, kapiten.
Kapiteni - Parullë armiqësore.
Hetuesi - Mund të jetë edhe parullë. Shërbyesit e ligjit bëhen shpesh objekt anekdotash. *(Shoferit).* Ç'punë bën?
Shoferi - Shofer me autovinç.
Hetuesi - Në ç'objekt punon?
Shoferi - Në ndërtimin e hotelit turistik "Pylli i Zi", njëzet kilometra nga qyteti.
Hetuesi - Pra ju udhëtoni në autostradën perëndimore përditë.
Shoferi - Dy herë në ditë. Në mëngjes dhe në mbrëmje.

- Hetuesi* - E dini ngjarjen e shëmtuar që ndodhi te kilometri i tretë i kësaj rruge natën e 27 dhjetorit?
- Shoferi* - E mora vesh të nesërmen, rreth orës nëntë.
- Hetuesi* - Në ç'rrethana?
- Shoferi* - Në rrethanat e zyrës së hetuesisë. Në sajë të zotit ndihmës, i cili pati mirësinë të më sqarojë me mjaft butësi, (*Tregon çikatriçen në fytyrë*) se krimin e asaj nate e kisha bërë unë.
- Hetuesi* - Gjë që ju e mohuat.
- Shoferi* - Kokë e këmbë.
- Hetuesi* - Si specialist i transportit të peshave të rënda, mund të na sqaroni se si mund të shkulet nga vendi një bust bronzi që peshon disa kuintalë?
- Shoferi* - Me anë të një makine me forcë të çfarëdoshme dhe të një kabloje prej çeliku.
- Hetuesi* - Mund ta bëjë këtë një njeri i vetëm?
- Shoferi* - Mundet.
- Hetuesi* - Kjo më duket si e pabesueshme. Mos harroni peshën e bustit.
- Shoferi* - Po të më jepni dy pashë litar, unë mund t'jua tregoj si bëhet kjo.
- Hetuesi* - Litar?
- Shoferi* - Kot më vajti mendja. Në këto zyra, s'ka pse të ketë litarë.
- Kapiteni* - I akuzuar!
- Shoferi* - I dyshuar zoti kapiten, vetëm i dyshuar. Kështu e përca-
tuam bashkë duke u mbështetur në Kodin Penal të mbre-
tërisë.
- Kapiteni* - Do të paguani edhe për ironinë tuaj. Dhe çmimin e këtij
borxhi do ta vëmë ne.
- Shoferi* - Unë nuk tallem. Është fakt, në burgjet moderne, litarët
kanë dalë nga përdorimi. (*Ndihmësi sjell një litar*).
Në fillim duhet bërë një lak i gjerë, aq sa të përmbledhë
tërësisht objektin që do të shkulet. (*Bën lakun dhe pastaj e
hedh mbi bustin prej bronxi që është në cep të dhomës*) Tani unë
jam në rolin e makinës. (Bëhet gati ta tërheqë. Ndihmësi
pret litarin me thikë).
- Kapiteni* - (*I turret, e godet dhe e rrëzon*). Provokator, qelbësirë, kriminel!

- Hetuesi* - (Ndërhyn).- Mjaft! Uluni në vendet tuaja dhe mos ndërhyini më.
- Kapiteni* - (I nxehur) - Ju e patë vetë! Ai guxon të hedhë lakun në qafën e mbretit tonë! A ka provë më të qartë sesa kjo për ndjenjat e tij armiqësore?
- Shoferi* - (Hetuesit) - Unë nuk shpreha asnjë ndjenjë. Ishit ju që më kërkuat ta bëja provën.
- Hetuesi* - Nuk mund ta bënit me ndonjë objekt tjetër të zyrës? Me një karrige për shembull.
- Shoferi* - Karrigia është tepër e lehtë. Meqë ishte fjala për sende të rënda prej bronzi, mendova se prova do që bindëse po të bëhej me një send tjetër prej bronzi.
- Kapiteni* - (I ndërhyin)- Busti i mbretit tonë nuk është send.
- Shoferi* - Këtë s'e kam ditur.
- Hetuesi* - Fjalët tuaja janë shumë të pamatura dhe kapiteni ka të drejtë kur thotë se ato shprehin ndjenja të errëta. Ju premtova se nuk do ta shënoja në proces-verbal atë fjalën e urtë, por këto të tjerat... (Ndihmësi mban shënim). Ju dukeni një njeri me bindje të patundura, me karakter të fortë. Njerëzit si ju çdo veprim e bëjnë me vetëdije të plotë, ndihen krenarë për to dhe duan që krenarinë ta shijojnë deri në fund, pa iu shmangur pasojave të saj.
- Shoferi* - E gjithë kjo lëvdatë, mos do të thotë se unë duhet të pranoj akuzën që më bëhet?
- Hetuesi* - Mos u ngut. Çdo gjë do të ecë sipas logjikës së saj. Ju më bindët se një njeri i vetëm, mund ta shkulë bustin nga vendi. Mirpo busti është shkullur dhe është zhdukur. Dyshohet se mund të jetë hedhur në ujrat e kënetës aty pranë. Kjo do të thotë se ai është transportuar me ndonjë mjet. Që të transportohej, duhej të ngarkohej. Nuk besoj të thoni se këtë mund ta bënin me duar një ose dy veta.
- Shoferi* - Jo, Kjo është e pamundur. Mund të ngarkohet vetëm me ndonjë mekanizëm peshëngritës.
- Hetuesi* - Për shembull, me një autovinç. Sa autovinça ka qyteti juaj?
- Shoferi* - Disa! Vetëm enti ynë i ndërtimeve turistike, ka gjashtë.

- Hetuesi* - Pra, ju e pranoni se busti mund të zhduket vetëm me anë të një autovinçi.
- Shoferi* - Këtë nuk e thashë. Busti mund të zhdukej dhe duke e tërhequr zvarrë nëpër xhade. (Hetuesi shikon kapitenin).
- Kapiteni* - Kjo përjashtohet. Në xhade do të kishin mbetur gjurmët e gërryerjeve. Hetimi nuk vërejtí ndonjë gjë të tillë.
- Hetuesi* - (Shoferit)- Ç' do të thoni?
- Shoferi* - Asgjë. Unë nuk kam bërë ndonjë hetim. (Pauzë)
- Hetuesi* - Kini ndonjë provë që ta hidhni poshtë akuzën? Ama ndonjë gjë me peshë.
- Shoferi* - Oh, asgjë me peshë. Vetëm një rrethanë. Atë natë automjeti im ishte mbyllur në garazh. (Pauzë)
- Hetuesi* - Edhe sikur të jetë kështu, kjo nuk e përjashton pjesëmarrjen tuaj, sepse ju mund të bashkëpunoni me ndonjë koleg.
- Shoferi* - Me cilin? Se vetëm unë jam burgosur!
- Hetuesi* - Se kush është arrestuar, ju s'keni si ta dini. (Shtyp një buton. Hyn një polic). Merreni! (Shoferi del).
- Kapiteni* - Më fal zoti kryehetues, por...
- Hetuesi* - Keni ndonjë vërejtje? Hetimi im ju duket i butë?
- Kapiteni* - Nuk desha të them pikërisht i butë.
- Hetuesi* - Mund të thoni, pse jo? Mos u stepni nga pozita ime, unë jam njeri i gjerë. (ndihmësit). Edhe ju kështu mendoni?
- Ndihmësi i kapitenit* - Në qoftë se më lejoni... Unë do të mendoja ndryshe, por druhem se do të më merrni për servil.
- Hetuesi* - Nuk ua marr.
- Ndihmësi i kapitenit* - Ka qenë një hetim shkencor me qitje të largët.
- Kapiteni* - Ç'shkencor more. Këta duan dajak, jo shkencë.
- Hetuesi* - Edhe druri është teknologji më vete. Nuk më thatë, qëndron ajo alibia e tij?
- Kapiteni* - Për fat të keq, duket se po.
- Ndihmësi i kapitenit* - I vetmi që mund të provojë se makina e tij ka qenë në garazh, është roja e natës e garazhit.
- Hetuesi* - E pyetët?

- Ndihmësi i kapitenit* - E pyeta unë. Pohoi se autovinçi u mbyll në garazh në orën nëntëmbëdhjetë.
- Hetuesi* - *(I mërziur)* Je treguar torollak. Nuk duhej t'i ballafaqonit.
- Ndihmësi i kapitenit* - Nuk bëra ballafaqim. E pyeta veçmas dhe porosita ta mbyllte gojën. *(Pauzë)*
- Hetuesi* - Dhe ju mendoni se pikërisht ky shofer duhet të jetë i akuzuari kryesor në këtë proces?
- Kapiteni* - Ju e patë vetë dosjen e tij. Kjo tjetra është e atit të tij. Një racë rebele, brez pas brezi. Kokëfortë, fodulle, kundërshtarë të përbetuar për jetë.
- Hetuesi* - Me atë rojen keni vepruar mirë.
- Kapiteni* - Po sikur ta qëronim këtë dëshmitar?
- Hetuesi* - Kjo që propozoni është shumë primitive. Roja do të qe shumë më i dobishëm, sikur të pohonte të kundërtën. Këtë duhet të arrini.
- Ndihmësi i kapitenit* - Në qoftë se më lejoni, dëshiroj t'ju jap edhe ndonjë emër për atë rrethin e tretë të bashkëpunëtorëve.
- Hetuesi* - Ja, ky zell më kënaq. E bisedojmë rrugës, në makinë. A ka ndonjë lokal nate ku mund të vrasësh mërzinë e largimit nga kryeqyteti?
- Kapiteni* - Te "Globusi". Aty ka një orkestër ciganësh.
- Hetuesi* - Mund të ftonim edhe zonjushën sekretare?
- Ndihmësi i kapitenit* - Ajo takohet për natë me kronistin e televizionit. Por, në qoftë se më lejoni, te "Globusi" ka plot vajza me sjellje të përshtatshme për një të huaj si ju...

Tabloja e katërt

- Zyra e hetuesit. Mëngjes herët. Hetuesi, kapiteni dhe sekretarja.

- Kapiteni* - (Duke hyrë). Mësuesja po pret tek korridori.
- Hetuesi* - Le të presë. *(Kapitenit)*. Kini ndonjë informatë të re për të?
- Kapiteni* - Ato që dija, ua kam thënë të tëra me shkrim.
- Hetuesi* - Dëshmitari, kapiten, duhet parë si një pyll i errët, misteret e të cilit zbulohen pak nga pak. Sa më shumë shtigje të gjesh, aq më shpejt e zbulon...
- Sekretarja* - *(E ndërpret)*. Viktimën.
- Hetuesi* - Shumë e vrazhdë kjo, zonjushë.
- Sekretarja* - Në kuptimin që gjatë hetimit, marrëdhënia e hetuesit me dëshmitarin, është si ajo e gjuetarit me lepurin.
- Hetuesi* - Me këtë zgjuarsi, që po e çmoj çdo ditë e më shumë, do të më hapni ndonjë shteg për të fshehtat e asaj gruaje?
- Sekretarja* - S'e besoj të ketë shumë të fshehta. Çështja qëndron kështu. Pas rebelimeve... më falni, pas turbullirave të vjeshtës, në shkollën ku ajo jep mësim, u arrestuan disa nxënës dhe dy mësues me pretekstin se ..
- Kapiteni* - Të jeni më e matur! Preteksti nënkupton një arsye të pamjaftueshme!
- Sekretarja* - Në qoftë se ju intereson rrëfimi im, i thoni të mos më ndërpresë.
- Hetuesi* - *(Me humor)*. Pa grindje.
- Sekretarja* - Kur u muar vesh kjo gjë, shumë prej mësuesve të shkollës dhanë dorëheqje. Midis tyre ishte edhe një mësues i vjetër që pas dy muajsh mbushte moshën e pensionit . Sipas ligjit, pas një dorëheqjeje te tillë, me nuanca politike, ai humbiste të drejtën e pensionit. Vendimi i tij dukej fare çmenduri, megjithatë, ai nuk u tërhoq.
- Hetuesi* - *(Kapitenit)* - Këto ju nuk m'i keni thënë.
- Kapiteni* - Sepse nuk kanë asnjë lidhje me çështjen. *(Sekretares)* Po

- ju bukuroshe. pse po i kujtoni këto gjëra?
- Sekretarja* - Sepse unë mendoj që kanë lidhje me çështjen. Siç thonë të gjithë, ishte pikërisht ky mësues plak , i cili e bindi granat që po pret aty të mos jepte dorëheqjen bashkë me të tjerët.
- Kapiteni* - Kjo është thjesht një shpifje e propagandës armiqësore që bëhet në këtë qytet.
- Hetuesi* - Pse e bëri këtë mësuesi plak? Ç'thonë ata?
- Sekretarja* - Mësuesja është e re dhe ka pesë fëmijë.
- Hetuesi* - Pesë fëmijë? O Perëndi ç'bëhet këtu!
- Sekretarja* - Po të jepte dorëheqjen, ajo mbetej pa asnjë mjet jetese.
- Hetuesi* - Dhe ajo u bind?
- Sekretarja* - E bindën më tepër.
- Hetuesi* - E bindën! Humbja e mjeteve të jetesës! (*Ecën nëpër zyrë*). Ja kush i shuan ndjenjat nacionaliste.
- Sekretarja* - Ajo kishte detyrime të mëdha. Një ndjenjë e tillë prindërore, a nuk të prek në shpirt?
- Hetuesi* - (*E shikon me habi*). Pa sentimentalizëm. Ju faleminderit, më ndihmuat. Silleni! (*Hyn mësuesja. Duket tepër e tronditur*)
- Mësuesja* - Mirëmëngjes.
- Hetuesi* - Mirëmëngjes. Urdhëroni, uluni ju lutem.
- Mësuesja* - Por nuk e di nëse duhet. Në orën nëntë duhet të jem në shkollë.
- Hetuesi* - Në orën nëntë? Kemi edhe një orë e gjysmë kohë.
- Mësuesja* - Autobusi i linjës nisat në orën tetë e njëzet dhe ...
- Hetuesi* - Uluni. Unë do t'ju nis me veturën time. Ju besoj e dini cili jam.
- Mësuesja* - Po.
- Hetuesi* - Ngjarja e datës së 27 dhjetorit, ishte një provokacion që synon të mbjellë përçarje në mbretërinë tonë solide. Është një krim politik. Ndihma për zbulimin e bandës që bëri krimin është detyrë nderi për çdo qytetar. Apo mendoni ndryshe?
- Mësuesja* - Jo, por nuk e kuptoj pse pikërisht unë?
- Hetuesi* - O, po, qetësohuni! Ndodhën midis njerëzve që ju çmojnë dhe ju duan të mirën. Mos vallë ju impresionon kjo zyrë? Hiqni perdet kapiten, të hyjë dritë. Ç'lëndë jepni në shkollë?
- Mësuesja* - Gjuhë angleze.

- Hetuesi* - O! I think it's a very pleasure for you¹⁾.
- Mësuesja* - Këtë kënaqësi ta jep dobia e kësaj gjuhe.
- Hetuesi* - Banoni në qytet?
- Mësuesja* - Po.
- Hetuesi* - Dhe jepni mësim në një shkollë fshati? Nuk është ca e lodhshme kjo?
- Mësuesja* - Jam mësuar. Pastaj linja e autobusëve është e rregullt.
- Hetuesi* - Me gjendjen tuaj familjare mund të pretendonit për një zgjidhje më të mirë. Në qytet ka disa shkolla. Por kjo nuk është e pamundur të ndreqet. Apo jo kapiten?
- Kapiteni* - Ashtu besoj edhe unë. Mund të ndreqet lehtë.
- Hetuesi* - Veprimi juaj i matur në vjeshtën e shkuar ka rënë në sy për mirë.
- Mësuesja* - (E pezmatuar). Ah, po... veprimi im në vjeshtën e shkuar.
- Hetuesi* - Ai provon mençurinë tuaj.
- Mësuesja* - Unë jam shumë e lidhur me nxënësit e mi, e nuk mund t'i lija pa mësim.
- Hetuesi* - Më tepër se dashuri, kjo shpreh besnikërinë politike.
- Mësuesja* - Zotëri!...Nganjëherë rrethanat janë më të rënda se dëshirat e njeriut.
- Hetuesi* - Mos e shikoni orën, vetura ime është parkuar në oborr. Tani le të hyjmë në temë (Shtyp butonin, polici sjell shoferin). E njihni këtë njeri?
- Shoferi* - Po, e kam parë
- Hetuesi* - (Mësueses). Keni ndonjë lidhje farefisnore?
- Mësuesja* - Jo.
- Hetuesi* - (Shoferit). Është e vërtetë kjo?
- Shoferi* - Nuk e mar vesh ç'kërkoni të nxirrni nga kjo grua?
- Hetuesi* - Këtu pyetjet i bëj unë. (Polici). Merre. (Shoferi del -Pauzë-) Më falni zonjë, por më shtyn detyra. Kapiten! Lajmëroni ndihmësin tuaj të presë. (Kapiteni del). Zonjushe, nuk është nevoja për proces-verbal, ne do të bëjmë thjesht një bisedë. (Shkon tek harta). Fshati ku jepni mësim ndodhet këtu?

1) Mendoj se kjo është një kënaqësi për ju

- Mësuesja* -Po.
- Hetuesi* - Vetëm një kilometër pas kodrinës ku u vendos busti i strategut dhe fare pranë kënetës.
- Mësuesja* - Po.
- Hetuesi* - Udhëtoni vazhdimisht me linjën urbane?
- Mësuesja* - Pothuajse.
- Hetuesi* - Nuk qëllon ndonjëherë të udhëtoni me makinë të rastit?
- Mësuesja* - Rrallë, kur linja s'ka qenë e rregullt.
- Hetuesi* - Me të arrestuarin keni udhëtuar?
- Mësuesja* - Dy a tri herë. Ka shumë kohë.
- Hetuesi* - Si është sjellë me ju?
- Mësuesja* - S'ju kuptoj!
- Hetuesi* - Ç'ka për të mos kuptuar? Jeni një grua e bukur.
- Mësuesja* - (Çohet). Ju po më fyeni.
- Hetuesi* - Përkundrazi. Dëshira ime e vetme është që t'ju ndihmoj dhe të plotësoj portretin moral të atij njeriut të ndyrë.
- Mësuesja* - Nuk e kam njohur për të tillë.
- Hetuesi* - Ju vjen rëndë, e di. Një grua e ndershme nuk ka dëshirë t'i kujtojë rastet kur ndonjë i poshtër është përpjekur t'i cenojë nderin.
- Mësuesja* - Me mua kjo nuk ka ndodhur kurrë.
- Hetuesi* - Më vjen keq zonjë, e shoh që lëndoheni lehtë, por detyra... më shtyn ta qartësoj nga çdo pikëpamje fytyrën e të akuzuarit. Kjo më detyron t'ju kujtoj se juve, ju ka ndodhur një incident me këtë shofer.
- Mësuesja* - Kurrë!
- Hetuesi* - Gjatë një udhëtimi, ai tentoi t'ju përdhunonte. Ju kundërshtuat me të gjitha forcat dhe ai nuk e arriti qëllimin e tij të poshtër. Ju zbritët në mes të rrugës. Aty pastaj ju mori një makinë tjetër.
- Mësuesja* - Ç'është kjo gënjeshtër e ulët? Përse ju duhet ajo?
- Hetuesi* - I am sorry! E para, kjo nuk është gënjeshtër se ne kemi dëshmitarë. E dyta, nga ju kërkojmë vetëm ta pohoni vepri-min e tij imoral dhe pastaj mund të shkoni e qetë. E qetë, dhe e sigurtë për të ardhmen tuaj.
- Mësuesja* - Këtë nuk mund ta bëj. Nuk do ta bëj kurrë.

- Hetuesi* - Mendohuni mirë. Rasti ka vënë në peshore të bardhën dhe të zezën tuaj.
- Mësuesja* - (*Më e vendosur*). Që kjo është gënjeshter. ketë ju e dini më mirë se unë, por...
- Hetuesi* - (*Endërpret*). Zonjë, dy herë e përdorët fjalën gënjeshtër. Ju këshilloj të mos e përsëritni më.
- Mësuesja* - Nuk e kuptoj përse e kërkonti këtë deponim, pikërisht prej meje?
- Hetuesi* - Sepse kjo ju ka ndodhur. Sepse i arrestuari, të cilin ju po e mëshironi, është një fundërinë, që nuk e meriton mëshirën tuaj. Një i degjeneruar, një maniak seksual agresiv, armik i rendit dhe i qetësisë së qytetarëve. Pra ai është gjithashtu një armik potencial politik i mbretërisë. I gatshëm për çdo veprim kriminal. Ja sepse (*Ulet i lodhur*). Mendohuni, por jo shumë gjatë se ora po kalon.
- Sekretarja* - (*I ofron mësueses një gotë me ujë*). Mblidhni veten, qetësohuni, ju presin fëmijët tuaj.
- Mësuesja* - Po të ishte ti në vendin tim, do ta bëje këtë deponim? (*Sekretarja largohet kokëulur*).
- Hetuesi* - Sigurisht që do ta bënte. Çdo grua e mençur do ta kish bërë. Është një gjë fare e vogël, që do të mbetet midis nesh. Ju e patë vetë. Unë e dëbova kapitenin. I want only to help you.¹⁾
- Mësuesja* - Kjo s'është ndihmë. Është presion, është një torturë shpirtërore. Nuk do ta bëj këtë. (*Çohet*).
- Hetuesi* - (*Çohet*). Uluni aty. Folët për një torturë shpirtërore. E mirë, mësoni se kjo e sotmja është vetëm gërma A e alfabetit të asaj torture. Pa thirrini mendjes! Kini pesë fëmijë të parritur. Ky pohim mua më duhet, më kuptoni. Më duhet! (*zhurmë tek dera, hyn kapiteni*) Ç'po ndodh aty?
- Kapiteni* - Ka ardhur i biri. Është i shqetësuar nga vonesa e saj.
- Hetuesi* - (*Që nuk e përmban veten*). Shporreni! (*Pendohet*). Prit! Ti pse e solle?

1) Dëshiroj vetëm t'ju ndihmoj

- Kapiteni* - Kujtova se mund t'ju duhet.
- Hetuesi* - Më duhet. Zonjë, dëshironi ta tregojmë edhe një herë historinë përpara djalit tuaj?
- Mësuesja* - Oh, jo. Mos! Kjo është e tmerrshme!
- Sekretarja* - Zoti kryehetues, sikur...
- Hetuesi* - Mos më çani kokën. Hë pra zonjë (*heshtje*). Silleni djalnin (*Hyn*). Pa shiko, qenke i rritur. Sa vjeç je?
- Djali* - Pësëmbëdhjetë.
- Hetuesi* - U shqetësove për nënën, ë?
- Djali* - Ç'ka bërë ajo? Pse e keni thirrur këtu?
- Mësuesja* - (*E përtohur*). Ah bir, bir!
- Djali* - Ç'kërkojnë këta njerëz prej teje? Ç'kërkojnë po të pyes?
- Hetuesi* - (*Me qetësi*). Tani ajo nuk ta thotë dot. Ne u nxehëm pak se ajo mbahet krenare dhe kokëfortë. Kurse ti, si djalë i zgjuar që je, mund ta ndihmosh që të bindet se ajo çka kërkojmë prej saj, është një gjë fare e vogël. Mos u tremb, ajo nuk ka bërë asnjë faj.
- Djali* - Këtë e di. Deri më sot ajo vetëm një faj ka bërë.
- Hetuesi* - Një faj? Ç'është ky faj?
- Djali* - Që nuk dha dorëheqjen nga shkolla kur na arrestuan shokët!
- Hetuesi* - (*I habitur*). Si?
- Kapiteni* - Këlysh bushtre! Do të shporrim nga shkolla edhe ty!
- Djali* - Por këtë faj ajo e di, sepse ia kam thënë me kohë.
- Hetuesi* - (*Që e ka mbledhur vefen*). Zonjë, më vjen keq që nuk u morëm vesh në bisedën tonë të parë. S'ka gjë, kemi kohë. (*Kapitenit*). Thuaji shoferit ta çojë në shkollë.
- Mësuesja* - Nuk është nevoja.
- Hetuesi* - Unë e mbaj fjalën. Këtë ua kam premtuar.
- Mësuesja* - Mund t'u çliroj nga ai premtim, meqë s'kam për të shkelur më në atë shkollë. Po të doni njoftoni se kam dhënë dorëheqjen. (*Del*).
- Hetuesi* - (*Nga pas*). Do të ngordhësh për bukë, me gjithë minjtë e tu! Do të hash dhe... Do të... (*Sekretarja i afron gotën me ujë dhe ai e pi pa vëmendje.*)
- Sekretarja* - U ngjirët, u lodhët.

- Hetuesi* - Përkundrazi. Tani jam në formën time më të mirë. Urrejtja e deh njeriun.
- Sekretarja* - Nuk del pak nga metoda juaj kjo, zoti kryehetues?
- Hetuesi* - Vogëlushe, shefi yt ka të drejtë kur thotë se ti e ke gjuhën e gjatë. (I afrohet). Por të bukurave ju falen shumë gjëra. (Sekretarja largohet).
- Kapiteni* - Të vijë ndihmësi im?
- Hetuesi* - Më parë sillni shoferin. (Pauzë. Sjellin shoferin). Hë mor bu-kurosh, si të duket klima këtu brenda?
- Shoferi* - Njëlloj si jashtë.
- Hetuesi* - E di pse janë kaq të ftohta e të ngushta qelitë e burgut?
- Shoferi* - Këtë duhet ta dinë ata që i bëjnë.
- Hetuesi* - Që t'i kujtojnë të arrestuarit dritën, ngrohtësinë dhe komo-ditetin e jetës në liri. Kujtesa i bën pastaj thirrje arsyes.
- Shoferi* - Kjo duhet të ketë efekt tek ata që kanë shijuar komoditetin e jetës jashtë. Unë, zoti hetues, e kam shijuar atë vetëm si qytetar i dorës së dytë.
- Hetuesi* - Vetëm-fjalët që keni thënë këtu, do të mjaftonin për t'u dë-nuar dy herë.
- Shoferi* - Pse, a nuk kemi liri fjale e mendimi?
- Hetuesi* - Por ato ju i keni kuptuar edhe si liri veprimi, si anarki. Ajo ju shpuri në atë veprim kriminal që ka lënduar ndjenjat e ba-norëve të këtij qyteti.
- Shoferi* - Për këtë nuk jam dhe aq i sigurtë.
- Hetuesi* - Mbylle. Hajde, pranoje se ti e zhduke bustin.
- Shoferi* - Pesë herë më keni pyetur, pesë herë nuk e kam pranuar këtë akuzë, s'ka kuptim ta pranoj të gjashtë.
- Hetuesi* - Do ta pranoni, sepse dëshmitarët do t'ju vënë me shpatulla pas murit!
- Shoferi* - Edhe ca dëshmitarë mund t'i gjeni, por edhe unë, po të më lejonit, do të sillja dëshmitarë që të provonin të kundërtën.
- Hetuesi* - Që të provonim, p.sh. se atë natë ju e mbyllët makinën në garazh. E?...
- Shoferi* - Edhe për këtë.
- Hetuesi* - Po, kjo do t'ju lehtësonte shumë, sepse do të dyshohej për një automjet tjetër. Po kush mund ta provojë se ju vërtet e

- mbyllët makinën në garazh?
- Shoferi* - Roja e natës. °
- Hetuesi* - Hëm, po sikur ky të jetë miku juaj, apo më keq. bashkëpunëtori juaj?
- Shoferi* - Mik nuk e kam.
- Hetuesi* - Mos keni pirë ndonjë gotë me të?
- Shoferi* - Rrallë, bashkë me kolegë të tjerë të punës.
- Hetuesi* - Ky njeri është i kombësisë tuaj?
- Shoferi* - Po.
- Hetuesi* - Jo, se mos kujtoni që kemi ndonjë paragjykim në zgjedhjen e dëshmitarëve. (*I bie ziles, hyn ndihmësi me rojen*). Uluni. Formalitete nuk do të bëjmë, sepse është hera e dytë që ju thërrasim për dëshmitar. (*Sekretares*). Lexoni përmbledhjen e dëshmisë së parë.
- Sekretarja* - Dëshmoj nën përgjegjësinë time, se natën e 27 dhjetorit autovinçi i drejtuar nga shoferi... u mbyll në garazh rreth orës 7-të të mbrëmjes.
- Hetuesi* - Firma juaj është kjo?
- Roja* - Hëm, po..
- Hetuesi* - E pohoni prapë se kjo dëshmi është e vërtetë?
- Shoferi* - E vërtetë.
- Hetuesi* - (*Rojës*). A është e plotë?-(*Heshtje*). Keni për të shtuar gjë? Për shembull, ndonjë hollësi që herën e parë nuk e kujtuat?
- Roja* - Kam.
- Hetuesi* - Fol.
- Roja* - Si të them... po atë natë, rreth orës 8, ai u kthye nëgarazh dhe e mori prapë makinën.
- Hetuesi* - Përse i duhej?
- Roja* - Tha se kishte ndodhur një aksident automobilistik në autostradën e Veriut. Duhej nxjerrë një veturë nga kanali.
- Hetuesi* - Pse nuk ia thatë ndihmësit herën e parë?
- Roja* - Si të them, nuk, nuk ...
- Hetuesi* - Nuk ju kujtohej, apo nuk deshët ta kujtonit?
- Roja* - Atë natë ndodhi ngjarja me bustin dhe si të them...Po të tregoja, gjithë dyshimi do të binte mbi të.
- Hetuesi* - Pra deshët ta mbronit. Pse?

- Roja* - Si të them... Epo gjaku s' bëhet ujë.
- Hetuesi* - Pastaj ç' ndodhi?
- Roja* - Pastaj, si të them. u muar vesh që unë u thirra për të dëshmuar dhe ata... më dërguan një letër. kër.. kër.
- Hetuesi* - Kërcënuese.
- Roja* - Ashtu.
- Hetuesi* - Ç'thoshte ajo letër?
- Roja* - Ja, e ka zoti ndihmës.
- Ndihmësi* - (*Lexon*). " Në qoftë se ti do të thuash se autovinçi nuk ka qenë në garazh natën e 27 dhjetorit, do të përfundosh në atë vrimë ku përfundoi busti i strategut". -*Paузë*-
- Hetuesi* - (*Shoferit*). Ke për të bërë ndonjë pyetje?
- Shoferi* - Vetëm një. Si ndodhi që i doli frika se mund të përfundojë atje ku përfundoi busti.
- Hetuesi* - Kjo s' është pyetje. Ti po përsërit kërcënimin e letrës.
- Shoferi* - Vetë më thatë nëse kisha për t'i bërë pyetje.
- Ndihmësi* - (*Rojës*). Hë përgjigju, thuaj ato që më the mua.
- Shoferi* - Ose që ia thatë ju.
- Roja* - Në fillim unë pandehja se ai nuk qe përzjerë, si të them... në këtë krim. Pas kësaj letrë, si të them... e kuptova dhe atëhere si të them, thashë ta kallëzoj.
- Ndihmësi* - Pa marrë parasysh rrezikun.
- Roja* - Ashtu! Sepse si të them, si qytetar i ndershëm, unë krimin e dënoj.
- Shoferi* - Që je një pijanec i neveritshëm, këtë e kam ditur me kohë, por që ke mbaruar fare si njeri, këtë sot e mora vesh.
- Hetuesi* - (*Rojës*). Mund të shkoni. (*Shoferit*). Hë mo bukurosh, do t'i japim fund tani?
- Shoferi* - I japim.
- Hetuesi* - Apo doni ballafaqim me dëshmitarë të tjerë?
- Shoferi* - Boll e keni edhe këtë.
- Hetuesi* - Aq më tepër që ai është i një kombësie me ty.
- Shoferi* - Aq më tepër! Se sikur unë të ngulja këmbë që ky njeri tha vetëm gënjeshtër, ju do të gjenit dy dëshmitarë të tjerë, që të thoshin po ato gënjeshtër. Më mirë le të mbetet ky që ka mbaruar me të gjitha dhe s'ka ç'të prishet më. Kurse të

tjerëve. mund t'u kishte mbetur pak nder dhe ndërgjegje. Po ju do t'i detyronit ta humbisnin edhe atë. S'dua t'i marr në qafë.

Hetuesi - Mjaft dërdëllite. E pranon që e zhduke bustin, apo jo?
-*Paузë-*

Shoferi - Sikur kjo ka ndonjë rëndësi! Mjafton që e pranoni ju, kapiteni!...

Hetuesi - Kriminel dhe racë kriminelësh! Ti do ta pranosh. Ti do të firmosësh këtu. Ti do të jesh i akuzuari kryesor në këtë proces, kemi aq prova, sa mjafton të kalbesh gjithë jetën në burg. Kemi aq prova sa mjaftojnë për të dëbuar gjithë familjen tënde. (*Merr një dosje nga tryeza*). Ja dosja e tët eti. I dënuar, i dëbuar, dy tentativa arratisje nga kampi i punës. Ja dosja e xhaxhait tënd, dosja e kushëririt tënd të parë, dosja e fqinjit tënd, dosja e...

Shoferi - Mëkat që s'kini arkiva më të vjetra zoti hetues, se atëherë do të më tregonit edhe dosjen e gjyshit, të stërgjyshit, të fisit tim, të gjithë qytetit tim! Se kështu ka vajtur kjo punë, more zotëri. Ju jeni munduar të na shfarosni, ne jemi për-pjekur të hedhim farën dhe të jetojmë.

Tabloja e pestë

Kafeneja "Globus" me ndarje të vogla si për bisedime të fshehta. Në sfond një orkestër dhe një këngëtare cigane këndon në gjuhën e saj një këngë të trishtuar. Kronisti dhe sekretarja janë në një ndarje sa më afër paraskenës. Pijnë diçka. Hyn kryetari. Ai përshëndet djathtas e majtas, pastaj ndalon tek ndarja e çiftit.

Kryetari - Ah, ja dhe Romeo e Zhuljeta! Mirëmbërëma pëllumba (*Kronisti dhe sekretarja përshëndetin pak të turbulluar*). Nuk do të më ftoni?

Kronisti - Ne u ulëm sa për një gotë zoti kryetar. Unë duhet të iki shpejt që të filmoj grupin e vallëzimit "Rega".

Kryetari - Po mirë, shkoni... Nuk besoj të bëheni xheloz sikur ajo të

qëndrojë edhe pak me mua. S'më pëlqen të rri vetëm lo-
kaleve.

- Kronisti* - Mirupafshim. (*Del*).
- Kryetari* - Dukeni e zbehtë. Mos keni qenë gjë e sëmurë?
- Sekretarja* - Ka ca kohë që vuaj nga pagjumësia.
- Kryetari* - Janë pasojat e jetës së natës. Më kanë thënë se vini shpesh këtu.
- Sekretarja* - Nuk e kam nga jeta e natës.
- Kryetari* - Ndonjë dramë dashurie? Komplexet e Frojdit? Pse nuk këshilloheni me ndonjë psikoanalist?
- Sekretarja* - S'ka pse të këshillohem përderisa e di nga më vjen. Zyrat e hetuesisë kanë ajër tepër të rëndë për mushkëritë e mia.
- Kryetari* - Eh, e... po ju sikur e morët me qejf!
- Sekretarja* - Vërtet, isha kureshtare. Një budallaqe, ja ç'jam. Ju lutem më hiqni prej andej.
- Kryetari* - Duro edhe pak. Kapitëni më tha se hetimi është në përfundim e sipër.
- Sekretarja* - Ai s'ka për të mbaruar kurrë.
- Kryetari* - Mos flisni marrëzira. Pastaj s'është mirë të largoheni pikërisht tani. Miku ynë i kryeqytetit do ta marrë si dorëheqje nga detyra. Për ju kjo është një provë devotshmërie!
- Sekretarja* - Provë devotshmërie? (*Hyn hetuesi*)
- Kryetari* - A mik, i dashur, mirseerdhët. (*Ulet*). Ç'do të merrni?
- Hetuesi* - Rum (*Pas pak*). Ai kapitëni juaj jo vetëm që është i paaftë, por edhe kokëmish!
- Kryetari* - Ç'thoni? E kemi djalë besnik.
- Hetuesi* - Por flet marrëzira. Ka thënë se fajtori e pranoi krimin dhe se së shpejti do të bëhet gjyqi.
- Kryetari* - Pse, nuk është ai fajtori?
- Hetuesi* - Po kush tha se ai është fajtori? Ai është njëri nga fajtorët... vetëm njëri. Se këtu kemi të bëjmë me një grup të organizuar dhe ka shumë mundësi me një organizatë të tërë politike.
- Kryetari* - Po më habitni.
- Hetuesi* - Dhe organizatat politikë ilegale kanë platforma, kanë programe, kanë një ideologji që i frymëzon, kanë udhëheqje dhe grupet terroriste.

- Kryetari*
Hetuesi
- Mos po shkojmë pak si larg?
 - Pse larg? I tërë ky qytet është si një trup i sëmurë nga virusi i armiqësisë ndaj mbretërisë.
- Sekretarja*
- Nuk vjen në kundërshtim me metodën tuaj kjo, zoti krye-hetues?
- Hetuesi*
Sekretarja
Hetuesi
- Me metodën time? Dhe ku i dini ju metodat e mia, zonjushë?
 - Zvogëlimi i rrethit deri në një bërthamë.
 - Atë do ta bëj! Do ta ndaj kokën nga trupi. Kurse ai idioti mburret se ka arrestuar fajtorin! Një shofer. Duhet ta shkar-koni. Ndhimësi i tij më duket më i aftë. Rojen e përpunoi siç duhet.
- Kryetari*
- Le të mos flasim për kuadrot tona të policisë. Dyshimi juaj për një organizatë i legale më shqetëson shumë më tepër. Jeni i bindur se kemi të bëjmë me një organizatë? Ekziston ajo vërtetë?
- Hetuesi*
- Edhe sikur të mos ekzistonte, duhet ta krijojmë. Besoj se më kuptoni ç'dua të them.
- Kryetari*
Hetuesi
Kryetari
- Por nuk e kuptoj ç'dobi do të kishim!
 - Disa.
 - Asnjë. Është njëqind herë më mirë ta bindim opinionin se këto janë veprime të një ose dy terroristëve dhe se populli e dënon këtë akt. Kjo është një çështje prestigji për mbretërinë tonë.
- Hetuesi*
- Prestigji është njëra anë e medaljes. Ana tjetër është nënshtrimi i qytetit.
- Kryetari*
Hetuesi
- Qetësia e qytetit.
 - Qytetet, si njerëzit, janë të qetë vetëm kur flenë. Duhet një goditje trullësuese që ta paralizojmë forcën dhe gjallërinë e tij.
- Kryetari*
- Ah, sikur kjo të qe e mundur. Ka kohë që po luftojmë për këtë, por më kot.
- Hetuesi*
- Atëherë le ta bëjmë detyrën tonë si ushtarët që në zjarrin e betejës nuk kanë asnjë ndjenjë tjetër veç urrejtjes dhe asgjësimi.
- Kryetari*
Hetuesi
- Ç'kini ndërmend të bëni?
 - Kam një listë të pjesëtarëve të organizatës. Hidhini një sy.

- Kryetari* - (Pa e parë) - Me ndihmën e kujt e keni formuluar?
- Hetuesi* - Të ndihmësit. Kuadër i së ardhmes. Duhet graduar.
- Kryetari* - (Duke e parë listën). Për këtë s'kam kundërshtim. Kurse ky jo, në asnjë mënyrë.
- Hetuesi* - Cili është ky?
- Kryetari* - Poeti.
- Hetuesi* - Po ai është kryesori! Ai është kryetari i organizatës.
- Kryetari* - Mos më përrallisni ëndrra në diell. Ai është i njohur në tërë vendin. Është i njohur jashtë kufijve. E kemi quajtur vlerë të mbretërisë sonë.
- Hetuesi* - Në kemi shumë vlera. Një më pak, ç'punë prish?
- Kryetari* - Jo, është e pamundur. Në këtë qytet, ata e mbajnë si një idhull të tyre.
- Hetuesi* - Prandaj edhe ne duhet t'i hedhim baltë. t'ua përlyejmë. Një idhull në krye të një organizate terroriste! E merrni me mend efektin.
- Kryetari* - (I zënë ngushtë). Ai i kalon kompetencat tona.
- Hetuesi* - Mua më është dhënë letër e bardhë. Kam të drejtë të marr në pyetje cilindo.
- Kryetari* - Por jo dhe të arrestoni cilindo.
- Hetuesi* - Kur provat e fajësisë janë të mjaftueshme, hetuesi mund të propozojë arrestimin.
- Kryetari* - Më hutuat fare. (Pauzë). Jo, nuk mund ta bëjmë. Një autoritet i tillë intelektual...
- Hetuesi* - Procesi im gjyqësor nuk mund të jetë proces shoferash e ku ta di unë. Ata le të jenë, po mua më duhet predikuesi që frymëzon kriminelin. Antikrishti që nxit turmën e verbër. Kandidaturë më e mirë, nuk mund të gjendet.
- Kryetari* - (Me vendosmëri). Poetin do ta marr përsipër vetë.
- Hetuesi* - Në ç'mënyrë?
- Kryetari* - Ka kohë që mendoj për të. Deri tani ai ka qëndruar si midis ajrit dhe tokës. Lavdërimet dhe honoraret i kanë pëlqyer, mirëpo ai ashku i tij patriotik nuk e ka lënë të bëhej tërësiht yni! Kështu tingëllon edhe poezia e tij. Herë është panjërëzore, herë betim ndaj traditave.
- Hetuesi* - Arti s'më ka interesuar kurrë. (Sekretares). Vërtet vlen

- kaq shumë ky kalemxhi, apo shefi juaj ka dobësi për të?
- Sekretarja* - Këtu e duan të gjithë. Arrestimi i tij do të indinjonte jo vetëm ata, por edhe ne. *-Pauzë-*
- Kryetari* - (*Hetuesit*). Shëtisni disa ditë mik i dashur, çlodhuni, argëtohuni! Ju po mundoheni shumë. *-Pauzë-*
Dëgjohet orkestrina dhe këngëtarja cigane.
- Hetuesi* - Vërtet duhet të argëtohem! Ah sikur të qe e mundur të jetoja jetën vetëm kështu... Të humbisja në avujt dehës të kësaj kënge, të shpëtoja prej ankthit që të pushton në këtë qytet, këtë atmosferë të elektrizuar, sikur priten rrufetë. Nuk e di nëse e keni provuar ndonjëherë këtë ndjenjë.
- Kryetari* - Kam dhjetë vjet që po e provoju.
- Hetuesi* - Ju lutem më mbani në korent për atë ... idhullin.
- Kryetari* - Do t'ju vë në dijeni për gjithçka. Mirupafshim. (*Hetuesi del*). Ja dhe një tjetër me trauma psikike.
- Sekretarja* - Dhe erdhi aq i sigurtë.
- Kryetari* - Pa shikoni, mos është poeti ai në kthinën mbas orkestrës?
- Sekretarja* - Ai është.
- Kryetari* - (*Sekretares*). Lajmërojeni. Thuajini se e kam ftuar për pak çaste. (*Pauzë, vjen poeti, sekretarja del. Kënga e ciganes*). Dhe thonë pastaj se artistët nuk janë të përpiktë.
- Poeti* - Me shtetin njeriu duhet të jetë i përpiktë se i pjell belaja.
- Kryetari* - Pra, unë jam shteti.
- Poeti* - Përderisa jeni autoriteti më i lartë në këtë qytet. Përse më kërkuat?
- Kryetari* - Rrini pak çaste. (*Ulet*). Siç duket ju pëlqen muzika cigane.
- Poeti* - Më pëlqen. Është si klithma e një shpirti të lirë që nuk du-ron pranga.
- Kryetari* - Vetëm se liria e tyre është një liri e çuditshme. S'kanë nevojë as për shtet, as për kufi! Të gjitha këto konvencione i shpërfillin.
- Poeti* - Megjithatë, ajo këndon në gjuhën e saj.
- Kryetari* - Ç'doni të thoni?
- Poeti* - Dua të them, megjithëse nuk formuan dot kurrë një shtet, ata e ruajtën me fanatizëm gjuhën, ritet, këngët, zakonet... Ky adhurim, nuk ju prek? *-Pauzë-*

- Kryetari* - Sonte dëshiroj të bëjmë një bisedë serioze.
- Poeti* - Këtu?
- Kryetari* - Pse jo? Zyrat nuk janë për njerëz si ju. Edhe unë në vendin tuaj do të fyhesha po të më thërrisnin në zyrë për një bisedë. Jam i sigurtë se nuk dyshoni aspak për ndjenjat e mia ndaj jush.
- Poeti* - Kemi kohë që njohim njëri - tjetrin, zoti kryetar. S'ka mbetur hapësirë për dyshime.
- Kryetari* - Singëriteti është porta e marrëveshjeve. (Pauzë). E di që keni rënë në një pozitë të vështirë?
- Poeti* - Jo, pse?
- Kryetari* - Sepse gjuhën e artistit nuk e kuptojnë të gjithë njëllorj.
- Poeti* - Unë flas qartë dhe hapur.
- Kryetari* - Jo gjithmonë miku im. Po ju sjell një shembull. Ditën që u përurua busti i strategut, ju keni thënë: "Sa i rëndon dheut ky bust". Është e vërtetë?
- Poeti* - S'më kujtohet. Mund të kem pyetur nga kureshtja.
- Kryetari* - Ama, ka disa njerëz që thonë se ato fjalë janë predha me qitje të largët, e të jemi të singertë, ato mund të kenë disa interpretime.
- Poeti* - Kjo është një shprehje kaq konkrete, sa s'mund të ketë veçse një interpretim: pyetje.
- Kryetari* - "Ah, jo. Se mund të shprehë edhe një dhimbje. " Oh, sa i rëndon dheut ky bust"! Thirrje të tilla patetike janë të zakonshme në gjuhën e një poeti, Mirëpo, a nuk do të që kjo një insinuatë e hapur kundër kujtimit të strategut? Pra edhe kundër veprës së tij kryesore, që ishte bashkimi i qytetit me mbretërinë tonë të madhe?
- Poeti* - Me atë psherëtimën "oh", edhe mund të merret, por unë nuk e kam zakon të psherëtim.
- Kryetari* - Po edhe në qoftë vetëm pyetje, prapë ka disa interpretime. Mund të merret si pyetje me karakter informativ. Domethënë, sa peshon busti që të llogaritim me ç'mjete mund ta shkullim.
- Poeti* - Mirëpo ky interpretim ju duket qesharak, sigurisht.
- Kryetari* - Më vjen mirë që dëgjoj të flisni kështu. Ju jeni një vlerë shtetërore dhe unë s'mund të lejoj që figura juaj të njolloset

duke e vënë përkrah disa kriminelëve ordinerë, disa faqezinjve që ju i përbuzni po aq sa unë. Mirëpo... në këtë mbrojtje që kam marrë përsipër, duhet që edhe ju të më ndihmoni.

Poeti

- Në ç'mënyrë?

Kryetari

- Para se t'ju them, dua t'ju siguroj se kundërshtarët tuaj nuk janë njerëz dosido, por autoritete me peshë. Mund të jenë pak ekstremistë, mirpo në ditët kur gjakrat janë të ndezura, ekstremizmi fiton shpesh mbi arsyen. (Pauzë). Si thoni?

Poeti

- Po pres.

Kryetari

- Çfarë?

Poeti

- Atë që vjen pas hyrjes. Zhvillimin i themi në letërsi.

Kryetari

- Në këto sulme dhe akuza, pozita juaj dhe imja do të ishin shumë më të lehta e të favorshme, sikur ju, ashtu si mjaft intelektualë të tjerë të qytetit, të kishit bërë një deklaratë në shtyp ose në radio, apo më mirë një intervistë në TV ku të dënonit aktin e shëmtuar të zhdukjes së bustit. Ju fola hapur. S'ka ku të vejë më hapur.

Poeti

- Sinqeritetit tuaj nuk dua t'i mbetem borxh. Shkaku që nuk e kam bërë një deklaratë të tillë, është se shpirtërisht, unë kam qenë edhe jam kundër vendosjes së atij busti në piedestalin ku qyteti mbante simbolin e tij të vjetër.

Kryetari

- Pse nuk e thatë më parë?

Poeti

- Është një liri që mund të ketë disa pasoja.

Kryetari

- Na kemi shtyp të lirë... Dhe ç'ndodhi në fund të fundit? U hoq një simbol i mbetur nga epokat primitive që s'përfaqësonte asgjë.

Poeti

- Por qyteti atë e adhuronte...

Kryetari

- Një mistifikim i kotë. Nuk ia vlen të adhurosh vjetërsira të tilla.

Poeti

- Ju nënën tuaj e doni se e keni nënë, apo se e keni të veshur me rroba të bukura e të shtrenjta?

Kryetari

- Nuk ju kuptoj.

Poeti

- Se njeriu e do nënën e tij edhe kur është veshur me rreca. (Pauzë).

- Kryetari* - Vendosja e bustit të strategut ka qenë një dëshirë e hershme e qytetarëve!
- Poeti* - Ku u shpreh? Mos vallë u bë ndonjë anketim? Jo, zoti kryetar, asgjë nuk u bë. Shpesh herë, në histori, prapa të ashtuquajturit vullnet i lirë i qytetarëve, janë fshehur vendime administrative të errëta dhe antipopullore
- Kryetari* - Po flisni pa menduar.
- Poeti* - Po them atë që kam menduar me kohë. Zhdukja e bustit, a nuk tregon zemërimin e kundërshtimin e qytetit të fyer në ndjenjat e veta?
- Kryetari* - Veprimi i një bande kriminele, nuk shpreh kurrë vullnetin e shumicës.
- Poeti* - Ajo që ndodhi është hakmarrje e qytetit.
- Kryetari* - Hakmarrja është një pasion shkatërrues. Hakmarrja pjell hakmarrje. Asgjë s'mund të zgjidhet me të. Ajo krijon një rreth vicioz, prej të cilit s'mund të dilet.
- Poeti* - Kur njeriut i mbushet shpirti me vrer e urrejtje, ai del nga çdo rreth vicioz ..
- Kryetari* - Arti, të cilit i shërbeni, duhet t'ju çojë në rrugën e urtësisë e të arsyes njerëzore dhe jo në rrugën e egërsisë e të shfrimit të pasioneve.
- Poeti* - Para se t'i shërbej artit, unë u shërbej njerëzve të mi. Atyre u është bërë një fyerje e madhe. Simboli i qytetit ka qenë vazhdimisht brenda gjakut dhe jetës së tyre. Ata nuk mund të ndërrojnë gjakun. Heqja e një simboli dhe vendosja e një tjetri, nuk mund të ndërrojë as historinë, as realitetin dhe as ndjenjat e qytetit.
- Kryetari* - Vendosja e bustit, s'ka aspak këtë qëllim.
- Poeti* - Popujt e lindjes kanë një gojëdhënë: "Njëri fjeti një natë në një han dhe nguli në mur një gozhdë. Pse e ngule, i thanë? Që nesër të kem edhe unë pjesën time në këtë han, sepse kam ngulur një gozhdë, tha".
- Kryetari* - Ju ftova të bisedonim e t'ju jepja disa këshilla si mund të mbrohemi nga një akuzë e rëndë. Për fat të keq, shoh se jo vetëm që nuk doni të mbrohemi, por përkundrazi, doni të sulmoni, të viheni në rolin e martirit. Mbrojtja ime

s'ka kuptim, se martirët s'kanë nevojë për mbrojtje . Atëherë keni dy rrugë. Ose të bëni një deklaratë publike, ose të përgjigjeni para drejtësisë.

Poeti

- Për pyetjen "Sa i rëndon dheut ky bust"?

Kryetari

- Për të gjitha. Për mëkatet e vjetra që ua kemi falur në heshtje, për simbolikën e errët të poezive, për ironinë që nuk e keni kursyer ndaj monarkisë sonë, për pikëpamjet politike që keni shprehur andej-këndej.

Poeti

- Për qumështin e nënës që kam pirë, por që s'duhet ta pija! Për ajrin e maleve të mia që kam thithur, por që s'duhej ta thithja. Për bukën e arave të mia që kam ngrënë, por që s'duhet ta haja. Për vëllezërit e motrat që kam dashur, por që s'duhet t'i doja...

Kryetari

- Mjaft, durimi im ka një kufi! Pas dy ditësh, pres një deklaratë.

Poeti

- Ju e dini që tani se atë deklaratë s'keni për ta marrë kurrrë.

(Kryetari largohet. Poeti ecën drejt ciganes. që rífillon këngën e saj).

Tablo e gjashtë

Zyra e hetuesisë. Natë. Disa projektorë janë përqendruar mbi shoferin. Në fytyrën dhe qëndrimin e tij duken gjurmët e torturave. Sekretarja në tavolinën e saj ka një abazhur të vogël. Kryehetuesi dhe ndihmësi vërtiten si hije.

Hetuesi

- *(Sekretares)*. Lexo deponimin që pandehuri ka firmosur dje.

Sekretarja

- *(Me zë të lodhur)* "Si shumë banorë të këtij qyteti, unë kam qenë kundër vendosjes së bustit të strategut".

Hetuesi

- Këtë pohim e ke bërë disa herë. Kështu?

Shoferi

- Mund ta bëj sa herë të doni... Kam qenë dhe jam kundër vendosjes së bustit.

Hetuesi

- Derisa ke qenë kundër; domethënë ke qenë i gatshëm

për ta zhdukur.

Shoferi
Hetuesi

- Kur të hyn një halë në sy, do ta heqësh, s'ke ç'bën.
- Ja, më në fund po tregoheni i mençur. (*Sekretares*) Atëherë fillojmë me deponimin tjetër. Natën e 27 dhjetorit, ora njëzet e tre e tridhjetë, bashkë me katër veta të organizatës "Shpendi i gjakut", mekaniku i garazhit, inxhinieri i ujërave, studenti i filologjisë dhe fshatari që banon pranë kënetës... (*Heshtje. Ia ngre kokën duke e kapur për flokësh*). Pohoje që janë ata.

Shoferi

- Derisa i keni arrestuar, ata duhet të jenë. Ç'ta përsërit më kot!

Hetuesi

- Vazhdojmë (*Sekretares*). Ne të pestë u ngarkuam nga organizata për të zhdukur bustin.

Shoferi

- Jo, kjo nuk është e vërtetë.

Hetuesi

- Ti porsa e pranove.

Shoferi

- Pyetja juaj ishte ndryshe. Ju më pyetët: "A keni qenë i gatshëm për ta hequr bustin."

Hetuesi

- Kjo është e njëjta gjë.

Shoferi

- Pse, e njëjta gjë është sikur unë t'ju vras me mend dhe t'ju vras me një plumb në ballë?

Hetuesi

- (*inxehur*). Kriminel dhe bir krimineli! Në trurin dhe në gjakun tënd rron vetëm instinkti i vrasjes.

Shoferi

- I vetëmbrojtjes, zoti hetues. Të mbrosh veten kur duan të të zhdukin, nuk është krim.

Hetuesi

- Pusho! (*Ia çon kokën*). Fol, për ndryshe do të të çoj prapë në atë dhomë e vogël. Aty dhe djallit, po t'i bënin një trajtim special, do ta nxirrnin shenjtor. Thuaj: "Jam pjesëtar i organizatës terroriste "Shpendi i Gjakut".

Shoferi

- Jo.

Hetuesi

- "Jam pjesëtar i organizatës ...

Shoferi

- Jo.

Hetuesi

- Jam...

Shoferi

- Nuk jam. (*Shoferi çohet me zor*).

Hetuesi

- Ku vete?

Shoferi

- Në dhomë. Këmbët më mbajnë akoma, pse të lodheni si dje kur më tërhoqët zvarrë.

- Hetuesi* - Do të të zbutim, mos u bëj merak! Do ta thyejmë atë shpirtin tënd rebel. Ti do t'i pohosh të gjitha ato që më duhen mua, përndryshe do të të bëjmë të hiqesh zvarrë e të lëpish gjakun tënd. Gjakun do të ta lëmë edhe për të ngopur urinë edhe për të shuar etjen. Fol! (*Sekretares*) Ti, shkruaj. (*Shoferit*). Kush bën pjesë në organizatën komplotiste "Shpendi i Gjakut"? Fol, në krye të organizatës tuaj është poeti?
- Shoferi* - Nuk është e vërtetë.
- Hetuesi* - "Poeti është udhëheqësi kryesor yni"!
- Shoferi* - Në qoftë se e keni fjalën për intelektualët tanë, ai vërtet është më i shquari yni.
- Hetuesi* - Ai është në krye të terroristëve. Ti, ose do të deponosh këtë, ose s'ke për ta parë më dritën.
- Shoferi* - Pse, dritë është kjo? -*Pauzë*-
- Hetuesi* - Silleni. (*Futin të fejuarën e shoferit*). E njihni?
- E fejuara* - Po.
- Hetuesi* - E dashuroni?
- E fejuara* - Jam e fejuara e tij.
- Hetuesi* - Kur do të martoheni?
- E fejuara* - Pas tre muajve.
- Hetuesi* - Nuk keni hequr dorë nga kjo dëshirë?
- E fejuara* - Kurrë.
- Hetuesi* - (*Shoferit*). Po ti? (*Heshtje*). Le që kot pyeta. Kjo vajzë ngjason me shpërthimin e pranverës pas dimrit të gjatë. Ajo është si një thirrje për të jetuar me të gjitha ndjenjat. Apo jo zonjushë?
- Sekretarja* - (*E hutuar*). Mua m'u drejtuat?
- Hetuesi* - (*I pakënaqur. Ulet*). Ku ju fluturon mendja? Jeni këtu për të ndihmuar. (*Vajzës*). Është krejtësisht në dorën e të fejuarit tënd, që martesë juaj të bëhet, pas tre ditëve, ose pas tri-dhjetë vjetëve. (*Heshtje*). Hë, flisni. Bëjini thirrje dashurisë së tij, bindeni. (*Heshtje*). E shikoni si është katandisur? Një kufomë e gjallë.
- E fejuara* - Atëherë ç'kërkoni më prej tij?
- Hetuesi* - Të bëhet i arsyeshëm, të dëgjojë këshillat e mia. Është i ri, do ta marrë veten shpejt, do të bëhet siç ka qënë dhe ju do ta doni prapë.

- E fejuara* - Unë e dua edhe tani! (*Shoferit*). Unë të dua siç ke qenë dhe siç je. Po të bëhesh ndryshe. do të të urrej Dëgjon? Do të të urrej. Po unë e di. Ti nuk mund të jesh ndryshe. (*Çohet*). Ai nuk mund të jetë ndryshe.
- Hetuesi* - Qërohu! (*Vajza del. Ndihmësit*). Ajo është e dyshimtë. Futeni në listat tuaja, sillni të atin. (*Sekretares*). Ç'keni, nuk ndiheni mirë.
- Sekretarja* - Po, mund të shkoj?
- Hetuesi* - (*Nxjerr një qetësues*) - Jo, pijeni këtë se do të qetësoheni. (*Hyn babai*). A! Ja dhe zotëria e tij, babai i dhimbshur! Mësuësi, edukatori i pinjollit të vet të denjë. Si ju duket djali juaj?
- Babai* - Ashtu siç kam dashur ta shoh, more zotëri i largët.
- Hetuesi* - Do ta shikoni akoma më të bukur.
- Babai* - Sido që ta bëni, babai e njeh djalin.
- Hetuesi* - Keni djem të tjerë?
- Babai* - Nuk kam. Dhe këtë e kam ruajtur si sytë, se do të më mbajë oxhakun hapur.
- Hetuesi* - Të dhimset e ardhmja e fisit tënd?
- Babai* - Më dhimbset more zotëri i largët, nuk e mohoj, po ca më shumë më dhimbset historia e fisit. Në katër breza, dhjetë burra si dhjetë lisa, i ka rrëzuar plumbi. Tani luftrat nuk bëhen si më parë, por prapë luftra janë. Po të jetë ky i njëmbëdhjeti, unë do t'i them, hallall gjakun
- Hetuesi* - Prej teje nuk prisja gjë tjetër. Të thirra që të shoh, deri ku mund të arrijë urrejtja e këtij qyteti.
- Babai* - Ky qytet nuk urren, more zotëri i largët. Njerëzit e tij janë të butë dhe paqësorë. Vetëm një të keqe kanë. Nuk dërojnë t'u hipë njeri mbi shpinë.
- Hetuesi* - Qërohu! Nuk prisja gjë prej teje, desha të shoh vetëm deri ku arrin urrejtja juaj! (*Kapitenit*). Merreni të burgosurin, bëni ç'të doni, bëni ç'të mundni, këtë ujë unë e dua të zbutur.

(*Pauzë. Hetuesi vjen rotull, shtëmgon tëmthaf. Skena errësohet. Hyjnë njëri pas tjetrit të akuzuarit e tjerë. Hetimi është shumë i shpejtë, i tensionuar. Ndrriçohen vetëm të akuzuarit*).

- Hetuesi* - Ti je inxhinieri?
- Inxhinieri* - Unë!
- Hetuesi* - Domethënë ti je ai që bëri projektin e zhdukjes së bustit?
- Inxhinieri* - Unë projektoj vetëm ura.
- Hetuesi* - Ke projektuar dikur. Tani si anëtar aktiv i organizatës terroriste "Shpendi i Gjakut" vetëm i shkatërron. Ti e projektove zhdukjen e bustit?
- Inxhinieri* - Kjo s'ka nevojë për ndonjë projekt. Çdo qytetar mund të shpikë ndonjë mënyrë për ta bërë!
- Hetuesi* - Qenke mjaft i dobët fizikisht. (I afrohet). I sëmurë?
- Inxhinieri* - Nuk qahem.
- Hetuesi* - Edhe i moshuar, plak njeri. Pandeh se mund t'i durosh burgjet e internimet?
- Inxhinieri* - E shoh se po kujdeseni shumë për jetën time.
- Hetuesi* - Poeti është kryetari juaj?
- Inxhinieri* - Poeti është një nga krenaritë e këtij qyteti. Në qoftë se e kuptoni kështu fjalën kryetar, s'jam kundër.
- Hetuesi* - Edhe që të zhduket busti, nuk ke qenë kundër?
- Inxhinieri* - Kam qenë kundër heqjes së simbolit të qytetit. Të tjerat s'më interesojnë.

Ndriçim tjetër

- Hetuesi* - Ti?
- Studenti* - Student i fakultetit të filologjisë.
- Hetuesi* - Ke marrë pjesë në turbullirat e vjeshtës?
- Studenti* - Si gjithë të tjerët.
- Hetuesi* - Ç'ke bërë gjatë tyre? Je anëtar i organizatës "Shpendi i Gjakut"?
- Studenti* - Nuk kam lexuar në shtyp për ndonjë organizatë me këtë emër. Me se merret ajo, me gjueti?
- Hetuesi* - Bandit! Të pret gjyqi! Të pret burgu, internimi në minierat e kripës, të pret vdekja e përditshme dhe e ngadalshme.

Pikë tjetër ndriçimi

- Hetuesi* - Ti! Ku punon?
Nëpunësja - Kam punuar dikur në Bashkinë e qytetit. Tani jam pa punë.
Hetuesi - Pse?
Nëpunësja - Më kanë pushuar.
Hetuesi - A! Domethënë ti je ajo nëpunësja që gjatë turbullirave të vjeshtës fshehe banditët në shtëpi...
Nëpunësja - Unë strehova dy vajza të plagosura.
Hetuesi - I strehove dhe i fshehe nga policia.
Nëpunësja - Pse, mos vallë duhet t'i lija që t'i vrisnin me shkopinjte e tyre?
Hetuesi - Pusho! Do të kalbesh edhe ti në burg si të tjerët.
Nëpunësja - Unë do të jetoj e do të pres bashkë me të tjerët.
(I drejtohet një fshatari)
Hetuesi - Po ti more leckaman?
Fshatari - O! Fyerje kjo zoti hetues! Këtë veshje më ka dhënë Bashkia mbretërore. Kjo është uniforma jonë.
Hetuesi - Ç'rrugë pastron?
Fshatari - Autostradën perëndimore, në hyrje të qytetit.
Hetuesi - Natën fshin?
Fshatari - Sipas rregullave.
Hetuesi - E pe shoferin me autovinç?
Fshatari - Kur kalojnë makina, unë ia mbath në trotuar, se mos më shtyp ndonjë rrotë.
Hetuesi - Kurse unë them, që mos të të shtypë ndonjë rrotë më e madhe, ti duhet të pranosh, se natën që u zhduk busti, ishe në ndihmë të grupit terrorist.
Fshatari - Vajta aty vallë?
Hetuesi - Vajte.
Fshatari - E po mirë, më shtoni edhe mua aty se më bëni nder...

Pikë tjetër ndriçimi

- Hetuesi* - Ti dhe ti.
- I pari* - I papunë.
- I dyti* - I papunë.
- Hetuesi* - Do të keni punë, të lehtë, me fitime të mira. Ju pëlqen?
- I pari* - Epo, ta merr mendja.
- I dyti* - Të thëm të drejtën jam mërziur pa punë.
- Hetuesi* - (*Ulet*). Atëherë pranoni se bëni pjesë në organizatë. Dënimi juaj do të jetë sa për sy e faqe.
- I pari* - E sigurtë kjo?
- I dyti* - E garantuar?
- Hetuesi* - E sigurtë dhe e garantuar. Do të thoni se kryetari juaj është poeti.
- I pari* - Poeti? Ai kryetari?
- I dyti* - S'më duket kushedi çfarë burri.
- Hetuesi* - Ai duhet të jetë.
- I pari* - Mbaj mend. më kanë premtuar punë dhe herë të tjera. Pō ty?
- I dyti* - Vërtet. Dhe ne s'kërkonim kushedi çfarë pune. Zanatin tonë.
- I pari* - S'na doli gjë.
- I dyti* - Asgjë.
- Hetuesi* - Këtë herë ju premtoj unë. Unë jam ndryshe.
- I pari* - Të gjithë thonë: "Unë jam ndryshe".
- I dyti* - Dhe pastaj dalin ndryshe.
- I pari* - S'kemi gjë.
- I dyti* - S'kemi gjë.
- Hetuesi* - Pushoni ! Ne e dimë, edhe ju keni ndihmuar për zhdukjen e bustit. Do t'ju marr shpirtin. Do të jap urdhër t'ju tredhin.

Pikë tjetër ndriçimi

- Hetuesi* - Ti. Dil në dritë se nuk të dalloj se cili je.
- Mekaniku* - Jam unë, mekaniku i garazhit të autovinçave.
- Hetuesi* - Sa fëmijë ke?
- Mekaniku* - Tetë.
- Hetuesi* - Në ç'moshë?
- Mekaniku* - I vogli 12 ditësh, i madhi 12 vjeç.
- Hetuesi* - Eshtë keq kur fëmijët mbeten për një kohë të gjatë pa kujdesin e babait. Psikologët thonë se babai është shtylla morale e familjes
- Mekaniku* - Ashtu duhet të jetë.
- Hetuesi* - Djemtë mund të bëhen hajdutë xhepush, vajzat narkomane e të përdala.
- Mekaniku* - Këto vese nuk i kemi për fis, prandaj nuk trembem dhe aq.
- Hetuesi* - Ti ke thënë se ke pasur shok të ngushtë shoferin.
- Mekaniku* - Dhe e kam.
- Hetuesi* - Ç'të lidh me të?
- Mekaniku* - Shpirti dhe zemra.
- Hetuesi* - Ti ke qenë dora e tij e djathtë natën e krimit. Ai e ka pohuar. Zërin e tij e kam të inçizuar.
- Mekaniku* - Nuk para u besoj aparateve. Sikur të ma thoshte me gojën e tij, do ta pranoja menjëherë. Se edhe më ka marrë malli ta shoh.
- Hetuesi* - Do të kesh kohë të çmалlesh. Do t'ju lëmë aty të çmalleni deri sa te vdisni.

Pikë tjetër ndriçimi

- Fshatari* - Më ndje zotëri. Kam kohë që të dëgjoj! Më duket se këtyre njerëzve u bie kot në qafë. Atë gurin që thua ti zotëri e kam marrë unë?
- Hetuesi* - Ti?
- Fshatari* - E! Nuk e ke llafin për një gur të madh pranë kënetës?
- Hetuesi* - Për bustin e strategut.
- Fshatari* - Ti quaje si të duash. Atë gurin që thua ti e mora unë për shtëpinë që po ngre.
- Hetuesi* - *(I hutuar)*. Si e more? Me se e more?
- Fshatari* - E tërhoqa me gomar. Kam gomar të fortë unë.
- Hetuesi* - Pushoni! Pushoni! Heshtni! Zhdukuni! Do të dënoheni të gjithë si kriminelë politikë. A, jo, s'ka krim ordiner këtu, ka vetëm krime politike. Do të kalbeni burgjeve, do të ngordhni... *(Zëri i meket. Errësohet. Të arrestuarit zhduken dhe ndriçohet skena)* Ç'është kështu? Kam 20 vjet hetues dhe s'më ka ndodhur asgjë e ngjashme. Kjo është skandaloze. Krimin nuk e kam bërë, po të kisha rast, do ta bëja. Të gjithë e mohojnë dhe të gjithë e pohojnë. Çmenduri! Qyteti duhet vënë i gjithi në pranga. *(Hyn ndihmësi)*. Po ti? Ç'do? Ç'është ajo fytyrë gjoja e pikëlluar? Duket sikur të vjen keq për disfatën time, hë? Nuk të doli profecia, - thua ti. Rrethi i të dyshuarve nuk u zvogëlua siç parashikohej, por u rrit dhe përfshiu gjithë qytetin. Kështu thua ti turidhelpër? Kënaqu maskara, se nesër e kam radhën unë. Do t'ju arrestoj të gjithëve. Ministri i Punëve të Brendshme do ta marrë vesh me fakte se fajtorët kryesorë për këtë situatë jeni ju... Pikërisht ju syleshë, impotentë, frikacakë, të qullët e të paaftë. Do të shkarkoheni të gjithë nga postet...
- Ndihmësi* - Zoti hetues, më ndjeni, por kam diçka tjetër tepër urgjente.
- Hetuesi* - Ç'ka ndodhur?
- Ndihmësi* - Ai... nuk do të mundë, nuk mund të paraqitet në gjyq.
- Hetuesi* - E keni dërmuar në torturë, ë? Thirreni mjekun menjëherë...

- Ndihmësi* - Kam frikë se mjeku s'ka ç'të bëjë më. *(Pauzë)*.
- Hetuesi* - I çmendur. Këtë s'duhet ta kishe bëre. Kjo s'duhej të ndodhte.
- Ndihmësi* - Kësh pandehte se ai do të qe aq pak rezistent!?
- Hetuesi* - Eshhtë një marrëzi, si çdo gjë tjetër që bëni ju në këtë qytet. Ti do ta paguash shtrenjt. Thuaj lamtumirë karrierës. *(Pauzë)* Lajmëro mjekun ligjor. të përpilojë aktin e vdekjes. Të vetëvrasjes.
- Ndihmësi* - Vetëvrasje? Po si? Me ç'mjete?
- Hetuesi* - Atë le ta gjejë mjeku. Për këtë paguhet! *(Ndihmësi del)*. Duhet të iki nga ky qytet, sa më parë! Sa më parë! Që tani. Hakmarrja e tij, kushedi ku më përgjon. Ajo nuk njeh mëshirë. Të iki. Të iki. *(Del)*

Tabloja e shtatë

Zyra e kryetarit e përgatitur për një filmim televiziv. Kamerat, ndriçuesit etj. Kronisti, dy kameramanë, gazetari dhe mjeku i burgut që rri në një kolltuk të veçuar. Herë pas here ai hap një dosje dhe e mbyll.

- Gazetari* - *(Mjekut)*. Gjatë filmimit, atë dosje nuk do ta mbani me vete.
- Mjeku* - Si, pse?
- Gazetari* - Sepse dukeni si një nxënës para provimit të mësuarpërmendsh.
- Mjeku* - *(I prekur e i nxehur)* Djalë i mbarë, unë jam mjek burgjesh e jo artist filmi. Po të keni për të çarë ndonjë kufomë, atëherë më thërrisni mua dhe do të shihni se si e përdor thikën. Këtu, përpara atyre gërvëreve e shtrake-shtrukeve të makinerisë, unë e humbas toruan fare, kurse në letër i kam të gjitha të shkruara me termat e duhur shkencorë.
- Gazetari* - Eksperti që lexon, nuk mund të jetë bindës.
- Mjeku* - E marrtë djalli këtë punë! Vdisnin edhe më parë, por s'kishim nevojë të përdridheshim kështu si kurvat.

- Gazetari* - Me sa duket juve nuk ju kanë udhëzuar si duhet!...
(*Hyn kryetari dhe sekretarja* e tij. Kronisti lë kamerën mënjanë dhe bashkohet me të.*)
- Kryetari* - (*Me një farë humori*). Miqtë e mi, ma paskeni bërë zyrën si han.
- Gazetari* - (*Tregon kameramanët*). Janë marifetet e tyre.
- Kronisti* - Besoj se ju do të qëndroni tek tryeza juaj e zakonshme, zoti kryetar. Uluni pak, ju lutem sa të përcaktojmë ndriçimin.
(*Kryetari ulet*)
- Kryetari* - Pa t'i shohim pak ato pyetjet që keni ndërmend të bëni?
(*Gazetari i zgjat një letër, kryetari duket i pakënaqur*). A, jo, jo!
Ja, këto pyetje tani janë të kota, fare pa vlerë!
- Gazetari* - (*I habitur*). Si është e mundur? Gjithë opinioni publik pret nga ju një deklaratë për zbulimin e grupit të kriminelëve.
- Kryetari* - Për këtë do të flasim sa më pak.
- Gazetari* - Për gjyqin që pritet të hapet...
- Kryetari* - Gjyqi do të shtyhet.
- Gazetari* - Deri kur?
- Kryetari* - Derisa të gjenden dëshmitarët e përshtatshëm për të arrestuarit. Nuk duhet të përsërisim gabimet e hetuesit të mëparshëm.
- Gazetari* - Ai njeri s'më pëlqeu kurrë. Ishte shpërfillës dhe i sigurtë në vetvete si një magjistar.
- Kryetari* - Prandaj dhe u hoq... Sidoqoftë... ishte kuadër i aftë. Por kanë dështuar edhe kuadro më të aftë se ai. Hetuesi i ri më duket i arsyeshëm... (*Pas pak*). Pika nevralgjike e intervistës sonë do të jetë tjetër gjë. Vdekja e shoferit.
- Gazetari* - Nuk mjafton dëshmia e komisionit mjeko-ligjor?
- Kryetari* - Nuk mjafton. Elementët turbullues kanë përhapur shpifje, sikur ai vdiq gjatë torturave. Kjo i ka ndezur gjakrat.
- Gazetari* - Më falni, zoti kryetar, mos vallë mendoni se ne e kemi në dorë t'i parandalojmë turbullirat?
- Kryetari* - Po të mendoja kështu, do të isha sylesh! Ne kemi në dorë t'u regojmë autoriteteve në kryeqytet se e kemi bërë detyrën tonë. Tani mund të filloni.
- Gazetari* - Sikur të fillonim me atë mjekun...

- Kryetari* - Ajo fytyra e tij prej babaxhani do të bëjë pershtypje të mirë.
- Gazetari* - Vetëm se është shumë i trashë Mezi lidh dy fjalë.
- Kryetari* - Ç' duhen më shumë për një mjek burgu?
- Gazetari* - (Mjekut). Afrohuni, do të bëjmë një provë Rrini ashtu qetë. Ruajeni atë shprehje të pikëlluar të fytyrës (Nga kamerat). Dhe tani le të dëgjojmë kryetarin e komisionit mjeko - ligjor. Doktor. Opinioni publik i këtij qyteti dhe i mbarë vendit është i tronditur nga lajmi i vdekjes së shoferit. Kjo është një ndjenjë e natyrshme, sepse. pavarësisht akuzës që i bëhej në burgjet e një shteti të lirë si ky yni. nuk lejohet të ndodhin aksidente të tilla që lënë shkas për dyshime. Ç' mund të na thoni ju për shkaqet e kësaj vdekjeje?
- Mjeku* - Më datën 16 mars, ora 17 e 20. më thirrën në burg për një urgjencë. Në orën 17 e 26, u ndodha në dhomën e 38-të, ku mbahej i arrestuari në fjalë. Në atë moment ai gjendej i shtrirë, me një pamje tipike asfiksie dhe me shenjat e dukshme të një litari, sajuar prej bezeje të fortë. në fyt. Që të shprehemi me gjuhën e medicinës... (nxjerr letrën dhe i hedh një sy vjedhurazi. Zëri i tij sfumohet)
- Sekretarja* - (Kronistit) Si është e mundur? Si është e mundur?
- Kronisti* - Çfarë?
- Sekretarja* - Gjithë ky trillim i ulët. O Zot! Përse duhet vazhduar?
- Kronisti* - Mos u bëj naive. Ç'ke kështu? Ti dukesh krejt e zbehtë. Mos je sëmurë?
- Sekretarja* - Të gjithë jemi të sëmurë. Nga një marrëzi absolute. Nga fiksimi për t'u bërë zotër në këtë shtëpi të huaj nga urrejtja e verbër për ta...
- Kronisti* - Ule zërin, këto që thua janë të rrezikshme.
- Sekretarja* - Tani nuk duroj dot më. Ka kohë që nuk fle. Trembem nga makthet e gjumit, më vijnë klithma nëpër ëndërr.
- Kameramani* - Qetësohu! Tani mbaroi gjithçka. Ne do të martohemi dhe unë do të të heq nga ky ferr...
- Sekretarja* - Vërtet mendon se ne do të kthehemi në jetën tonë normale?
- Kronisti* - Sigurisht! Dashuria i përjashton kujtimet e së djeshmes. Dashuria është vetëm e sotme.

- Sekretarja* - Çka na duhen fjalët e bukura, kur mua sa herë përmendet shoferi, më duket vetja bashkëfajtores në vrasjen e tij!?
- Kronisti* - Ai vrau veten. Dëgjon? Vrau veten! Në rast se do të jetosh me mua, këtë duhet ta ngulësh mirë në kokë.
(*Sekretarja ul kokën*)
- Kryetari* - (*Mjekut*). Ato termat shkencorë, mos i thoni. Të flisni si në fillim, me bindje dhe po me këtë keqardhje në fytyrë...
(*Hyn poeti*)
- Poeti* - Më falni. Kisha dëshirë të merrja pjesë edhe unë në këtë konferencë shtypi. (*Pauzë. Të gjithë stepen*).
- Gazetari* - Ju? Dhe në emër të cilës gazetë? Kë do të përfaqësoni ju këtu? Apo gazetat e ndonjë shteti tjetër?
- Poeti* - A thua jeni aq i pavarur sa të vendosni ju për këtë?
- Kryetari* - Ejani, ejani! Ç'ke për të thënë?
- Poeti* - Dy fjalë... mënjanë. (*Tërhiqen anash*). Më kërkuat para pak kohe një deklaratë...
- Kryetari* - Po, po...
- Poeti* - A nuk do të qe e përshtatshme ta bëja sot këtu!?
- Kryetari* - (*Ikënaqur*). E prisja këtë kthesë. Nuk kishte kuptim ndryshe. Jeta është gjithnjë më e bukur sesa ëndërrimet prej martiri. Vetëm se, duhet të dini që kemi një trasmentim televiziv të drejtpërdrejtë.
- Poeti* - Dyshoni në aftësitë e mia prej oratori?
- Shefi* - Përkundrazi! (*Rreh shuplakat*) Qetësi. Do të bëjmë një ndryshim të vogël, por tepër të rëndësishëm në program. Poeti ynë i shquar, dëshiron të bëjë një deklaratë ku do të dënojë krimin e natës së 27 dhjetorit. (*Poeti vete tek podiumi. Ndriçohet vetëm figura e tij*).
- Poeti* - Të nderuar zotërinj. Këtë deklaratë unë duhej ta kisha bërë kohë më parë, fill pas ngjarjes së 27 dhjetorit. Deri tani unë kam heshtur, mirëpo heshtja merret gjithmonë me dy kuptime dhe shpjegohet sipas interesit të atij që e interpreton. Ne të gjithë jemi nënshettas në të njëjtën mbretëri. Historia na ka vënë nën këtë çati të përbashkët. E pranojmë, historia nuk është treguar gjithnjë mëmë e drejtë për njerëzit. Disa i ka ledhatuar, disa i ka rrahur si njerë. Sidoqoftë, sot kudo

flasin me të madhe që në këto bashkësi kombesh duhet të zotërojë barazia e harmonia që të gjitha kulturat, gjuhët dhe zakonet, ajo që quhet bota e veçantë e shpirtave të kombit, të respektohen e të zhvillohen.

Mbretëria jonë, me gojën e zëdhënësve të saj zyrtarë, e ka thënë botërisht se këto çështje i ka zgjidhur më së miri. I lumtë! Se që ta themi troç, sot në botë, ka plot shtete që këto çështje të brishta i zgjidhin me kërbaç e me plumb. Por nuk janë pak edhe ata teoricienë që thonë s e... do të ishte më mirë sikur shoqëria njerëzore të mos çante kokën fare për konvencione të tilla si komb, kombësi e ku ta di unë ç'tjetër gjë, që në botën tonë moderne tingëllojë anakronike të kota, si atavizmat. Mirëpo, si t'ua bëjmë atyre njerëzve të thjeshtë, pa shumë shkollë, por edhe plot të tjerëve me shkollë, që i kuptojnë gjërat ndryshe dhe që duan t'i mbeten besnikë adhurimit të fisit të tyre, lashtësisë dhe monumenteve të saj? Dhe s'janë pak, por turma të tëra. Ja, një prej tyre ishte shoferi, zhdukësi i bustit, për të cilin mjekësia jonë ligjore na sqaroi qetësisht se ka vrarë veten. Disa thonë se me të ishin dy-tre terroristë, disa një organizatë e tërë, pikat mbi i t'i vërë konferenca e shtypit. Sa për mua, unë jam bindur se në këte ngjarje me bustin, ka gisht i tërë ky qytet! Ai dhe vetëm ai, qyteti i tërë duhet të përgjigjet për këtë veprim në bankën e akuzës. Mirëpo zotërinj a mund të ketë sallë gjyqi që ta marrë brenda të gjithë qytetin? Kuptohet, ky gjyq s'është as i lehtë dhe as pa rreziqe, ca më tepër, kur pas çdo gjyqi duhen dhënë dënime. Ç'na mbetet të bëjmë? A nuk do të ishte më mirë t'ia lëmë vetë qytetit që t'ia bëjë gjyqin vetvetes?


Ai dhe vetëm ai ka të drejtë të gjykojë nëse heqja e një simboli dhe vendosja e një tjetri, apo veprime të tjera kësisoj që burojnë nga qendra e mbretërisë, janë të mira, apo të këqija për të...

Nga ana e tij, qyteti e ka dhënë me kohë vendimin për vetveten.

Historia e ka vënë atë përpara provës së jetës e të vdekjes.

Dhe ai do të rrojë, sepse jeta e tij i ka rrënjët në shpirtin,
në nderin e në gjakun e njerëzve të tij.

Fund



Dy fjalë për "Një det helmi"

Drama është shkruar gjatë viteve '94-95, por tharmi i saj gjendet në shënimet e mia letrare të periudhës që do ta quaja "të Fierit" (1975- 1982).

Në vitin 1975, pas goditjeve sistematike kundër liberalëve në letërsi e art (1973) dhe kundër puçistëve në ushtri (1974), i erdhi radha goditjes në ekonomi. (A. Këllezi, K. Theodhosi, K. Ngjela...). "Kronosi" nga Olimpi i tij hante qetësisht viktimat që i faniteshin netëve si armiqtë e vet. Këta tre vjet ndoshta kanë qenë nga më të tmerrshmit në historinë gjakatare të dhunës enveriste.


Në Fier, goditja u bë në sektorin e naftës. Ish sekretari i parë P. Gusho vrau veten. Ish drejtori i përgjithshëm, Lipe Nashi u arrestua e u dënua me 25 vjet, kurse disa inxhinierë (K. Plaku..), u pushkatuan.

Në gjithë specialistët e naftës , ndoshta edhe tek ata që përkohësisht ngriheshin në përgjegjësi, sundonte psikoza e frikës së një ndëshkimi absurd, që s'dihej se si mund të shfaqej. Në ato ditë, dëgjova historinë (sekrete) të një inxhinieri, i cili prej javësh nuk kthehej në shtëpi nga pusi ku punonte, për të përgatitur një "ndarje" të besueshme me të shoqen në rast se do të arrestohej... Ndarja u bë, por.. ai nuk u arrestua asnjëherë.

Ky ishte shënimi mbi të cilin nisi të punojë imagjinata ime në ditët e demokracisë, ku shpesh bëhet thirrje për të harruar.

Diktaturat, veç dhunës së dukshme e të dëshmuar, ushtrojnë edhe dhunën tinëzore mbi psiqikën e individit. E zbehin, e thyejnë, e tjetërsojnë, por disa i bëjnë edhe të papërkulur.

Autori



NJË DET HELMI


Dramë

Personazhet

Aroni
Tomi
Bahiri
Alma
Aneta
Pistoli
Ajdini

Xhabiri
Mahija
File Murati
Afrim Meta
Një daktilografiste
Një polic

Ngjarjet ndodhin në fillim të viteve '70 në një zonë naftë.



Tabloja e parë

Zyra e inxhinierëve që shërben edhe si fjetore. Përkundër ndërtimit dhe pamjes së rëndomtë të barakës, brenda bie në sy dëshira për rregull dhe komoditet. Një ndarje me perde. Në sfond konturet e pusit të naftës, si vizatim abstrakt.

Në tavolinën e punës. Aroni është duke përfunduar një relacion, që duket se i kushton një përqendrim nervoz. Tomi ruhet tek pasqyra e tualetit. Është një burrë i pashëm rreth të dyzetave. Dëshira për t'u dukur më i ri, vihet re në çdo gjë që bën. Radioja jep këngë polifonike të Labërisë me brendi politike, të cilat Tomi i përcjell herë pas here me përplasjen karakteristike të këmbës në vallet e kësaj krahine.

Tomi - (Duke fërkuar fytyrën me kolonjë). Mbrëmë tek Alma kam dëgjuar një anekdotë të hatashme. Burri duke u rruar në mëngjes, i thotë gruas: interesant e dashur, sa herë mbaroj së rruari, më duket vetja dhjetë vjet më i ri. Nga pasqyra vëren shprehjen përçmuese të fytyrës së gruas. Ia kthen atëherë ajo: pse nuk rruhesh çdo mbrëmje? (Qeshin).

Aroni - Sikur të mos ishte ai vështrim përçmues i gruas, do të vija bast se kjo është një anekdotë angleze.

Tomi - Vërtet angleze është. Po si e gjete?

Aroni - Sepse humori është tepër i hollë. Para se të qeshësh, duhet të vrasësh mendjen për kuptimin e anekdotës.

Tomi - Atë vështrim përçmues e shtova unë nga xhepi, që ta kapje më lehtë se ku e ka hallin gruaja. Të ketë përnatë në shtrat një burrë dhjetë vjet më të ri... Ma ha mendja e lakmon çdo grua në një farë moshe, tek të dyzetat, të themi.

Aroni - Pse pikërisht tek të dyzetat?

Tomi - Thonë se kjo është moshë kur etja seksuale e gruas arrin pikën më kritike.

- Aroni* - (Ngrihet e ndryshon stacionin e radios. Vijnë tingujt e valsit të Shtrausit. "Trëndafilat e Jugut"). Këtë anekdotë do t'ia vlente ta arkivonim për një moshë tjetër. Për ne është herët që ajo të na vërë në mendime. Apo jo?
- Tomi* - (Pas një pauze). E di, Aron, nganjëherë më kap një panik i çuditshëm. Ty mund të ta rrëfej këtë gjendje njëlloj si vetes sime të dytë. Më bëhet se kur të vijë ajo natë që të flej në një shtrat me Almën, nuk do të jem në gjendje të bëj asgjë. Më kupton ç'dua të them?
- Aroni* - Sigurisht. Thua marrëzira.
- Tomi* - Jo, nuk janë aspak marrëzira, është një gjendje deliri, një ankth i parakohshëm që m'i mpin gjymtyrët e m'i shuan të gjitha dëshirat. (Pauzë). E kam patur fare të lehtë me dashnoret e përkohshme. E ndaja mendjen që në fillim se si do të përfundonin ato lidhje dhe i vërtisja në majë të gishtave. Kështu, më shkonin vitet me një mendjelehtësi gazmore dhe më bëhej se s'do të isha kurrë i aftë për një dashuri të thellë, tronditëse, serioze. Pastaj u shfaq Alma dhe bota ime plot mëkate të vogla e të ëmbla, u përmbys...
- Aroni* - Dhe tani, ti nuk përshtatesh dot me botën tënde të re... (Qeshin). Çështje kohe. Do të mësohesh (pauzë). Nga vizita ime e vetme në shtëpinë e të fejuarës tënde, pata përshtypjen se ata ... atje e marrin çdo ngjarje tepër seriozisht, i japin një farë kuptimi politik...
- Tomi* - Ç'do të thuash?
- Aroni* - (Si i penduar) O, asgjë. Mbase gabohem. Ti i njeh më mirë.
- Tomi* - Mua më duhet vetëm Alma. Vetëm ajo. S'kam për ta ngrysur jetën me shokun veteran Ajdin Shabani që e fillon çdo darkë me tri döllit: për partinë, për shokun Enver dhe për lëvizjen marksiste-leniniste në botë... (Qeshin)
- Aroni* - (Përfundon relacionin, psherëtin). Më në fund! Ma nxiu jetën (la zgjat). Lexoje.
- Tomi* - Ç'ta shoh? E pe ti, e pa perëndia.
- Aroni* - Përfundimi është ky : (Lexon)"Megjithëse shpimi arriti thellësinë e parashikuar në projekt, ne propozojmë që ai të vazhdojë, sepse, siç dëshmon raporti teknik të gjithë para-

metrat japin shpresa se shtresa naftëmajtëse...”

Tom

- Hiqe fjalën “s’fresë”. Hiqe. Thuaj “na japin siguri, bindje”, ç’të duash, vetëm atë fjalë të papërcaktuar jo. E urrej.

Aron

- Gjithmonë është më mirë të lësh një shteg të hapur, sado i vogël qoftë. Duhet ta firmosim të dy.

Tom

- (*Nëshkruan*)... po të mos ishte ky pus afër shtëpisë së Almës, ndoshta do të ngurroja para se të firmosja.

Aron

- (*I habitur*). Pak më parë ti deshe të shkruanim, kemi siguri, kemi bindje...

Tom

- M’u mërzitën të gjitha. Sapo nis të hapësh krahët, t’i shkurttojnë.

Çdo njeri që ka një farë pozite në parti, apo në shtet, mbahet si specialist i mbaruar për naftën, kurse në të vërtetë s’dinë as formulën bazë të hidrokarbureve. Në daltë djalë, rrahin gjoksin: “Ishte mendimi i shokut “X” që të shpojme në këtë zonë”-thonë.

Aron

- (*Ngacmues, me humor*). Nuk i vë dot një emër shokut “X”?

Tom

- Dreqi, i biri i dreqit. Ohu, mos më fut në ngasje, ti e di që nganjëherë mua më zgjidhet gjuha nga freri.

Aron

- Se mos të zgjidhet edhe në shtëpinë e nuses?!

Tom

- Aty s’kam qeder, jam në shtëpinë time.

Aron

- Kam dëgjuar se aty vete shpesh edhe Pistol Gorica...

Tom

- Sigurisht, është nipi i vjehrrës. Nuk e dije?

Aron

- Diçka dija, por jo se janë kaq të afërt.

Tom

- Tani po ta kuptoj më mirë shqetësimin.

Aron

- Në të vërtetë, përveç që është shefi i sigurimit të zonës së naftës, unë s’di gjë tjetër për të.

Tom

- Do të prezantoj në rastin më të parë. Është njeri interesant, me humor, komunikues. Krejt ndryshe nga përfytyrimi që kemi ne për njerëzit e sigurimit. Të krijon menjëherë një gjendje komode, të shpenguar. Apo nuk tregon anekdota. Dhe jo më kot, por me spec! Politike!

Aron

- Ta paska gjetur pikën e dobët! Bëni garë ndonjëherë?

Tom

- Mos më pandeh budalla? Kur është ai, unë tregoj vetëm barceleta seksi, të moderuara natyrisht, përndryshe vjehri do të skandalizohej.

- Aroni* - (*Nxiton drejt radios. lëviz butonin shikon orën*) Lajmet paskan mbaruar.
- Tom* - (*Ironik*). Humbje e madhe! (*Tom nënqesh*) Mos vuaj aq shumë, po deshe t'i përsëris unë një për një (*imiton*) "Punonjësit e Kombinatit Metalurgjik "Çeliku i Partisë" në Elbasan, të mobilizuar për nder të 30-vjetorit të çlirimit të atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor, kanë tejkaluar objektivat në mënyrë të ndjeshme duke u vënë në pararojë të lëvizjes "Sulmues i 5 vjeçarit të katërt"! Sa plane që kemi realizuar! Pupu! (*Hyn Bahiri. është me veshje pune. I shikon radhazi me ngulm*). - Ç'ke që na shikon, si qenie parahistorike?
- Bahiri* - Vërtet jeni kaq indiferentë? Apo e prisnit që të ndodhte?
- Aroni* - Çfarë prisnim? Fol qartë.
- Tom* - Mos ke hedhur ndonjë gotë? (*E shikon*). S'më dukesh. Sytë i ke të kthjellët.
- Bahiri* - (*Drejt radios*). Po s'dëgjuat gjë? Shurdhë ishit?
- Aroni* - Lajmet na shpëtuan. Dëgjonim muzikë.
- Bahiri* - Është zbuluar një grup armiqësor në naftë. Kanë arrestuar drejtorin tonë të përgjithshëm, kryeinxhinierin, zëvendës-drejtorin e Institutit.
- Aroni* - Si është e mundur?
- Tom* - (*Përsërit*). Çdo gjë është e mundur! (*Si me vete*). Qeveria e zë lepurin me qerre! "Se këtu në vendin tim, edhe pjepri ka kuptim!" (*Nënqesh*).
- Bahiri* - Ty të qeshet? Si mundesh? Nuk të trondit ky lajm?
- Tom* - Duhet t'ju tregoj atë anekdotën e kuptimit që ka pjepri. Më duket s'ua kam thënë...
- Aroni* - Gjete kohën.
- Tom* - K.TH. Spiri i famshëm, ishte i pezmatuar asaj dite me njerëzit e qeverisë lokale, s'di përse, të themi për ndonjë formalitet të kotë që i kërkohet.
- Rrinte i mërziur në kafe dhe aty tha me zë të lartë atë që i vërtitej në mendje si një varg satirik: "Se këtu në vendin tim, edhe pjepri ka kuptim". Kështu e paska huqin kjo raca e poetëve popullorë. Vete e thotë me zë mendimet e fshehta. E dëgjoji atje tej kundërshtari i tij në bejte, Lamja dhe ia

ktheu." Dhe kështu o miku im/ hedh një gur në rindërtim..."
Domethënë, ajo që the për pjeprin është parullë armiqësore
dhe pengon rindërtimin e vendit...

Aroni

- Nganjëherë s'të kuptoj fare. Si mund të bëhet humor në situata të tilla?

Bahiri

- Ne beqarët pleq, tallemi me çdo gjë!

Tomi

- Ma ha mutin! *Pauzë*

Aroni

-Më duket se duhet të ulemi e të kuvendojmë shtruar.

Tomi

- Përse?

Aroni

- *(Duke mbledhur fletët)* . Për këtë...

Bahiri

- Unë prandaj u ktheva. Më the se do ta çoja unë në drejtori.

Aroni

- Ah, po. Por në këto rrethana...

Bahiri

- Çfarë rrethanash? Vdiq mbreti, rroftë mbreti. Me siguri dikush është ngarkuar për të drejtuar punët. Partia nuk lë zgavra.

Aroni

- Janë disa ide që i kisha biseduar në telefon me kryeinxhinierin dhe ai i kishte mbështetur. Tani...

Bahiri

- Ah, ai kryeinxhinieri... Dukej sikur nuk shkelte dot asnjë mizë.

Tomi

- Dhe nuk e shkelte.

Bahiri

- Por e paska patur thikën nën gunë*(pauzë)*. Sa për atë pisin, drejtor, Filen, e kam ditur me kohë që do të përfundonte aty ku e kishte vendin. Në hale!

Tomi

- *(Ironik)* Sidomos pasi të hoqi nga drejtorja shkencore dhe të solli këtu...

Bahiri

-*(Që nuk e nuhat ironinë)*. Dhe përse? Hm...

Tomi

- Kot fare.

Bahiri

- *(I kënaqur)*. E dinin të gjithë që isha viktimë, por kush guxonte ta thoshte!

Tomi

- Nuk të braktisën të gjithë. Dikush të doli krah.

Bahiri

- Aronit i jam mirënjohës për jetë. Mos të ishte ai që më mori në sektorin e tij, me atë motivacion që më sajoi ai paçavurja, File Murati, mund të kisha përfunduar ndonjë pompist apo manovrator i thjeshtë...

Aroni

- Ti ishe inxhinier, nuk mund të ta merrnin diplomën. Edhe detyra e teknikut që bën këtu, e përkohshme është. Unë

kam folur me ...(*Stepet*).

Bahiri - Lëre me kë ke folur. Harroje. Njëqind herë më mirë, që kjo situatë më gjeti teknik të thjeshtë. Unë e di. Unë do ta them aty ku duhet, se ata pisa i nënvleftësonin kuadrot e afta. I nënvleftësonin, i mënjanonin dhe i luftonin (*Aronit*). Ja, ty, inxhinierin më të zot që njoh unë në sektorin e naftës, ku të çuan? Në këtë pus të largët, në zonën më të vështirë, larg familjes, larg kërkimeve shkencore. Sepse vetë ai harapçiu, kurvari, File Murati nuk të donte. Të shihte me dyshim, të kishte halë në sy dhe pse? Vetëm e vetëm sepse ti nuk i bëheshe urë dhe kishe kurajon qytetare të kundërshtojë.

Aroni - Nuk mund ta them... Kisha vetëm kurajon shkencore. Megjithatë...

Tomi - E çuditshme. File Muratin e çmonin deri lart...

Bahiri - Tani e kanë marrë në dorë ca ustallarë që dinë ta çmojnë tamam siç duhet. Ka për të vjellë edhe qumështin e nënës.

Aroni - Mos po flasim para kohe. Ende s'dimë asgjë të saktë!

Bahiri - Grup armiqësor. Ç'duhet më tepër? (*I shqetësuar befas*). Unë duhet të jem aty një orë e më parë. Kot po vonohem.

Tomi - Beson se do të reabilitojnë menjëherë?

Bahiri - Kur ka dënime, ka edhe rehabilitime. Kjo është dialektike. Ashtu siç ka rënie, ka edhe ngritje. (*Aroni rregulon fletët e raportit, gjithmonë me mëdyshje*). Ja për shembull, sikur ky pus i mallkuar të kishte shfryrë ndonjë currilë naftë apo gazi, ti Aron do të gdiheshë anëtar i Komitetit Qendror të Partisë.

Aroni - (*Me humor*). Unë s'jam as anëtar partie, pa le më të gdihem në majë të piramidës.

Bahiri - Pavarësisht, kur i duhesh partisë, ajo i kapërcen etapat me galop. Ngrysesh kandidat partie, gdihesh anëtar i Komitetit Qendror.

Tomi - Si tek Shekspiri "Mirëmëngjes Makbeth që nesër bëhesh mbret!..." Me sa di unë, kështu fabrikohen anëtarë partie, vetëm nga heronjtë e punës që vdesin. Ti po na ndjell tersin Bahir!

Bahiri - Me ty nuk e kruaj. Ke shpatulla të gjera ti, s'të zë era.

Tomi - Unë?

- Bahiri* - Vjehri veteran, nipi i vjehrrës lis i madh me degë shumë. Ehu! Dite ku trokite ti, lumë miku, ç'të bëjmë ne me Aronin që duhet të çajmë dallgët me varkën tonë.
- Aroni* - Fjalë pa bukë. Tjetër gjë më shqetëson mua tani...
- Bahiri* - (*Intim*). Mos u bëni të marrë, nuk e ndjeni një erë të ngrohtë që vjen e na mbështjell? Unë e ndiej. Ku do të gjejnë specialistë më të aftë e më të ndershëm se ti Aron, për ta bërë të paktën kryeinxhinier? (*Tomit*). Kurse ty... përgjegjës të kësaj zone po se po. Që të mos jesh larg nuses së re!...
- Tomit* - Po për vete?
- Bahiri* - Çfarë për vete?
- Tomit* - S'bëre asnjë profeci.!
- Bahiri* - Unë jam modest. Unë e di që s'e bëj dot vezën e Aronit. As tënden, megjithëse ti s'ke çarë kurrë kokën për poste. Mjaft të më vihet nderi dhe e drejta në vend. Shoku i ndyrë File Murati, është në burg. Po kush m'i vuri minat mua? File Murati. Atëherë unë kam të drejtë ta shpall me zë të lartë se ai më mënjanoi mua si specialist të padëshirueshëm me që unë do t'i bëhesha pengesë dhe do t'ia zbuloja qëllimet e tij djallëzore.
- Tomit* - Thua mund ta bëje?
- Bahiri* - Të thashë, me ty nuk e kruaj. (*Qesh, i rreh shpatullat*). Ngado që të shohësh, duket qartë. Erdhi dita ime! Aron, unë po nisem (*merr dosjen*). Ke për të më dhënë gjë tjetër?
- Aroni* - Edhe atë, s'di në duhet të ta jap tani...
- Bahiri* - Pse? Dyshon se s'ka kush të merret me të?
- Aroni* - Jo, do të merren, sepse ky pus ka thithur një pjesë të madhe të investimeve për kërkim. Dyshoj vetëm se nuk e di më ç'sy do ta shohin.
- Bahiri* - Me një sy tjetër nga ç'do ta shihte ai fundërrina, File Murati. Pa lëkundje vëlla, pa lëkundje. Mendimet dhe propozimet e tua, tani marrin peshë të jashtëzakonshme. Në qofsh ai Aron që njoh unë, atëherë prit kur të bjerë zilja e telefonit dhe të të kërkojnë lart, në Olimp, aty ku vendosen fatet e njerëzve (*Merr dosjen dhe largohet*).
- Tomit* - Ptu! Më gjej një uturak se më vjen të përzier. Nuk e prisja

- të shfaqej kaq i pështirë.
- Aroni* - Ai ka ethet e hakmarrjes.
- Tomi* - Të gjithë thonë se ai sillej si një pusht i neveritshëm.
- Aroni* - Po, por ky nuk është një shkak i mjaftueshëm për ta ndëshkuar.
- Tomi* - Neverinë e kam prej shtirjes. E dëgjove? Unë do të zbuloja qëllimet e tij djallëzore! Nuk ju zihet besë këtyre njerëzve,
Aron, këtu të lan e të lyen, atje të përbalt e të nxin...
- Aroni* - O, jo, s'është kaq i keq. Veç asaj, mosmirënjohja njerëzore, s'mund të vejë kaq larg (*duke dashur të çlirohet*). Ma bëre mendjen dhallë.
- Tomi* - E di ç'bëjmë? Eja me mua tek vjehri. Eja, nuk ia vlen të mbyllesh këtu dhe të presësh i vetëm derisa të vijë nata duke dëgjuar muzikë. Kanë një verë të mirë "Pino- Nero" që e ruajnë për miq të mëdhenj. Po a ka mik më të madh se dhëndri? Eja, mos ma prish!

Aroni vishet me përtesë. Errësim.

Tabloja e dytë

Në shtëpinë e Almës. Dhomë pritjeje. Tryezë me pije dhe fruta të stinës. Aneks kuzhine ku merren me detyrat e tyre prej amvise Mahija dhe Alma. Rreth tryezës janë Ajdini, Pistoli, Aroni, Tomi dhe Xhabiri.

- Tomi* - (*Që duket pak i eksituar nga vera*). Ja, dëgjo edhe këtë, ama fundin do ta lëmë enigmë. Të shohim kush do ta gjejë. Ti Aron, po qe se ta kam treguar, mos fol, s'ka kuptim. Është provë nuhatjeje komike kjo.
- Xhabiri* - Hë de nxirre, se na vdiqe.
- Tomi* - (*Në po atë gjendje*). Mos thuaj nxirre, se mund të merret ters. -*Qeshin*-
- Mahija* - Këtij i ka plasur cipa!

- Alma* - Ka pirë pak, prandaj...
- Mahija* - Ka pirë, po të mos pijë mentë.
-*Alma vjen për të servirur kafen-*
- Alma* - (*Tomit*). Bën për veshët e mia ajo që do të tregosh, apo t'ia mbath?
- Tomit* - Bën, si s'bën! Unë nuk tregoj kurrë barceleta banale. Ato janë sektori i Pistolit.
- Pistoli* - Andej nga nahija jonë, e kemi një çik si qejf të gudulisemi me anekdotat e sevdasë. Zakon i burrave me ko... hm... se desh ia këputa një fjale të trashë, Alma. I burrave të fortë po them. Apo jo xhaxha?
- Ajdini* - E, e, e! Zakon i verës thuaj, ç'ka barku e nxjerr bardhaku.
- Xhabiri* - Shiko, u zbythët fare nga llogorja. E kishte fjalën Tomi.
- Tomit* - Vdiq një burrë dhe vajti drejt e në ferr. Aty ishin dy porta të mëdha. Ku do të hysh, i thotë rojtari, kjo është porta e kapitalizmit, kjo porta e socializmit. Mirë, hyj ku të urdhërosh zotrote, ia kthen ky me djallëzi, po më parë më trego ç'bëhet aty brenda? Këtu tek kapitalizmi po hapin një xhade, - thotë rojtari. Të shtrojnë në rrugë bashkë me zhavorrin dhe sipër të kalon ruli që të thërmon kockat. Po andej nga socializmi? Edhe andej po bëjnë një xhade. Të shtrijnë në rrugë me zhavorrin dhe sipër të kalon ruli. Ou, po ç'ndryshim ka atëherë, thotë burri i dëshpëruar. Ka një ndryshim thotë rojtari, se këtej... (*kujtohet*).
Dreq, për pak më shpëtoi goja dhe do të thosha përfundimin..
Kush e gjen ku është ndryshimi që tha rojtari?
- Pistoli* - Këtej nga socializmi, ruli një orë punon dhe një orë bën pushim, kurse andej punon tetë orë rresht!
- Tomit* - (*I habitur*) Je i madh! E dije?
- Pistoli* - Jo, por s'është e vështirë për ta marrë me mend. Anekdotat me humor të zi, zakonisht kështu mbyllen.
- Ajdini* - Reaksionare qind për qind.
- Xhabiri* - Reaksionare, por e vërtetë.
- Tomit* - Përgjigjja ishte aq e saktë, sa tani unë dyshoj se e ke ditur. Leri huqet profesionale prej hetuesi. Tregohu i sinqertë, e dije apo s'e dije...

- Pistoli* - E mirë, s'dua lavdi të pamerituar. Ma ka treguar një ditë ai drejtori juaj i përgjithshëm, File Murati.
- Bie një heshtje e vështirë-*
- Ajdini* - Ai File Murati ka patur një gjuhë prej nepërke.
- Alma* - Mos fol kot, babi. Ai ishte një nga njerëzit më të besuar. Kandidat i Komitetit Qendror të Partisë.
- Ajdini* - (E ndërpret) Kur ngjitesh lart në pemë, të merren mentë...
- Pistoli* - Gjithmonë duhet të presim. Diçka duhet të presim...
- Tomi* - (Me tallje). "Uji fle, armiku nuk fle!", "Vigjilencë, vigjilencë, gjithmonë vigjilencë".
- Ajdini* - Tani nuk po tregojmë anekdota, dhëndër. Me këto gjëra s'mund të tallesh. Janë me zarr.
- Alma* - Ti baba, çdo gjë e shikon në prizmin ideologjik.
- Ajdini* - Nën... prizmin ? Hm... do të flisni shqip apo do të na rrokasni kokën me llafe të mëdha?
- Xhabiri* - I shikoni me syze të zeza, donte të thoshte.
- Mahija* - U,u,u! Ai s'ka as syze të bardha, pa le më të zeza? (Qeshin).
- Ajdini* - A ç'më çani kokën, (del me shpejtësi).
- Tomi* - Ç'pati? Kaq shpejt zemërohet?
- Mahija* - Jo, jo... (Ulët). Nuk... nuk e duron dot ujin e hollë. Pleqëri hesapi.
- Alma* - Ç'flet dhe ti mama. Ai është vetëm 62 vjeç. Kam frikë se mos i ka filluar ndonjë prostatat...
- Pistoli* - (Aronit) Si e njihnit ju File Muratin?
- Tomi* - Ore, hetim do të na bësh këtu ti?
- Pistoli* - Më vjen keq! Ne po bisedojmë. S'mund të më shikoni një herë si qytetar të zakonshëm?
- Aroni* - (I rezervuar). Ai kishte punuar në të gjitha profesionet e naftës. E sollën për të forcuar drejtimin, kështu që...
- Xhabiri* - Bukur e forcoi. Ia luajti fenë.
- Tomi* - Një rrotë mulliri, ja ç'ishte.
- Pistoli* - Po ai shoku juaj, Sandri?
- Aroni* - (I befasuar) Çfarë Sandri? Cili Sandër?
- Pistoli* - Sandër Agaraj, kështu më duket se quhet.
- Aroni* - Ç'lidhje ka Sandri me këtë çështje? Ai nuk punon në

Drejtorinë e Përgjithshme.

Pistoli - Fijet e merimangës janë shtrirë më larg se Drejtoria e Përgjithshme.

-Pauzë-

Tom - Kini një mënyrë shumë të stërhollë për të thënë se dikush është arrestuar.

Pistoli - Rutinë profesionale. Ç't'i bësh?

-Pauzë-

Aroni - Bahiri nuk na tha asgjë për të.

Pistoli - Cili është Bahiri?

Tom - Një vartësi ynë. Një ish inxhinier që File Murati e dërgoi teknik...

Pistoli - Nuk e njoh. Ka plot njerëz që janë viktima të luftës së këtij klani armiqësor.

Ajdini - (Që ka hyrë). Ai Bahiri është goxha burrë. Kam pirë dy-tre herë me të. Burrë i vendosur, besnik.

Alma - Aman baba! Besnik?! Të gjithë e dinë përse e hoqën.

Xhabiri - Që ishte feminist i dorës së parë, këtë s'e luan as topi. Megjithatë...

Ajdini - Armiku, kur don të godasë njerëzit tanë, ngre kurthe të ndyra.

Xhabiri - Prit kur ta s hohim Bahirin mbi ndonjë "Aro", përgjegjës sektori apo nëndrejtor.

Tom - E kishte shaluar kalin që sot.

Pistoli - (Afron gotën me Aronin). Gëzuar! Mos e vrit mendjen shumë.

Aroni - (I hutuar). Gëzuar! (E trokasin edhe të tjerët.)

Ajdini - Armiku kokën poshtë, në gjiriz. (E troket me Aronin. Heshtje).

Aroni - Po Sandri... përse?

Pistoli - Nuk e di!

Tom - (Me humor). Pse, mos prisje të zbërthehej!

Pistoli - Sinqerisht nuk e di pse akuzohet konkretisht. Përndryshe do t'ua thosha. Është krejt njerëzore që ju të interesoheni për mikun tuaj.

-Pauzë-

Ajdini - Pse, e keni mik me të vërtetë?

- Aroni* - Po, e kam. Por... asqë e kuptoj ç'ka bërë dhe përse duhej...
- Xhabiri* - Ajo dihet. Deri sa e kanë arrestuar, diku e ka qelbur.
- Tomi* - Sandri është inxhinier i thjeshtë. Ç'ka në dorë ai? Kyçet e kashtës.
- Pistoli* - Nganjëherë tufës së peshqve të mëdhenj, i prijnë ca peshq të vegjël. Si puna e kinezëve. Asnjëherë nuk është i pari, ai që paraqitet si i parë.
- Aroni* - Më duket e pabesueshme. E pamundur.
- Ajdini* - E, e...Mos e vër dorën në zjarr se të digjet.
- Tomi* - Ç'doni të thoni? Sandri është edhe shoku im.
- Ajdini* - Dua të them që partia nuk godet qorrazi, këtë dua të them.
- Alma* - Por... ata e kanë të vështirë. Ata e kanë patur mik. Si s'e kuptoni. Eshtë një e papritur tronditëse.
- Aroni* - Mik e kam vetëm unë. Tomi kot flet. Ai prej meje e ka njo-hur.
- Alma* - Tomi është zemërgjerë. Ai i quan të gjithë lehtësisht, shokë, miq...
- Pistoli* - Gjithësesi, tani është më mirë që disa miq të harrohen. E di që s'është e lehtë, megjithatë në jetë krahas pohimit, është edhe mohimi. (*Aronit*). Mos e kam gabim?
- Aroni* - Sikur t'ju thonë se shoku juaj i vjetër, miku i zemrës që e çmoni si veten, nuk është më ai që njihni, po përkundrazi është përçudnuar i tëri, brenda një dite, ju do ta besoni?
- Pistoli* - Po të ma thoshte partia do ta besoja.
- Aroni* - Kaq e lehtë është kjo?
- Pauzë-
- Tomi* - Kot e pyesni. Ai s'mund të përgjigjet me logjikën e ndje-njave. Përgjithësisht ata s'kanë as shokë, as miq.
- Pistoli* - E teprove më duket. (*Pauzë. Pistoli hiqet si i fyer*)
- Xhabiri* - E drejtë! (*Tomit*). Mos ma fyej kushëririn. Ai nuk është kalë karroce si disa të tjerë. Ti e ke thënë vetë dikur!
- Tomi* - (*I penduar*). E thashë ashtu, teorikisht. Eshtë natyra e punës e tillë që i veçon disi nga shokët.
- Alma* - E dini që na mërzitët? Mos vallë do të rrimë tërë kohën duke folur për luftën e klasave? (*Vë magnetofonin. Muzikë*)

vallëzimi gjysmë ritmike. latinoamerikane). Mama, të lutem bëje ti kafënë. (Merr Tomini)

Tomini
Alma

- (Në anën e skenës pa njerëz) Po ç'të shkrepni kështu?
- Oh, sikur mos të të shkëpusja prej tyre, ti do të bëje gafë pas gafe.

Tomini
Alma

- Gafa ideopolitike?
- Më shtrëngë edhe pak. Dua të të ndiej. Në këtë qoshe nuk na sheh njeri.

Tomini

- (E afron). Mos vallë kushëriri yt do t'i raportojë diku fjalët e mia?

Alma

- Jo, ai nuk mund të hedhë baltë mbi fisin e tij. Megjithatë i dashur, ti i merr disa gjëra fare lehtë.

Tomini

- Sepse jam i sigurtë. Ke kundërshtim? A nuk të jam rrëfyer si tek prifti?

Alma

- Si mund të bëje ndryshe? Po të mos më rrëfesheshe, unë do t'i zbuloja vetë të gjitha dhe atëherë do të më humbisje.

Tomini

- Kurse unë kisha vendosur mos të të humbsja.

Alma

- Që kur?

Tomini

- Menjëherë. Porsa u njohëm, e vendosa. Kjo është e fundit...

Alma

- Thonë se dashuria e fundit në të vërtetë është e para.
(futen në dhomën tjetër).

Ajdini

- (Së shoqes për magnetofonin) Mbyllja grykën asaj zorre se nuk e duroj dot ...

Mahija

- Si s'u gdhende një çikë. Gjithnjë don të bëhet e jotja. Kemi një dhëndër tani...

Ajdini

- Një dhëndër që e ka kokën plot lakra. Ç'pandeh ai. Meqë i ka shpatullat e ngrohta, mund ta lëshojë gjuhën azat? E? Ç'pandeh ai?

Mahija

- Pusho, se po bëhesh gazi i botës. Mbylle muzikën, ata po rrinë në divan. Hajde pi kafënë. (Ulen secili më vete. Tek tryeza janë Aroni, Pistoli, Xhabiri).

Xhabiri

- (Aronit). E përfunduat atë studimin?

Aroni

- Nuk ishte studim. Ishte një relacion për drejtorinë.

Xhabiri

- Tomi ka qenë shumë i shqetësuar këto ditë.

Aroni

- Nuk m'u duk.

Xhabiri

- Sepse ai ka një besim të jashtëzakonshëm tek ty. U lodhët

- shumë, thotë.
- Aroni* - (Me mërzë). Relacioni ynë tani s'ka kurrfarë rëndësie.
- Xhabiri* - Pse jeni kaq i rënë moralisht? Bëtë gjithë atë mund, gjithë atë punë.
- Aroni* - Kush do të merret me të? Gjithçka do të fillojë nga e para dhe ne do të mbetemi këtu në një pritje të gjatë, si peshku pa ujë.
- Pistoli* - Ai e di më mirë.
- Xhabiri* - Tomi nuk është kaq pesimist.
- Aroni* - Tomi është natyrë optimiste.
- Pistoli* - (Xhabiri). Ai ka të drejtë! Ai mendon se në këtë situatë kritike, makina e shtetit tonë do të mbetet në baltë dhe ...
- Aroni* - (Si i shkundur). Përse e keni fjalën? Makina e shtetit do të mbetet në baltë? Kush e tha, se s'ju kuptoj?
- Pistoli* - Fola paksa në mënyrë figurative. Ju deshët të thoshit, se derisa të sqarohen gjërat, udhëheqja e re e naftës s'do të ketë kohë të merret me propozimet tuaja, (si i kujtuar). Po, vërtet, jam kureshtar të di çfarë propozimi keni bërë?
- Aroni* - Që shpimi të vazhdojë.
- Pistoli* - Pavarësisht se kuota e projektit u arrit dhe naftë nuk doli?!?
- Aroni* - Pavarësisht, (i befasuar). Po ju si e dini?
- Pistoli* - (Qeshi). Diçka dimë edhe ne.
- Aroni* - Ah, e kuptova. Ua ka thënë ai! (Vjen Tomi dhe të tjerët).
- Tomi* - (Ende pa u ulur). Çfarë ju kam thënë?
- Pistoli* - Që do të kërkoni fonde për të vazhduar shpimin.
- Tomi* - Vërtet ua kam thënë. Kur? Ne sot e vendosëm.
- Pistoli* - Sot e vendosët, por e mendonit prej ditësh.
- Tomi* - Ka mundësi. S'mbaj mend. Kur jam këtu dua t'i harroj hallet e punës.
- Pistoli* - Po të mos ishte arrestuar File Murati, do t'ua jepte fondet?
- Aroni hesht, duket i tronditur-
- Tomi* - Nuk varej në dorën e tij. Duhej të vendoste Këshilli Teknik.
- Pistoli* - Sidoqoftë, mundësinë e kishit më të madhe. Aty ishte kryeinxhinieri. Vlasi apo Vllasi, si quhet miku juaj, Sandri, një tjetër specialist i njohur Afrim Meta, miku juaj edhe ai.
- Tomi* - Kot e përsërit aq shpesh atë fjalë "mik". Nuk na tremb dot.

Apo jo Aron?

-Aroni hesht-

Pistoli

- Për nder, një dreq profesioni që keni. Luani vazhdimisht me të panjohurën.

Tomi

- Me të panjohurën luani edhe ju.

Pistoli

- Po, por ne e kemi mbi tokë, kurse ju nën tokë.

Tomi

- *(Ironik)*. Veç të tjerave e panjohura juaj ka nerva, mish, eshtra... Me to mund të luash më lehtë, apo jo...

Pistoli

- Je një dhëndër i vështirë, e pranoj. Apo jo Aron?

Aroni

- S'kuptoj... Ç'deshët të thoni me atë që luajmë me të panjohurën? Me sa duket nuk e kishit thjesht për naftën.

Pistoli

- Ti je më i vëmendshëm se Tomi. Ose ke nuhatje më të mprehtë. Unë bëra një hamendje se ç'mund të ndodhë me propozimin tuaj gjatë diskutimit në Këshillin e ri Teknik dhe sidomos më vonë, disa muaj më vonë...

Tomi

- Dhe ç'ju tha ajo hunda juaj prej hetuesi pas kësaj hamendjeje?

Pistoli

- *(Qesh)*. Hunda ime prej hetuesi? E bukur kjo! Ka dymundësi. E para, fondet ju jepen, ju vazhdoni shpimin, nafta nuk del. Atëherë mund t'u thonë se i hodhët paratë në erë. I guposët lekët e shtetit, djersën e popullit. E dyta, fondet nuk ju jepen, dikush tjetër vazhdon shpimin. Nafta del, atëherë mund t'ju thonë, përse nuk ngulët këmbë që shpimi të vazhdonte. Përse e latë kaq kohë të vdekur këtë vendburim. Ekonominë pa gjak, industrinë pa arterie.

Tomi

- Mund të na akuzojnë si sabotatorë, që të jemi të saktë.

Pistoli

- Unë s'e përdora atë fjalë. Unë parashikova vetëm dy mundësitë e këqija. Por ka edhe një mundësi fatlume që nafta të dalë dhe atëherë ju bëheni heronjtë e ditës *(merr gotat)*. Ta pimë për mundësinë fatlume. *(E trokasin)*.

Ajdini

- Të lumtë goja.

Pistoli

- Që të bëheni heronjtë e ditës.

Xhabiri

- Për heronjtë e ditës. Unë e parandiej. Ata do të bëhen. Ama edhe ti s'duhet të rrih duarkryq.

Pistoli

- Çdo gjë varet prej tyre. Vetëm prej tyre.

Aroni

- Mua më falni, më duhet të iki. Mirupafshim.

- Tom* - Prit, do të vi edhe unë. S' mund të të lë vetëm. Alma, nuk mërzitesh?
- Alma* - Aspak. Babushit tim i pëlqen që ti je burrë zakoni dhe nuk rri për të fjetur në shtëpinë e tij pa u martuar. (*Qeshin. E përcjell tek shkallët*). Ti... sidoqoftë, nuk ke të bësh fare me atë grupin, apo jo?
- Tom* - Si s'kam të bëj? Unë jam kryetari, por s'më kanë zbuluar akoma. Thuaji Pistolit (*përqafohen*). Më prit nesër pasdite.

Tabloja e tretë

-Dhoma, zyra e skenës së parë. Tomi në po atë gjendje gazmore të paratakimit me të fejuarën. Ndjek me fërshëllimë këngën që jepet në radio. Eshtë "Yesterday" e Bitëllsave. E shoqëron pastaj duke kënduar. Aroni është shtrirë në shtrat. Duket i përgjumur, apatik.

- Aroni* - Çuditë me këtë qetësinë tënde.
- Tom* - Pse? Ç'na gjeti? Mos po merr zjarr bota? (*këndon*). O, Yesterday...
- Aroni* - Nuk mund të jesh kaq i shkujdesur, ta hajë dreqi. (*Çohet mbyll radion*).
- Tom* - Ti më njeh, unë jetoj çastin. Pse duhet ta prish magjinë e tij me ankthin për të nesërmen?
- Aroni* - Si lum ti! Të kam zili. Unë kam dy net që s've gjumë në sy. Mendimet më vërtiten brenda një qerthulli, prej të cilit s'ka rrugëdalje. Eshtë e tmerrshme. Një herë mundohem ta bind veten që kjo që po ndodh me mua, s'është veçse një makth. Parandjenjat i kam të këqija. A duhet t'ju nënshtrohem parandjenjave? A duhet të marr tani disa vendime për jetën time? Jo aq për jetën time, sepse unë vetë ndiej këtu për brenda një forcë kryengritëse që mund t'i bëjë sfidë çdo gjëje dhe kujtdo. Për jetën e njerëzve të mi të dashur. Të guas, të fëmijëve, të prindërve...

- Tom* - Je shumë i eprët, por ke të drejtë. Pagjumësia të turbullon arsyen. (*Vishet*).
- Aron* - Ai Pistoli yt përshembull ... pse duhej të bënte parashikime ogurzeza për propozimin tonë?
- Tom* - Mos ia var torbën. Pastaj ai bëri edhe një parashikim fatlumtur. S'të kujtohet?
- Aron* - Dhe ti do të pranoje që e ardhmja jonë, imja, e fëmijëve të mi të varet vetëm nga ky pus? Të varet vetëm nga ky lëng i zi që lëviz makinat dhe që siç duket do të lëvizë edhe jetën, fatin tonë.
- Tom* - Jo, sigurisht. Po ti nga e nxore këtë përfundim?
- Aron* - Nuk e nxora unë, e nxori Pistoli. Të dy zgjidhjet e tij janë njëlloj ogurzeza. "I hodhët lekët e popullit në erë. Djersën e popullit". A s'është ky sabotim? Ose "donit ta linit industrinë pa gjak, donit t'i prisnit arteriet." A s'është ky sabotim?
- Tom* - Sikur nuk u shpreh kështu. Jam i sigurtë që nuk e përdori fjalën sabotim. Po, krejt i sigurtë.
- Aron* - Nuk e përdori, por e mendoi tërë kohën. (*Paузë*).
- Tom* - (*I mërzitur*). Po ne e kemi ndërgjegjen të qetë, të pastër, kemi punuar me ndershmeri... S'është e mundur.
- Aron* - Ma merr mendja, edhe Sandri këto fjalë po thotë tani... atje ku është.
- Tom* - Nganjëherë ti të çmend, (*vjen vërdallë*). Shpirt i dyshimit. Pse s'më le ta gëzoj këtë ditë? (*Heq kravatën, zhvishet*).
- Aron* - Ej, s'është nevoja ta ndash përgjysmë ankthin tim. Mos ma vër veshin. Unë e kam arsyen të mjegulluar nga pagjumësia. A nuk e the vetë? Ik, nisu, sa më larg kësaj angushtie, aq më mirë.
- Tom* - Po vjen Bahiri. Tani edhe të dua, s'mund të iki. (*Hyn Bahiri. Është i veshur me kostum*).
- Bahiri* - (*Nga hyrja i flet shoferit*). Shofer! Je i lirë për një orë. Kujdes se mos hedh ndonjë gotë, (*hyn brenda*). Mirëdita, shefa. (*Takohen*).
- Tom* - (*Duke parë nga vetura*). Paska hipur lart pjaca!
- Bahiri* - Më emëruan nëndrejtor të Institutit.
- Aron* - Urime, me gjithë zemër urime, ti mund ta bësh atë detyrë.

- Tom* - Kur do ta lagim?
- Bahiri* - Një ditë tjetër. Sot jam me ngut. Ka ardhur një ekip i madh qeveritar. S'e keni idenë ç'po ndodh atje. Tërmet nëntë ballësh. Kujt do t'ia bëj dorëzimet?
- Aroni* - Iljazit. Ja po të jap një shënim.
- Bahiri* - Iliazit?! Atij jevgut që merret me pompat?
- Aroni* - Iliazi është tekniku më i vjetër që kemi këtu.
- Bahiri* - Tani po e kuptoj sa poshtë paskam qenë.
- Tom* - *(Ironik)* - Nga karrigja e nëndrejtorit të gjithë të dukemi poshtë.
- Bahiri* - *(Pauzë)*. Të shkuara të harruara.
- Aroni* - Ka ndonjë përgjigje për punën tonë?
- Bahiri* - Ti do të bëje mirë të zbrisje vetë.
- Aroni* - Këto ditë nuk mundem. Ne po vazhdojmë shpimin, s'dihet ç'ndodh.
- Bahiri* - *(Cinik)*. Mirë e ke. Ja të shpërtheu nafta dhe t'u ndez. Digjemi të tërë pastaj...
- Tom* - Ti jo njëherë. Ti ia hodhe.
- Bahiri* - Për ideal, tani s'e merr vesh qeni të zotin. Të duket sikur ka dalë një magjistari i madh e i padukshëm dhe luan me fatin e secilit. Asnjëri nuk e ka mendjen në vend, të gjithë janë si në ajër.
- Tom* - Vetëm ne kemi mbetur në fund të botës, të harruar prej të gjithëve.
- Bahiri* - Të harruar? Ja, këtë e besoj më pak se çdo gjë. Sot askush s'mund të thotë se është i harruar. Si ngrysesh nuk gdhiesh. E morët vesh kush u emërua drejtor i përgjithshëm? Sigurisht, s'keni si ta dini. Fjala u hap mbrëmë vonë, mbas mbledhjes së qeverisë, por është e sigurtë. Muhamet Kodra quhet.
- Aroni* - Muhamet Kodra? Ku e kam dëgjuar këtë emër?
- Tom* - Mos është ai Muhameti i uzinës së Ballshit?
- Bahiri* - Zëvendës Ministri i Punëve të Brendshme. Tani është ish zëvendësi.
- Tom* - Po ku merr vesh ai nga nafta?
- Bahiri* - Nga nafta marr vesh unë, ndihmësi i tij kryesor. Ai di po-

- litikën e partisë.
- Tom* - *(Ironik)* E saktë, e saktë, politika në plan të parë.
- *Pauzë*-
- Aron*
Bahir - *(Befas)*. Di ndonjë gjë për Sandrin?
- Për Sandrin? *(Si i kujtuar)* Ah, për Aleksandër Spiron! Di që është arrestuar, asgjë tjetër. Kush të thotë dhe për kë të pyesësh më parë?
- Aron*
Bahir - Kaq i madh ishte grupi?
- I madh? Deri tani janë vetëm dhjetë veta. Maja e ajsbergut, thonë.
- Tom* - Një e shtata. Sipas llogarisë tënde, mbeten të hyjnë brenda edhe 70 vetë.
- Bahir* - Atë s'e di... S'është puna ime, listat i ka tjetër kush.
- Tom* - Mirë, falemnderit për informacionet, shoku nëndrejtor i Institutit. Sidoqoftë një gjë është e sigurtë.
- Bahir* - Çfarë ?
- Tom* - Që ti nuk je në ato lista.
- Bahir* - *(Pas një grime me një farë inati)*. Po kjo është më se e sigurtë. *(Del, por harron çantën)*.
- Aron* - Kot e ngacmovë.
- Tom* - *(Vjen rotull)*. Fytyrë e ndyrë. Maja e ajsbergut. Vjen këtu si Kasandra. Qelbësira.
- Aron* - Nuk e ka me ty!
- Bahir* - *(Hyn papritur, merr çantën)*. Harrova çantën. Për Sandër Spiron që pyete qëpari?
- Aron* - Po.
- Bahir* - Më duket se ia internuan familjen. Më tha një i njohuri im. E kishte parë duke ngarkuar plaçkat në "Skodë" *(mundohet të ndryshojë gjendjen shpirtërore)*. Shefa, mos ma vini re. Unë nuk ju harroj. Do t'ju ftoj pa tjetër një ditë në "Turizëm". Do ta lagim se s'bën.
- Aron* - Do të kthehesh prapë këtu?
- Bahir* - Nëse ke ndonjë porosi...
- Aron* - Mund të kem.
- Bahir* - Atëherë, më prit, *(del)*.
- Tom* - Kanë internuar familjen e Sandrit? Me të vërtetë e ka ky

- sy qeni?
- Aroni* - Ndoshta don të na provokojë?
- Tomi* - Pse të na provokojë?
- Aroni* - Që të shprehemi. (Pauzë).
- Tomi* - Sot qenke vërtet shpirti i dyshimit. Harroje! Ose pi që ta harrosh. Kam raki aty.
- Aroni* - Sikur kishe takim me të fejuarën?
- Tomi* - Mund të vete edhe më vonë. Ajo nuk ikën
- Aroni* - As unë nuk iki...
- Tomi* - Ti... don të të le vetëm?
- Aroni* - Nuk dua të të le vetëm ty. Unë jam mësuar me vetminë.
- Tomi* - Ah? Që kur kështu? Ti ke grua, ke fëmijë. Kujtova se do të thoshe se jam mësuar unë me vetminë.
- Aroni* - Atëherë le të themi se edhe mua më duhet të mësohem me vetminë.
- Pauzë-
- Tomi* - E di që s'të kuptoj. Je enigmatik.
- Aroni* - Aq më mirë, se deri tani kam qenë libër i hapur.
- Tomi* - Po shkoj, por do të kthehem shpejt.
- Aroni* - Si të duash. (*Tomi del. Aroni e mbyll radion. Mbyll derën me shul. Mbyll perdet e dritareve. Pastaj hap derën. del te pragu dhe vëzhgon rreth e qark. Fik dritën. Mbetet vetëm një kënd drite që bie mbi tryezën e punës. Në gjysmë terr. Aroni ulet dhe merr një letër të bardhë. E shikon në dritë si për t'u bindur nëse vërtet është e bardhë. Ashtu bën edhe me stilolapsin. Të gjitha veprimet e tij të ngadalshme shprehin një dyshim i cili ngjan si i palogjikshëm.*)
- Aroni* - (*Fillon të shkruajë. Zëri i tij.*) " E dashura ime , kjo është letra më e çuditshme që të kam shkrojtur ndonjëherë, por ti mos u tremb. Është edhe më e çuditshme se sa letra e parë e dashurisë, të cilën ti e mban në kutinë e sendeve të tua si kujtimin më të bukur të rinisë sonë. Këtë letër nuk duhet ta futësh aty. Në asnjë mënyrë mos e mbaj në kuti. Do ta kuptosh një ditë përse. Në fund do të shkruaj se ç'do të bësh me këtë letër...
- Pyetja e parë që do të vijë ndërmend, është përse nuk vij vetë që të ta them e të të sqaroj këto që po të shkruaj. Ke

dy muaj pa ardhur do të thuash. Si s'të mori malli për Irenën e vogël. Ie më për të tjerët që nuk pyet shumë. S'është e vërtetë. Më ka marrë malli kaq shumë sa s'ka natë që mos t'ju shoh në ëndërr. Thonë se ëndrrat s'janë gjë tjetër, veçse plotësimi në gjumë i dëshirave të porealizuara. Ah, ç'po shkruaj budallallëqe. Nuk do të vij. Siç po rrjedhin ngjarjet, del se kam bërë mirë që nuk kam ardhur fare këto dy muaj.

(Vazhdon të shkruajë me shpejtësi, zëri i sfumohet. Muzikë dramatike. Shfaqet Aneta. Ajo është e veshur me rroba nate dhe vazhdimisht duket sikur mërdhin. Ata rrinë tërë kohën larg njëri - tjetrit.)

Aneta

- Aron, nuk do të biesh në shtrat?

Aroni

- Ç'më duhet. Nuk jam i sëmurë.

Aneta

- Jo, kush e tha? Ti nuk je i sëmurë.

Aroni

- Atëherë përse ma përmende shtratin?

Aneta

- Që të prehesh. Ti je i lodhur. Je shumë i lodhur.

Aroni

- Ç'don të thuash me atë që "je shumë i lodhur"?

Aneta

- Asgjë tjetër...

Aroni

- Mos deshe të thuash se edhe trupi, edhe nervat, edhe mendja ime janë lodhur?

Aneta

- Jo... vetëm. Ti ke qenë gjithmonë i qetë, me nerva të forta.

Aroni

- Edhe mendjen e kam më të kthjellët se kurrë. Më beson?

Aneta

- Të besoj. Qetësohu.

Aroni

- *(Duket sikur shkruan).* E dashur. Ti që më ke besuar në çdo çast të jetës, ti që me besimin tënd ke zhdukur nga jeta jonë çdo hije xhelozie, ti që...

Aneta

- Jo, jo, kjo është e pamundur!

Aroni

- Besomë. Edhe tani jam më i kthjellët se kurrë.

Aneta

- Asnjëri s'do të na besojë.

Aroni

- Njerëzit s'më duhen. Duhet të na besojnë gjyqtarët.

Aneta

- Do të më marrin për të çmendur... Kush do të dëshmojë për mua?

Aroni

- *(Mendohet).* Po, këtu ke pak të drejtë (pauzë). E gjeta: do të bisedosh në fillim me Vjollca Asllanin.

Aneta

- Me Vjollca Asllanin? Me atë s'më lidh asgjë. Ajo s'ka qenë kurrë shoqja ime.

- Aroni* - Por është përpjekur të bëhet shoqja jote. Ka dashur shumë...
- Aneta* - Unë s'e kam duruar dot kurrë. Sa herë vinte vizitë, mezi prisja që të kthente krahët.
- Aroni* - Tani do të vesh vetë. Është grua e ndarë nga burri, prandaj do të besojë më lehtë.
- Aneta* - Jo, nuk, s'mundem. S'di të gënjej. Ajo do ta kuptojë menjëherë.
- Aroni* - Gratë e ndara janë avokatet më të mira për gratë e tjera që kanë mosmarrëveshje bashkëshortore. Mjafton të thuash se burri yt kohët e fundit po sillet shumë i ftohtë me ty. Ai ka dy muaj që nuk është kthyer në shtëpi, i thuaj, gjë që s'e ka bërë kurrë më parë. Ka marrë vetëm një herë në telefon dhe është shfajësuar me punët e shumta, por ty të ka ardhur në vesh se të paktën dy herë duhej të vinte vetë për të sjellë disa raporte të rëndësishme. Mirëpo është shmangur dhe ka dërguar një teknik të mesëm. Jam në një gjendje shpirtërore të tmerrshme. Më kanë mposhtur dyshimet, ndonëse më parë ai s'më ka lënë asnjë rast për xheloz. U shkatërrova fare,- thuaji. Kaq duhet dhe pastaj e ka merak vetë ajo. Pas njëzetë e katër orëve gjithë pallati do ta dijë se unë jam ngatërruar me një femër të bukur e të re por të pamoralshme, që më ka marrosur fare. Në këtë moshë dashuria i deh burrat si opium. Ata e ndiejnë se ky është rasti i fundit që u vjen në shteg dhe kapen pas tij si i mbyturi.
- Aneta* - Ah, Ç'janë këto mendime? Më duket se s'po të njoh.
- Aroni* - Pikërisht kjo duhet. Të pohosh se kam ndryshuar aq shumë, sa ti s'më njeh më.
- Aneta* - O Zot, po përse? Përse gjithë kjo?
- Aroni* - Mos thuaj se nuk kupton asgjë!
- Aneta* - Nuk dua ta kuptoj. Përse duhet ta pranoj këtë njollë të zezë në jetën time? Më mirë pranoj çdo rrezik tjetër se sa këtë..
- Aroni* - Ti je e mençur, e dashura ime. Ti e di që unë s'jam as i pari e as i fundit që po veprojmë kështu.
- Aneta* - As që dua ta di për të tjerët. Nuk kam parë kurrë se ç'bëjnë ata të tjerët... Të kam parë vetëm ty.

- Aroni* - Por nuk jemi vetëm ne të dy. Eshtë edhe Eltoni. Pas maturës duhet të vazhdojë universitetin, mirëpo, pas asaj... që pritet zor se do t'i japin degën elektronikë. Me diplomën e shkëlqyer që ka, një degë të çfarëdoshme edhe mund t'ia japin. Ai s'duhet të bëjë naze. Mjaft që të studiojë. Eshtë Blerta që duhet të vazhdojë pa tjetër violinën në shkollën e mesme të muzikës. Eshtë dhe Irena e vogël... Pa mendohu pak e dashur ç'përgjegjësi kam para tyre? Ty edhe mund të të merrja, sepse e di që ti më mirë pranon të rrosh bashkë me ankthet e mia se sa të rrosh në një qetësi të gënjeshtërt. Por ne nuk jemi vetëm, prandaj nuk na lejohet. Nuk më lejohet. Nuk më...
- Aneta është zhdukur. Ai vazhdon të shkruajë me nxitim. Hyn Bahiri.*
- Bahiri* - Po shkruan?
- Aroni ngre kokën. Eshtë i hutuar.*
- Bahiri* - Pse gjithë kjo errësi? (Qesh) Dukesh si i përbetuar.
- Aroni* - Çfarë? I përbetuar?
- Bahiri* - Kështu u thënkuan komplotistëve në gjuhën e pastër shqipe. A e di kush ma tha?
- Aroni* - Si mund ta di?
- Bahiri* - Gazetari Jonuz Fterra. Ai është i dërguar i posaçëm i "Zërit të Popullit" në zonën naftëmbajtëse. Dje mbrëma, ndërsa pinim nga një gotë të vogël tek aneksi i "Turizmit", më tha: Ata janë një grup i madh të përbetuarish që donin ta gjunjëzonin ekonominë tonë, duke i hequr asaj shpirtin.
- Aroni* - (Me po atë hutim). Tek aneksi i "Turizmit"?
- Bahiri* - E pra, pse çuditësh? Tani unë bëj pjesë në nomenklaturën për të cilën është i rezervuar ky lokal.
- Aroni* - Ah, po, harrova. Ti bën pjesë në nomenklaturën e atij lokali.
- Bahiri* - Shumë i shpërqendruar po më dukesh. Mos ke nevojë për ndonjë ndihmë?
- Aroni* - Jo, jo!
- Bahiri* - Mos më kurse, ne jemi shokë. Unë nuk e harroj kurrë atë që ke bërë ti për mua.
- Aroni* - (Duke mbyllur derën). Ky pus do të më thinjë fare! Mund t'ia çosh këtë letër sime shoqeje?

- Bahiri* - Ç'pyetje është kjo?
- Aroni* - Që sot!
- Bahiri* - (*Shikon orën*). Do të arrij natën.
- Aroni* - S'ka gjë. Edhe po pati fjetur, zgjoje.
- Bahiri* - (*Me habi*). Por, pse nuk zbret vetë? Eja me mua. Nesër të kthej prapë me makinë.
- Aroni* - Nuk mundem. Ti e di vetë...
- Bahiri* - Këtu është edhe Tomi. (*Pauzë*). S'di çfarë t'i them kur të më pyesë për ty.
- Aroni* - Asgjë mos i thuaj, bile ti mund ta fusësh letrën te e çara e derës ku futen gazetat. Mirë u kujtova, fute te e çara e derës.
- Bahiri* - Je bërë tepër misterioz.
- Aroni* - (*I mërzitur*) E çfarë misteri ka këtu? Ne burrat e martuar që punojmë larg shtëpive, e kemi të parathënë të vuajmë nga dyshimet e grave, nga xhelozia e tyre që ta bën jetën skëterrë. Si lum ti që je ende beqar. Gratë janë të vështira. Për to sedra dhe dëshirat e tyre janë mbi çdo gjë. S'duan t'ia dinë ato për detyrat shtetërore, për shoqërinë midis burrash, për atë një çikë liri që burri e ndien më shumë se kushdo në një kafene plot me tym...
- Hyn Tomi*-
- Bahiri* - Tom, paske vlarë veten me dorën tënde.
- Tomi* - Ç'është ky budallallëk? Posti i ri kërkon seriozitet.
- Bahiri* - Ta shpjegon Aroni atë budallallëkun. Si thoni, ndahemi tani? Më falni kusuret shefa, e mos më harroni se edhe unë s'do t'ju harroj.
- Tomi* - Faleminderit. Gjithësesi... tani është më mirë të harrosh se ke qenë vartësi ynë.
- Bahiri* - Ç't'i bësh? Rrota e fatit!
- Tomi* - Sidoqoftë, unë do ta harroj që ke qenë vartësi ynë.
- Bahiri* - Ta kam falur ironinë. Unë dua të mbetemi miq, shokë...
- Aroni* - Dhe do të jemi Bahir, do të jemi. S'ka arsye pse të mos jemi.
- Bahiri* - Ashtu uroj edhe unë. Njerëzit ngrihen, ulen, rrëzohen fare... ama shoqëria është tjetër gjë. Është ... supreme. (*Përqafohet*)

me zell. Del).

- Tom* - (Me maraz) Supreme! Po ky është edhe pa kulturë.
- Aron* - Pse u ktheve kaq shpejt?
- Tom* - Alma ishte në një konferencë të gruas. Kush rrinte të dëgjonte pordhët e vjehrit... (pauzë). Ai... ndenji gjatë me ty?
- Aron* - Priti deri sa mbarova një letër.
- Tom* - Është bërë i padurueshëm. Edhe më parë i tillë ishte, por ne e duronim sepse na vinte keq. Tani që ia hodhi dhe u bë i madh, ke për ta parë si do të hakmerret.
- Aron* - Kundër kujt?
- Tom* - Kundër gjithë atyre që e kanë marrë nëpër këmbë, që e kanë përbuzur e poshtëruar.
- Aron* - Ne nuk e kemi poshtëruar ...
- Tom* - Njerëz si ai fyhen nga një fjalë, nga një shikim. Nuk ta falin kurrë.
- Pauzë-
- Tom* - (Që s'ia vë veshin). Atë letrën... për kë e kishe.
- Aron* - Për time shoqe.
- Tom* - Gabim bërë që ia dhe.
- Aron* - Pse?
- Tom* - Ai do ta hapë.
- Aron* - (Disi i tronditur). E përse duhet ta bëjë këtë gjë?
- Tom* - Sepse bëhet kureshtar më keq se gratë.
- Aron* - Vërtetë është i shthurur, por nuk besoj të jetë edhe i poshtër... Nuk na ka dhënë rast.
- Tom* - Sepse ishte i dobët, pa mbrojtje, si një trumcak i mardhur.
- Aron* - Jo, jo. Ti gabohesh. S'ka për ta bërë një veprim të tillë. Do të ishte ... e ulët. (Mundohet të qeshë). Je mbushur i tëri me vrer.
- Tom* - Çfarë i shkruaje?
- Aron* - (Po ashtu). Probleme intime. (Si me vete). Nuk është e mundur. Pse më torturon me këto dyshime?
- Tom* - Mund ta di çfarë i shkruaje?
- Pauzë-
- Tom* - Kur s'më beson... (bën të ngrihet).
- Aron* - Ulul! (Vjen rotull). Tom. Unë do të ndahem nga Aneta.

- Tom* - (Brof). Mos u çmende?
- Aroni* - Ulu, dëgjomë. Unë... duhet të ndahem! (Thekson). Duhet!
- Tom* - O Zot. S'të kuptoj fare.
- Aroni* - Nuk është e vështirë të më kuptosh...
- Tom* - S'qenke mirë sot!
- Aroni* - Nuk kam të drejtë t'i tërheq edhe ata në greminën time...
- Tom* - Këto shkruaje në atë letër?
- Aroni* - Letra iku tani, është vonë...
- Tom* - Ç'marrëzi ke bërë, Aron. (Ngrihet). Ç'marrëzi! (Bën të ikë).
- Aroni* - Ku vete?
- Tom* - Duhet ta gjejmë, ta arrijmë. Ndoshta ende s'është nisur. Mund të jetë kthyer në kafene.
- Aroni* - Iku. E pashë makinën nga dritarja kur po kalonte tek kthesa e Qafë Malit.
- Pauzë-
- Tom* - E tmerrshme.
- Aroni* - Nëse vërtet don të më ndihmosh, ti mund të bësh diçka tjetër.
- Tom* - Ti e di... mund të kërkosh ç'të duash.
- Aroni* - Po sikur të të kërkoj të dalësh dëshmitar në gjyqin tonë.
- Tom* - Në gjyq? Po, ç'mund të thosha aty?
- Aroni* - Që... që unë kam patur lidhje me një femër.
- Tom* - Me një femër? Kush do ta besonte?
- Aroni* - Aneta. Gratë këtë e besojnë më lehtë se kushdo tjetër.
- Tom* - Dhe cila do të ishte kjo femër?
- Aroni* - (I hutuar). Cila do të ishte? S'ka rëndësi. Pa emër.
- Tom* - Pa emër për gjyqin s'ka asnjë vlerë.
- Aroni* - Nuk mund të bëhet që... për ta ruajtur nga njolla të mbetet e panjohur?
- Tom* - Jo, nuk bëhet!
- Aroni* - Kam dëgjuar se pranohen edhe raste të tilla.
- Tom* - Aron, s'qenke mirë vërtet. Nëse duhet të dëshmoj, unë do të them se kjo letër ka qenë një lajthitje e çastit dhe se ti e ke shkrojtur në një gjendje të mjerueshme shpirtërore, i lodhur nga puna, i tronditur nga ngjarjet e kohëve të fundit... këto po. Mund t'i them nëse të duhen.

- Aroni* - S'ke për të thënë asgjë. Askush nuk do të kërkojë që të dëshmosh.
- *(Pauzë)*- Je tepër i padjallëzuar dhe dritëshkurtër, si të gjithë naivët.
- Tomi* - Kurse ti.. Ti je njeri i sëmurë.*(Pauzë. Lëvizin të dy të nervozuar).* Megjithatë... nëse vërtet duhet ndihma ime, ti e di, mund të mbështetesh tek unë kur të duash. Por më parë mendohu. Mendohu. Mendohu ose këshillohu me ndonjë shok tjetër.
- Aroni* - Me kë? Sandri është në burg, unë ty të kam.
- Tomi* - Për këshilla mua s'më ke. S'kam asnjë përvojë. Për ndihmë, po.
- Aroni*
Pistoli - *(Entuziast).* Ja, këtë prisja prej teje.*(Trokitje. Hyn Pistoli)*
- Kalova këtej dhe dëgjova zëra.*(Heshtje).* Mos u shqetësoni. Nuk e kam zakon të dëgjoj tek e çara e derës. S'më shkon ky rol. Kur dua të marr vesh diçka, përdor mënyra të tjera.*(Pauzë).* Po ju ç'kini kështu? Mos jeni grindur?
- Tomi* - Sigurisht që jemi grindur. Vendimet teknike nuk merren qetësisht, sikur ha qershi.
- Pistoli* - Më vjen mirë që keni kontradita.
- Aroni* - Pse kështu?
- Pistoli* - Sepse e vërteta del nga debati. Debati lind kur ka pozicione të ndryshme. Pozicionet e ndryshme shprehin pikëpamje të kundërta, ide që ...
- Tomi* - Na e bëre si përralla e rrepkës.Plaka pas plakut,plaku pas mbesës, mbesa pas... Hiq e hiq...
- Pistoli* - Më në fund e shkulën rrepkën. Hë? Mrekulli... Rrepka shkulet!
-*Pauzë*-
- Tomi* - Mos don të na futësh në thekra të gjata?
- Pistoli* - Në thekra të gjata futet njeriu që don të fshihet. Kurse ju jeni të hapur.
- Tomi* - Domethënë shkulja e rrepës nuk është barabar me shkulje sekreti?
- Pistoli* - Bah! Me ju të dy? *(Pauzë).* Kam makinën jashtë. Po shkoj tek Ajdini. Po vjen?
- Tomi* - Sigurisht *(shikon orën).* Alma duhet të jetë kthyer. Aron,

eja edhe ti.
Aroni - Ah, jo. Sot do të ndihesha i tepërt. (*Dalim. Mbyll derën. ul perdet*). I tepërt! I tepërt! (*Jehona e ndërthurur e fjalës "i tepërt". Errësimi i skenës*)

Tabloja e katërt

(Në antëpinë e Almës. Kanë shtruar një tryezë të vogël. midis kolltukëve. Pistoli duket në një gjendje gazmore, me një si ethe profesionale. Tomi pi i ngrysur. Alma shërben).

Alma - (*Almës*). Për ideal të partisë, m'u duk e pabesueshme. Duhet të ishte vetë aty dhe të shikoje me sa shkathtësi e vërtiste bisedën. U shmang si mjeshtër. Gjëja e parë që më vajti në mendje ishte " Ky qenka i prirë për organet tona".
Pistoli - (*Qesh*). Ai? Po ai është thes i shpuar.
Alma - Ashtu pandehja edhe unë. Më ke befasuar, Tom. (*E imiton*)
Tomi "Kot e ke, ne s'futemi në ato thekra". Më ke shastisur.
Pistoli - (*I zyrtë*). Ky nuk më duket kushedi çfarë humori!
 - Varet nga gjendja shpirtërore, i dashur. Po ju lë vetëm, po shkoj ta ndihmoj xha Ajdinin, në kopsht. Më bën mirë pak punë fizike. Kam filluar të lëshoj bark(*del*).
Alma - Tom, pse je kaq i zyrtë? Ç'të ka ndodhur?
Tomi - Asgjë. Më mërziti. Kishte qejf të dërdëlliste shumë.
Alma - (*Pas një ngurrimi*). Ai.. ai don të bëjë një bisedë serioze me ty.
Tomi - Të rëndësishme deshe të thuash. Të vështirë ndoshta?
Alma - Mundet. Megjithëse mua s'më duket kushedi sa e vështirë.
Tomi - Pra ti e di. Ty ta paska thënë!
Alma - Jo krejtësisht.. domethënë, jo në mënyrë të drejtpërdrejtë...
Tomi - Si të duket kjo mënyrë të thëni ty?
Alma - Oh, nuk e çaj kokën shumë. Kështu ka folur gjithmonë.
Tomi - Që në fëmijëri?
Alma - (*E habitur*). Tom! Harrove që ai është dhjetë vjet më i madh

- se sa unë? Si mund ta di se si ka qenë në fëmijëri?
- Tom* - Të pyeta. sepse disa njerëz e kanë tinëzarinë aftësi të lindur. Por ai nuk e ka të lindur. E ka ves profesional. Prandaj mënyra e tij mua më duket e ndyrë. E neveritshme.
- Alma* - Ndoshta. Ti ... ke pak frikë?
- Tom* - Frikë? E përse?
- *Pauzë* -
- Alma* - (*Lozonjare*). Sepse ... I dashuri im ti je si një libër i hapur dhe nuk di të mbyllësh asnjë fletë për të tjerët. Ky është një virtyt i mrekullueshëm megjithëse si zakon, është i keq.
- Tom* - (*E largon disi*). Sonte më dukesh shumë e mençur!
- Alma* - Nuk të pëlqej kështu?
- Tom* - E mençur dhe... pak tinëzare, si ai. Mos është çështje trashëgimie?
- Alma* - Nuk jam tinëzare! Jam vetëm e dashuruar. E dashuruar pafundësisht, deri në sakrificë. Ta dish!
- Tom* - Sikur deshe të më thoje diçka tjetër?
- Alma* - (*E fyer*). Para kësaj, të tjerat janë hiç! Të paktën për mua!
- Tom* - (*I prekur*). Për mua, njëqindfish!
- Alma* - Nuk jam fort e sigurtë.
- Tom* - Je! (*E afron*). Je, por të pëlqen të dëgjosh se je e dashuruar, se përveç teje në jetën time nuk ka vend për asnjë tjetër. Se për një jetim si unë që s'ka njohur as nënë as baba, as motër, as vëlla... një dashuri e tillë është vetë jeta. Pa to edhe jeta e humbet kuptimin. (*Alma don ta ndërpresë, por ai ia mbyll gojën duke e puthur gjatë...*). Prit, dua të mbetesh edhe pak pa frymë nga puthja ime. E ndjej se po vjen diçka e errët që më tërheq drejt një bote të panjohur, drejt një misteri që ndërsa unë përpiqem ta zbujoj, ai më vret vullnetin, më shuan forcat, dëshirat dhe ashtu i shpërbërë, s'jam më kurrkushi. E di që të duket si përçartje, s'kam ç'bëj... Kam bërë një jetë që të gjithëve u dukej e lehtë, e shkujdesur, gazmore. Askush nuk e ka ditur se kjo ishte vetëm gjysma ime. Gjysma e ditës, e dritës. Gjysma tjetër i përkiste natës, vetmisë, trishtimit, dhimbjes, gërryerjes për fatalitetin që më dënoi të mos kem kurrkënd...

Pastaj në jetën time u shfaqe ti, dhe ti ishe e vetmja rreze që mund ta çajë natën time. E kupton ç'je ti për mua?

Alma

- (*Pauzë. I varët në qafë*). E gjithë kjo ishte kaq e papritur, kaq e bukur, kaq e mrekullueshme, do të desha të më përsëritej çdo natë.

Tomi

- Me kusht që edhe ti... mos më mbash asnjë të fshehtë.

Alma

- Kurrë!

Tomi

- Edhe kur të ta kërkojë ai... Pistolja?

Alma

- (*Me humor*). Pah, ç'emër që ka! Tingëllon vërtet si pistoletë. (*Qeshin*).

Tomi

- Ende s'do të ma thuash ç'kërkon ai prej meje?

Alma

- I dashur... Unë s'kuptoj shumë nga këto gjëra, por ai... për ato rastet në naftë... ai thotë se këto nuk janë thjesht ca gabime teknike.

Tomi

- E di. Ata i quajnë të qëllimshme. Sabotime.

Alma

- Ata duan të na marrin pushtetin, thotë.

Tomi

- Të na marrin pushtetin? Po çfarë pushteti kemi ne? Ti për shembull, çfarë pushteti ke?

Alma

- Unë? Unë them ashtu në përgjithësi.

Tomi

- Këtu është e keqja. Ne flasim gjithmonë "në përgjithësi". Në emër të të gjithëve, të popullit. Kur flet në emër të të gjithëve, pa e ditur ç'duan ata "të gjithë" ke folur në emër të askujt. Kjo është thjesht propagandë, një mënyrë e lezetshme për të të trullësuar kokën, që aty të mos mbetet më asgjë përveç disa shtampave." Hero i Popullit", "Armik i Popullit", "Revolucionar", "kundërrevolucionar", "Sulmues"... "Sabotator".

Alma

- (*I zë gojën*). Tom! Të lutem! Mos më llahtaris!

Tomi

- Pse? Nuk janë të vërteta?

Alma

- Disa të vërteta është e mira të mos i thuash kurrë. Ne duhet të mendojmë për të ardhmen tonë. Me të kaluarën dhe rrethin familjar që kemi, ajo është e sigurë, po ku i dihet fati?

Tomi

- Të gjithë bredhim në këtë botë, ngarkuar me thesin e fatit. Të thënës s'ke ç'i bën. Do ta pranosh si të vijë. Po kur jetën ta shkatërrojnë të tjerët, titullarët, ata... drejtuesit e fatit, shteti

vetë, ky nuk quhet më fatalitet.

Alma

- Si ndryshe?

Tom

- Mos u bëj naive. Ky është ndëshkimi që shteti e bën për të siguruar qetësinë e vet.

Alma

- Sidoqoftë... ti nuk do ta rrezikosh dashurinë tonë, apo jo? Do të bësh të pamundurën ta ruash! Përderisa ajo është kaq e shtrenjtë për mua dhe për ty...

Tom

- Do ta ruaj me çdo çmim! Përveç dinjitetit!

-Ka hyrë Pistoli pa u vënë re-

Pistoli

- Jam me ty!.. Humbja e dinjitetit është fundi i personalitetit. Pas kësaj ç'mbetet të jetë njeriu? Një plesht.

Alma

- *(Me humor)*. I poshtër. Spiun i keq, si hyn kështu pa trokitur?

Pistoli

- Në portat e hapura, zakonisht nuk trokitet... Si mund të trokasësh kur je midis njerëzve për të cilët nuk ruan asnjë të fshehtë?

Tom

- Eshhtë e mundur kjo vallë?

Pistoli

- S'e luan as topi.

Tom

- Kisha parasysh profesionin tuaj. Detyrën!

Pistoli

- Detyra ime mbaron pasi kyç dosjet në kasafortë. Më pëlqen edhe mua që të më shohin si një qytetar të zakonshëm, si njeri të afërt e të besueshëm. Sidomos njerëzit që dua, fa-refisi... përndryshe detyra do të më kthehej në një torturë *(tek dollapi)*. Mund të mbushim edhe nga një gotë, kushërirë? *(Shtie vetë)*. Meqë ti s'po kujtohesh! *(I jep Tomit)*. Gëzuar! *(Pi)* Sigurisht sot jam i mërziur. Mbase s'dukem ashtu, por jam... Dua diçka që të argëtohem, të harroj *(Tomit)*. S'ke ndonjë gjë të re?

Tom

- Të re? Çfarë?

Pistoli

- Anekdotë de!

Alma

- *(Paralajmëruese)*. Veç jo politike hë! Se ai merr një leje kallimi nga ty dhe pastaj i tregon tryezave ku të mundë!...

Pistoli

- Të jetë si të jetë. Më keni mua.

Tom

- *(Disi me mërzi...)*. Do të na zemërohej Alma.

Pistoli

- Kaq me spec është?

Tom

- Jo, vetëm se është pak... e shthurur.

Pistoli

- S'ka gjë, tani ajo u mësua me to. U emancipua. *(Almës)*.

Apo jo?

Alma
Tomi

- Ç'të bëj, s'mund t'i zë veshët.

- Meqë e doni, (me pak mëzë). Po t'ua kem treguar më parë, më ndërprisni.

Pistoli
Tomi

- Mirë, mirë, jepi.

- Në një dyqan punonin dy fotografë. Njëri i pashëm, çapkën, feminist. Tjetri i shëmtuar, i turpshëm, i virgjër. Thotë ky i dyti:... Ore flasin për ty që... kur mbyllesh në dhomën e fotografimit. ... ua fut duart femrave. E vërtetë është?

- Disave po, por jo të gjithave se të pjell belaja, - thotë i pari, çapkëni.

-Po si e njuh se cila është me namuz dhe cila ia thotë asaj pune?- pyet ai i virgjëri.

- Kjo është çështje syri dhe praktike, - thotë i pari.

- Po unë si t'ja bëj që t'i njoh?- pyet tjetri.

- Zor e ke, se syri yt nuk është i stërvitur, po do të ndihmoj unë. Kur të vijë ndonjë nga ato të dorës, unë do të këndoju këtu te banaku atë këngën "me Bashkimin Sovjetik". Ishte një operetë ato vite dhe aty kishte ca arie për derrat, derrkucat dhe një tjetër për BS. Ashtu vendosën. Vjen një vajzë e re, bukuroshe e hedhur. Çapkëni ia merr këngës "me Bashkimin Sovjetik". Tjetri fillon t'ia rregullojë pak pozicionin e kokës. Ia rregullon flokët, e prek pak në qafë ai i gjori. Deri këtu çdo gjë vete mirë. Pastaj përkulet dhe e puth një çikë në faqe. Kur fap kërcet një shuplakë surratit dhe vajza ia mbath drejt e në rrugë. Del ai mëkatari duke mbajtur faqen me dorë. I vërsulet shokut. E ku ishte me BS ajo, o të dhjefsha tët ëmë! Ajo ishte me imperializmin amerikan!... (qeshin).

Alma
Pistoli

- Çka. Prisja më keq.

- Edhe ai ka filluar të emancipohet. Nuk tregon anekdota banale. (Ngre gotën). Thatë, pa një çikë meze do ta shtyjmë?

Alma

- Po hidhem deri në dyqan. Mund të ketë ndonjë ulli. Tjetër mos kërkoni!...

Pistoli
Tomi

- Po hë? Ç'bëhet andej nga pusi juaj?

- Asgjë e veçantë. Ka të ngjarë të ndërpresim shpimin dhe të ikim...

- Pistoli* - Dështim edhe këtu?
- Tomi* - Dreqi e merr vesh këtë punë.
- Pistoli* - Thonë se dreqi ka fytyrë njeriu.
- Tomi* - (Me një farë inati). Jo. ka fytyrë cjapi.
- Pistoli* - Në të vërtetë ka shumë fytyra. sepse përdor maskë. Kështu që... si tek barcoleta jote, nuk e kupton dot, është me Bashkimin Sovjetik apo me imperializmin amerikan...
- Tomi* - Mund të jetë dhe ashtu (pi një gotë).
- Pistoli* - Ja, ti për shembull... je me BS apo s'je?
- Tomi* - (I zymtë). Ç'lloj shakaje është kjo?
- Pistoli* - E kupton ti, e kupton...
- Tomi* - Bjeri drejt. Kur ma sjell rrotull, më bëhet se ke qëllime të këqija.
- Pistoli* - Si mund të kem qëllime të atilla ndaj teje? Ti je njeriu ynë i fisit. Alma është dashuruar marrëzisht pas teje. Ne s'mund të bëhemi shpirt kazmë. Duam s'duam, tani je brenda trungut tonë. brenda biografisë tonë. Qëllimi i vetëm është të të ndihmoj, të të mbroj.
- Tomi* - Jam bërë për të mbrojtur vallë?
- Pistoli* - Përndryshe nuk do ta hapja këte bisedë.
- Tomi* - Prej kujt do të më mbronin?
- Pistoli* - Prej atyre që ti i quan miq, por që mund të të tërheqin në humnerë.
- Tomi* - Edhe prej Aronit?
- Pistoli* - Edhe prej Aronit.
- Tomi* - Në rastin e tij gaboheni kryekëput. Ai është miku im më i mirë. Për të unë i vë duart në zjarr.
- Pistoli* - Ne do të mbajmë larg atij zjarri...(pauzë). Pse don të ndahet ai nga e shoqja?
- Tomi* - (I shokuar). Çfarë?
- Pistoli* - Pse kërkon të bëjë divorc, thashë.
- Tomi* - Unë... nuk... (befas). Po ju nga e dini këtë?
- Pistoli* - Sigurisht jo prej tij. Me mua ai s'do të bënte këtë bisedë.
- Tomi* - S'është e mundur (i hutuar). Ose ... ndoshta keni qenë i fshehur diku dhe na keni përgjuar?
- Pistoli* - Shiko, mos më fyej! Përgjimi i atij lloji nuk është i denjë

- për mua! (*Nxjerr letrën*). Ua ka zënë syri këtë letër?
- Tom* - (Zë kokën me dorë). Bahiri ! Fëlliqësira! (*Befas*) Ju s'duhet ta shfrytëzoni këtë letër.
- Pistoli* - Letra do të vejë në vend brenda ditës së sotme. Mua s'më intereson fare Aroni. Tjetërkush merret me të. Tjetërkush do të vendosë. Letra më duhet për ty.
- Tom* - (*Në po atë gjendje*). Për mua?
- Pistoli* - Vetëm për ty. Që ta kuptosh përfundimisht se situata ku ke rënë, është tepër e rrezikshme. Pusi juaj dështon, por ndërkohë ju keni kërkuar të vazhdojë shpimet - ndryshe, të hidhet lek i popullit në erë. Shokun tënd, përgjegjës in kryesor e ka pushtuar frika. Paniku. Ka parandjenjë se shpata e drejtësisë popullore do ta godasë edhe atë. Pret të arrestohet, të dënohet. Ndërgjegja e njoletur e mundon dhe në këto përpëllitje, duke e parë të mbyllur rrugën e vet, përpiket të shpëtojë gruan e fëmijët. Po të jetë ndarë prej saj, drejtësia do t'ia kursejë të shoqen, nuk do ta trajtojë si familjen e armikut të klasës. Truk i zgjuar. S'ke ç'thua. Shumica e bëjnë këtë akt ndarjeje pas dënimit, pasi është provuar fajësia. Dikujt i merrret parasysh, dikujt jo. Ai i del së keqes përpara. Tani unë të pyes ty. Përse kjo frikë? Përse ky panik, ky tmerr kur ende askush nuk e ka marrë për hetim?
- Tom* - Eshtë... ku ta dish? Eshtë një parandjenjë ogurzezë- e the vetë. Një ngulitje në tru që i bën presion, e mundon, ia humbet logjikën.
- Pistoli* - Po pse? Pse? Mos ka vuajtur ndonjëherë nga mania e persekutimit?
- Tom* - Jo.
- Pistoli* - Jo! Ka qenë një nga njerëzit më gjakftohtë, më të qetë e më të logjikshëm që ti ke njohur. Vetë ma ke thënë këtë.
- Tom* - Unë? Kur? Sikur s'më kujtohet.
- Pistoli* - Ma ke thënë. Sidoqoftë, ti për të tillë e njeh. Nuk ka dhënë asnjë shenjë çekuilibri psiqik. Atëherë, përse?
- Tom* - Por.. në këtë atmosferë, kur përditë dëgjon se arrestohen kolegë, shokët e tu që i ke njohur për njerëz të ndershëm, ankthi lind vetvetiu. Të zë për fyti, të mbyt, të errëson me-

ndimin, të çmend.

Pistoli - Vetëm kur je fajtor. Është pesha e fajit ajo që të krijon ankth. (Pauzë). Kurse ti deshe ta vije dorën në zjarr. (Tomi nuk zë dot vend. Ndalon herë pas here te tryeza me pije. hedh nga një gotë).

Tomi - U bë për të ikur e për të marrë malet... T'i vesh ferrën gjithçkaje.

Pistoli - Aspak. Mjafton të kesh dikë që të të mbrojë pak. Mjafton të mendosh pak më shumë për vete.

Tomi - S'kam menduar asnjëherë vetëm për vete. Jetën e kam marrë si më ka ardhur...

Pistoli - Sepse nuk e ke parë që një hap më tej është rreziku, është fundi i atyre kënaqësive të përditshme, mungesa e të cilave do të ta bënte jetën ferr. Për fat të mirë, s'është vonë që t'i ndreqim disa nga marrëzitë e njohura të rinisë tënde. T'i ndreqim përfundimisht...

Tomi - Si? T'i ndreqim? Po përse vallë? A është e mundur? Dhe ç'duhet bërë?

Pistoli - Mjafton të japësh prova se nuk të lidh kurrë asgjë me armiqtë e partisë e të popullit.

Tomi - Çfarë llojë provash?

Pistoli - Ato që do të kërkohen!

-Pauzë-

Tomi - (Befas i zgjuar) Çfarë? Mos kërkon të më rekrutosh?

Pistoli - (Gjakftohët). Ti përdor gjithmonë fjalën më të papërshtatshme. T'i shërbesh popullit tënd, në procesin e luftës së klasave, nuk do të thotë se je i rekrutuar. Njeriu ynë i ri është bërë i vetëdijshëm për detyrën që ka ndaj atdheut.

Tomi - (I nervozuar). Fjalë, fjalë, vetëm fjalë të mëdha! Parulla!

Pistoli - Të cilat unë po bëj sikur nuk i kam dëgjuar! (Pauzë. Stepje). Alma ka të drejtë. Ti shpesh e lëshon gjuhën të kullosë si kalë azat dhe...

Tomi - Për Aronin s'kam për të thënë asgjë. Kurrën e kurrës!

Pistoli - (Pas një çasti që duket sikur mendohet). Ato që i dinë të gjithë edhe mund t'i thuash. Sidomos për atë letrën e ndarjes...

Tomi - Sidomos për atë s'kam për të folur kurrë. Tani jam i bindur

që atë letër doni ta përdorni kundër tij, sepse s'keni asgjë tjetër për ta akuzuar...

Pistoli - Si s'kemi? Po dështimi i pusit? Kërkesat për të vazhduar punimet më tej, për të hedhur lekët e popullit në erë?

Tomi - (I nervozuar). E ke thënë nja tre- katër herë këtë. Unë kam neveri nga këto që po dëgjoj. (Tek dera. Alma)

Pistoli - Do të kërkosh ndihmën e saj? Mirë, kërkoje. Ama ta dish. Ajo nuk është aq e marrë sa të shkatërrojë jetën e saj për hir të të tjerëve.

-Hyn Alma. I vëren të dy-

Alma - Ç'është? Jeni grindur? (Tomi hesht).

Pistoli - Një keqkuptim i vogël.

Tomi - Po më çmend kjo mënyra jote e thjeshtëzimit të gjërave! (Almës). A e di ti ç'kërkon ai prej meje? (Pa pritur përgjigje). Ai kërkon që unë të bëhem spiun!

Pistoli - Spiun! Ah! Fjalë e rëndë dhe demode! Krejt e papërshtatshme. Përkundrazi! Ajo që kërkoi unë prej teje në aspektin moral do të quhej vetëm veprim patriotik. (Alma u afron gotat. Tomi duket sikur refuzon). Pije, pije se nuk të mbyt. (E hedh me fund). Për shëndetin tuaj, për të ardhmen tuaj. (Tomi me po atë ngurrim).

Ama - Pije, Tom! Mos vuaj kaq shumë për të tjerët, i dashur.

Tomi - (E pi). Në djall vafshin të gjitha. (E troket). Për shëndetin tonë! (Si i kujtuar). Ama për Aronin mos më kërkoni asgjë. Ai është një njeri i kulluar, i përsosur.

Pistoli - Vetëm se pak mashtrues dhe hipokrit.

Tomi - S'është aspak e vërtetë.

Pistoli - Ç'kuptim tjetër ka letra e tij?

Tomi - Të thashë dhe po ta përsërit. Ai është nën presionin e rrezikut, është në ankth.

Pistoli - Edhe unë po ua përsëris. Njeriu i pastër s'ka përse të ketë frikë! Alma s'ka frikë. Edhe ti nuk ke frikë. Ne të tre jemi gati t'i nënshtrohemi çdo hetimi për bëmat tona. (Pauzë).

Megjithatë në këtë valle nuk është vetëm Aroni. Madje unë kam një parandjenjë se atë do ta lënë jashtë valles. Është specialist me përvojë, i zgjuar, i talentuar, shkencëtar, kuadër

me vlera të mëdha profesionale. Njerëzve të tillë ju falen disa lajthitje, kur i pranojnë dhe bëjnë autokritikë. Në këtë valle ujçerish janë edhe disa të tjerë që i ti njeh. Eshtë ai drejtori megalloman që kur e pyesnin ku duhet vendosur sondë për shpim, hiqte nga koka kapelën prej kashte, e flakte me forcë dhe thoshte: "Ku të bjerë kjo kapelja ime, aty të vendoset sonda!" Dhe populli priste naftë nga kjo llojë shkence! Eshtë në valle edhe ai kryeinxhinieri që të vret natën e të qan ditën (*fillon të nxehet*). Miu i vrimave! Vemja e ndyrë. Mosmirënjohësi poshtër! Partia e ka ditur me kohë që ai rrjedh nga një familje e dyshimtë, megjithatë i dha shkollë të lartë jashtë shtetit, e specializoi. Dhe ai si ia shpërblen? Duke u bërë agjent i të huajve! (*Pi edhe një gotë, e detyron edhe Tomin*). Pi kushëri i dashur, pi dhe mos u tut fare! S'kanë ç'të na bëjnë, veç të na marrin të keqen! Qentë lehin, karvani shkon përpara! Kala e patundur. Kështjellë e marksizëm-leninizmit. Të pimë nga një për udhëheqësin tonë legjendar, shokun Enver. (*Pinë të dy, Dhe Alma*)... Bravo kushërirë! Ma bëre qejfin mall!

*Tomë
Pistoli*

- (*Që ka filluar të vijë në qejf*). Ajo është bijë Labërie!
- Eshtë bijë Labërie, bijë Shqipërie! (*pauzë*) Vëllazërisht. Tani që ma turbullove pak kokën, po të hapem përtej cakut që më lejon detyra. Shëëësht! (*Luan të pirin*). Nuk i kishe mirë punët, Tom! Hiç mirë. (*Lemza*). Hek! Ç'djall speci qenka ky Alma? Më përvëloi gjoksi. Për shkak të gjuhës së gjatë, e të tjera e të tjera. Po unë ndërhyra drejt e tek zëvendësministri. Tomin ma lini mua, thashë unë. E marr unë përsipër përpunimin. Se... Mos dëgjo ti Alma. (*Ulët*). Në këto punët tona, një cipë qepe të ndan, o andej, o këtej... Më kupton apo jo...

Tomë

- (*Po ashtu pak çakërcejf*) Megjithëse s'të kuptoj hiç fare ... prapë të kuptoj.

Pistoli

- Të lumtë. Kjo është e gjithë filozofia! Të kuptosh pa kuptuar asgjë.

Tomë

- Kur kupton pa kuptuar asgjë, atëherë do të thotë se je de-le?

- Pistoli* - Përparim i hatashëm. (*I hedh krahum mbi sup*).
- Alma* - (*I përfaqon e mallëngjyer*). S'ju gëzohem dot kur ju shoh kështu!
- Pistoli* - (*Këndon*). "Ne në gojë të ujkut hedhim valle / Lum moj Shqipëri që na ke".
- Tom* - (*Krejt çakër qejf*). E mo, lëri këto me gojë egërsira, se do na i nxjerrësh rakinë për hundësh. (*Pi, shikon Almën me përgjërime dhe këndon*). " O moj ti me sy të zi/ Me atë shtatin si selvi/ Nem një gotë që ta pi/ Se po s'erdhe do të vij. (*Qeshin*). Sikur i bëra çorbë vargjet e këngës më duket.
- Alma* - (*I sjell gotën*). Po kështu u dukën më të bukura. (*Afron faqen*).
- Pistoli* - Përpunim i mrekullueshëm. Çift i mrekullueshëm! Jam kot këtu tani. Po ju lë. (*Vete deri tek dalja. Kujtohet*) Ah, po, (*nxjerr nga xhepi një letër*). Firmose këtë Tom!
- Tom* - (*Në përfaqimin e Almës*). Hiqmu sysh. A nuk the se je i tepërt?
- Pistoli* - Unë po, por jo ky dokument!
- Tom* - E ç'është ai dokument!
- Pistoli* - Shpëtimi yt. Këtëj e tutje ty s'guxon të të prekë kurrkush me gishtin e vogël.
- Alma* - Firmose Tom, se ai kur të qepet nuk të ndahet pa ia arritur qëllimit.
- Tom* - (*I përhumbur*). Kur ma thua edhe ti... (*Firmos, Pistoli largohet. Si i zgjuar*) Nuk e kisha menduar kurrë se mund të vinte edhe një çat si ky!
- Alma* - Jeta prandaj është interesante se ka të papritura. Vemi në dhomën e gjumit? Këtu mund të vijmë njerëz.

Tabloja e pestë

Skena paraqet dy vende veprimi. Një cep i barakës së inxhinierëve, tek këndi i tualetit ku bie në sy një tra prej druri, i tavanit. Mjedisi tjetër është i mobiluar si një zyrë hetuesie.

Mëngjes herët. Aroni është duke bërë përgatitje për t'u nisur. Në këte gjendje e gjen Tomi që ka ardhur të fillojë punën. E shohin njëri-tjetrin me një farë habie. Këtë pauzë vrojtimi i pari nuk e përballon Tomi!

Tomi - Qenke kthyer?

Aroni - Jam kthyer edhe një herë!

Tomi - (Konfuz). Të pyeta sepse në telefon më the që do të qëndroje... S'di sa...

Aroni - S'di sa kohë, ky është përcaktimi më i saktë!

Tomi - Oh, prapë me atë gjendje ti? Hiqe mendjen, ty s'kanë për të të prekur asnjë fije floku. Ti je specialist me përvojë. Shkencëtar, kuadër me vlera të mëdha profesionale (Stepet sepse i kujtohet që këto fjalë i ka thënë Pistoli). Ata ... nuk mund të sakrifikojnë një njeri të tillë si ti.

Aroni - Kush ata?

Tomi - Drejtoria e përgjithshme... Dikasteri! Shteti!

Aroni - Partia nuk do të ishte më e plotë? Ajo është në komandë.

Tomi - Partia sigurisht. S'mund t'i bëjë kurban.

Aroni - Qenke i turbullt sot. Paske kaluar një natë të keqe.

Tomi - Të keqe? Jo! Si zakonisht. Isha me Almën. Nuk e di. Tani të gjithë kanë një ngarkesë ankthi që vjen prej tensioneve të ditës. (Si i kujtuar). Si është Aneta, fëmijët?

Aroni - Nuk i kam parë. Kam fjetur në hotel. Besoj se s'janë keq, përndryshe dikush do të më njoftonte.

Tomi - Po si është e mundur? Ti... ende ... nuk...

Aroni - Po. Unë ende nuk kam hequr dorë nga vendimi për ta ndarë. Dhe kur merr një vendim të tillë, gjëja e parë që duhet bërë është të mos bashkëjetosh.

Tomi - Dhe ajo... jot shoqe e ka pranuar një gjë të tillë?

- Aroni* - Aneta është grua e zgjuar.
- Tomi* - Nuk më bëhet ta besoj.
- Aroni* - *(I tregon një dokument)*. Kjo është ftesa e gjyqit për një seancë ballafaqimi. Tentativë pajtimi e quajnë ata. Kur pajtimi nuk arrihet, vazhdojnë me dëshmitarët. Atëherë do të më duhet shumë ndihma jote.
- Tomi* - Nuk do të arrihet deri aty. Do të pajtoheni menjëherë. Do të kuptohet fare qartë se kjo është një lojë dhe atëherë konflikti juaj i shtirur s' do të ketë më kuptim.
- Aroni* - Lojën e dimë vetëm ne të tre: unë, ime shoqe dhe ti.
- Tomi* - *(Pak i nervozuar)*. Nuk e dimë vetëm ne të tre. Mund ta kenë marrë vesh edhe të tjerë.
- Aroni* - *(I habitur)*. Po ti nga e di këtë?
- Tomi* - *(më i nervozuar)*. E di, sepse në këto kohë të tmerrshme, më ka mbetur ende një fije arsytimi i ftohtë. Gabimet e tua, dhe të mijat në daç, janë fare foshnjore. Në vend që të gjesh një mënyrë për t' u takuar fshehur me Anetën dhe për t' ia shpjeguar të gjitha, ti ngrihesh e shkruan një letër dhe për më tepër ia dëgon atë dorazi me një person të fëlliqur. *(Sheh protestat e Aronit)*. Dakord, me një person të pasigurtë, po themi, i cili nuk dihet se ku e ka shpënë letrën tënde më parë. Në grupin e kontrollit në naftë, apo në degën e Punëve të Brendshme...
- Aroni* - Kjo përjashtohet. Aneta e ka marrë letrën, përndryshe nuk do të bënte padinë.
- Tomi* - Mund ta ketë marrë pasi ta kenë lexuar e fotokopjuar të tjerët më parë.
- Aroni* - *(Mendueshëm)*. Po... edhe ky rast nuk përjashtohet *(befas)*. Vetëm teorikisht ama, se Bahiri s' mund të ma bënte mua këtë poshtërsi. E kemi ndihmuar dhe mbrojtur. Ne e njohim atë, apo jo. S' mund të gabojmë kaq shumë në vlerësimet tona
- Tomi* - Mund të gabojmë Aron, dhe mund të gabojmë në një mënyrë kaq të dhimbshme sa të mos na mbetet asgjë tjetër përveç dyshimit të mallkuar për njëri-tjetrin. Ç'të bëjmë pas kësaj? Asgjë, përveç mbylljes në guaskën tonë brenda

vetes, ku s'të përgjon askush përveç ndërgjegjies... (ka rënë në një gjendje të zymtë dhe duket krejt i rrënuar nga dëshpërimi). Aron, ti je një nga njerëzit e paktë fisnikë që kanë mbetur në këtë shoqëri të qelbur ku jetojmë.

Aroni

- Edhe në qofsha i tillë, jam i lumtur që nuk jam i vetëm...

Tomi

- Nëse e hedh fjalën për mua, unë dua të të zhgënjej (Aroni proteston me gisht). Dhe aq më bën nëse s'më beson. Ç'rëndësi ka nëse të beson tjetri kur ti nuk e beson më vetveten? Kur nuk e njuh më? Aron, mos më kërkto të vij për të dëshmuar në gjyqin tuaj. E di, të kam premtuar se do të isha i gatshëm të të ndihmoj, se mund të bëja dëshmi të rremë për hir të shoqërisë tonë, për hir të miqësisë, por... prej asaj dite kanë ndodhur ca gjëra që ti nuk i di dhe që s'ke për t'i mësuar kurrë. Dhe ja unë, shoku yt i vjetër, njeriu të cilin ti e pandeh të çiltër, besnik, fisnik, të ndershëm, po ta them troç se s'jam veçse një hiç! Një plehrë. Një mut.

Aroni

- (E qetëson). Mjaft Tom. E kuptoj se të ka ndodhur diçka me Almën. E marr me mend. Kjo është krejt normale dhe e parashikuar për çifte të reja pak të vonuar si ju.

Tomi

- (Bërtet). Asgjë s'di ti, asgjë (befas). Dëgjo, mund të më pëshytysh para se të ikësh dhe kjo do të më qetësonte më shumë se sa këshillat e tua prej njeriu naiv.

Aroni

- E përse duhet ta bëja këtë?

Tomi

- Përse? Hm... përse pra? (Ngurron). Ja, qoftë edhe për atë që jam burracak dhe nuk guxoj të vij të dëshmoj në një gjyq ku dëshmia e rreme do të zbulohet menjëherë.

Aroni

- A nuk është edhe ky një lloj fiksimi si ai imi? Kjo është një lloj krize e identitetit tonë vëlla, sepse tani ne ndihemi të kërcënuar, në prag të një ndryshimi në jetën tonë dhe kjo na tremb, na bën frikacakë, meqë pas kësaj jeta mund të bëhet më e rëndë, më e padurueshme ndoshta. Por unë të siguroj se kjo krizë është e përkohshme dhe ne të dy do të rigjejmë veten tonë që tani e tutje e quajmë të humbur. Atë vetvete që është e bukur, e pavarur, e panënshtuar. Atë vetvete që të bën të ndihesh krenar, kryengritës, rebel. (Jlët).

Tomi, po ta them ty si njeriut më të afërt e më të besuar që

kam. Unë tani thua jse jam pajtuar me këtë ndryshim që më pret. Me hetuesinë, burgun. Edhe me torturat, nëse ato përdoren. Çdo gjë e pres me qetësi dhe madje, me një farë kureshtje siç presim diçka të panjohur, por edhe i vendosur për ta çuar provën deri në fund. Ne të dy e dimë se ky fat, që na e përcaktojnë të tjerët është pa kuptim, është absurd, sepse ne s'jemi fajtorë për asgjë. Por edhe kundër absurditetit duhet të ngrihesh!

Tomi

- Dhe në emër të kujt duhet bërë tërë kjo sakrificë?

Aroni

- Në emër të kujt? As që e kam menduar!

Tomi

- Në emër të atdheut, të së ardhmës, të brezave që vijnë, të...

Aroni

- Pse duhet menduar vetëm me kategori të tilla të mëdha? Ajo mund të bëhet thjesht vetëm në emër të lirisë tënde si individ, që më në fund të ndjesh se ti je ti dhe askush s'mund të ta japë formën sipas kallëpit që do.

- *Paузë-*

Tomi

- Shko, Aron! Ne të dy bëjmë pjesë në botë të ndryshme.

Aroni

- Ne jemi në të njëjtën botë, miku im. Ke qenë ti njëri nga ata që ke patur ide të tilla heretike për moralin zyrtar. Vërtet ne na ndodh ta humbim herë pas here veten tonë të vërtetë, na ndodh të biem në dëshpërim dhe të shohim çdo gjë pas xhamave të errët të shpresëhumbjes, por kjo s'qo të thotë se e kemi humbur atë përgjithmonë.

Tomi

- Disa e humbin përjetësisht. (*Errësim i plotë. Fokusohet vetëm Tomi, në shtrat. Gjatë këtij episodi dhe atyre që vazhdojnë, ai lë përshtypjen e njeriut të mbërthyer me pranga pas hekurave të shtratit që përpiqet të çlirohet me lëvizje epileptike, pa mundur dot.*)

Episodi i parë

(File Murati, Pistoli, daktilografistja, polici).

- Pistoli* - Më datën 16 qershor të vitit 1972, bashkë me disa inxhinierë, ti je ndodhur në zonën naftëmbajtëse të Zarinës. Eshtë e vërtetë?
- File Murati* - Jam ndodhur në atë zonë aq shpesh, sa në kujtesën time datat kanë humbur kuptimin. Mund të jem ndodhur më 16 qershor, më 10 korrik, apo më 16 tetor.
- Pistoli* - Mua mos më thuaj broçkulla, se lëvizjet e tua ne i kemi ndjekur hap pas hapi. Mos na pandehje qorra? Unë po të flas për një ditë kur bëre një nga ato broçkullat e tua me kapelen.
- File Murati* - Profesionin e zhonglerit të cirkut nuk e di. Mos e ka shënuar dikush gabimisht në dosjen time?
- Pistoli* - Me këtë gjuhë të pëlqen të flasim?
- File Murati* - Sipas vendit dhe kuvendi.
- Pistoli* - Këtu kuvendin e bëj unë.
- File Murati* - Bëjeni.
- Pistoli* - Por ka disa mënyra për ta bërë. I dini?
- File Murati* - Unë di vetëm mënyrat e mia.
- Pistoli* - (Ngrihet e qëllon në zverk nga mbrapa). Qelbësirë. Armik i regjur. Me këtë gjuhë mos guxo të flasësh me mua se të marr shpirtin dhe ta hedh në rrugë që ta hanë qentë. More vesh? (E godet prapë. File Murati bie nga karrigia pa ndjenja. Pistoli i bën shenjë policit, i cili i hedh një kovë ujë. Filja përmendet). Kjo ishte një nga mënyrat e mia, meqë donit ta dinit. Si ju duket?
- File Murati* - (I trulllosur). Njerëzore!
- Pistoli* - E dimë që je shakaxhi i madh, e dimë. Ashtu për shaka e flake edhe kapelen nga maja e kodrës në Zarinë?
- File Murati* - Mbase ma ka marrë era. Aty fryn erë e madhe.
- Pistoli* - Ta paska marrë era? Çfarë deklarove pasi ta mori era?
- File Murati* - Ja, këtë s'e mbaj mend. Mos jam ankuar kundër erës vallë.

- Pistoli* - Jo, ke bërë një deklaratë tekniko - shkencore.
- File Murati* - Në lidhje me korentet e erërave?
- Pistoli* - (*Inxehur, ngrihet*). Në lidhje me vërën e satëme! Mos don të të freskojmë prapë me ujë të ftohtë? Qen bir qeni!. Armik i regjur. Edhe ai tjetri para teje me këtë gjuhë më fliste. Çfarë, mos keni bërë një shkollë? Po, domosdo. Të njëjtën shkollë keni bërë! Atë të spiunave imperialisto-revizionistë! Do t'i kujtoj unë ato metodat drejtuese që zbatonte në naftë koka jote djallëzore. Inxhinierët që kishe me vete atë ditë po diskutonin me shqetësim të sinqertë se ku duhej vendosur sonda e shpimit të thellë që kishte kushtuar miliona dollarë prej djersës së naftëtarëve. prej djersës së popullit. Ty s't'u durua sa ta vendosnin ata, specialistët e vërtetë e të ndershëm. Nxore kapelen e kashtës, e flake dhe the:" E pse grindeni kot? Ku të bjerë kapelja ime, aty të vini piketat!" E vërtetë është kjo?
- File Murati* - Ka disa të vërteta që s'kanë kurrfarë kuptimi.
- Pistoli* - Prapë me sofizma? Ti nuk don të nxjerrësh rrënjët e këtyre veprimeve, por jam unë këtu që t'i nxjerr e t'i shkul përgjithmonë. Shkencë të madhe na bëje zotrote. (*Imiton*) "Ku të bjerë kapelja". Dhe populli priste nga ty!
- File Murati* - (*Këtë herë i vrenjtur, i prekur*). Unë kam një jetë të tërë që punoj në naftë. Kam filluar si ndihmës sondist kur s'më kishte dalë pushi në faqe, kam ndjekur shkollën e natës dy orë larg kantierit, kam gdhirë netë pa fund përmbi libra në universitet, kam bredhur si inxhinier cep më cep në zonat naftëmbajtëse. Kam mohuar qetësinë, familjen, edukimin e fëmijëve dhe ja... tani që s'më ka mbetur asnjë rrënjë floku pa u zbardhë ti kërkon të më mbulosh me baltë, të më damkosësh me turp. Kërkon të më fshish nga faqja e dheut tërë punën time. Jetën time. (*Merr frymë me zor. Pauzë*) Edhe mund ta bësh. Por njerëzit, ata që më njohin, nuk do ta besojnë. Askush nuk do të dalë dëshmitar për të pohuar trillimet e fantazisë suaj.
- Pistoli* - (*Ironik*)- Kaq i bindur je?
- File Murati* - Ndonjë plehrë edhe mund ta gjeni, por njerëz të ndershëm,

kurrë.

Pistoli - Për shembull, inxhinierët Aron Shtuni. Luan Burhani. Afrim Meta. Tomi Vreshtazi... Si i njihni ju? Për të ndershëm?

File Murati - Ata? I njoh fare mirë. Kemi fjetur nëpër baraka ku të hynte acari në palcë, kemi ngrënë bukë të tharë që mezi shpohej me plumb... Ata s'mund të dëshmojnë kundër meje.

Pistoli - Do ta shohim! (*Përplas derën . thërret*) Të vijë dëshmitari.

(*Përsëri zhyten në gjysmë terri dhe ndriçohet shtrati i Tomit me përplasjet e zakonshme. Zëri i tij është tani disi i shuar*).

Tomi - Sigurisht... unë e kuptoj... kjo është çështje politike dhe ideologjike. (*Këputet i dërmuar nga pamundësia për të thyer prangat imagjinare*).

Episodi i dytë

(*Pistoli. polici. daktilografistja, inxhinieri. Afrim Meta*)

Pistoli - Si thua, do të merremi vesh apo jo?

Afrimi - Natyrisht, pse të mos merremi vesh, shoku hetues? Pse të mos?...

Pistoli - Fjalën "shok" këtu ne e lëmë pas derës. E di sepse?

Afrimi - Jo, më falni nuk e di.

Pistoli - Po sepse s'jemi më shokë! Është një hendek i madh që na ndan.

Afrimi - E kuptoj, si urdhëron. Hendeku. Por shpresoj vetëm përkohësisht. Sa të sqarohet keqkuptimi dhe pastaj prapë...

Pistoli - Do Zoti (*Qesh*). Ti i beson Zotit apo s'i beson?

Afrimi - Jo, në asnjë mënyrë; si mund t'i besoj? Unë jam materialist-dialektik. Jam ateist!

Pistoli - Edhe unë s'i besoj, por ja që na shket goja ndonjëherë. Ndodh, apo jo?

Afrimi - Ndodh, ndodh...

Pistoli - Ty të ka shkarë goja ndonjëherë?

- Afrimi* - S'di. Edhe mundet, por sigurisht pa dashur. Del gjuha para mendjes.
- Pistoli* - Këtë e the mirë. Kjo më jep shpresë se do merremi vesh.
- Afrimi* - Pse të mos merremi? Qëllimi ynë është i përbashkët...
- Pistoli* - Atëherë të hyjmë drejt e në thela. Më 12 maj 1971 në zonën naftëmbajtëse ku ishe ti erdhi një grup ekspertësh i huaj dhe u takua me ju. E mban mend?
- Afrimi* - Si jo? Ishin rumunë. Ne do të blinim prej tyre disa sonda për shpime të thella.
- Pistoli* - Ti ke studjuar në Rumani. E njihje ndonjërin prej tyre?
- Afrimi* - Ishin në përgjithësi moshë e re.
- Pistoli* - Njëri prej tyre nuk ishte dhe aq i ri, ndonëse dukej i ri sepse mbahej mirë...
- Afrimi* - Mundet, nuk e kundërshtoj.
- Pistoli* - Ju të dy rrinit karshi njëri-tjetrit dhe buzëqeshnit. Ky është një fakt, apo jo?
- Afrimi* - (I hutuar). Fakt?
- Pistoli* - Ky fakt për ty do të thotë gjëkafshë, apo as gjëkafshë?
- Afrimi* - (Edhe më i hutuar) Thotë gjëkafshë, s'thotë gjëkafshë...
- S'di* ç'të them.
- Pistoli* - Të vrasësh mendjen, pse të buzëqeshi ty përshembull, jo atij tjetrit?
- Afrimi* - Vërtet, pse të më buzëqeshi mua?
- Pistoli* - Sepse diçka ka parë tek ti. Ka gjetur terren. Ose të ka njohur. Mos keni qenë bashkë në një shkollë dhe ti s'e mbaje mend?
- Afrimi* - Në shkollë?
- Pistoli* - E de, në shkollë. Ti ke mbaruar në Ploesht të Rumanisë.
- Afrimi* - Por, nëse duhet... unë jam gati të kem qenë në shkollë me të...
- Pistoli* - Ja sa mirë kur merremi vesh. Atëherë ti ke mbaruar studimet në një vit me atë inxhinierin... Si quhet (*shfleton disa letra*). Liviu Grigoresku quhet?
- Afrimi* - Liviu Grigoresku, po !
- Pistoli* - Ky Grigoresku të kërkon ty si shok që t'i rezervoje një takim kokë më kokë me drejtorin e përgjithshëm File Murati

dhe ti t'i shërbeje si përkthyes.

Afrimi

- Si urdhëroni.

Pistoli

- Takimi u bë. Rumuni i propozoi Files , kundrejt një shpërblymje të majmë, prej të cilit edhe ti more diçka (*Një gjest proteste i Afrimit*), jo shumë, pako gjë, sepse ti ishe një peshk i vogël në këtë histori, pra i propozoi që Filja të pranonte çmimin e palës rumune për sondat, i cili ishte mjaft i lartë. Shteti ynë mund të blinte të njëjtat sonda në vendet arabe me një çmim 30 % më të ulët.

Afrimi

- Por... s'di, më duket se...

Pistoli

- Fillove tani? Hiç mos të të duket.

Afrimi

- Jo, s'di nëse do të besohet, nëse do të vlejë si dëshmi. Sepse kur janë vetëm dy veta, bie poshtë kollaj.

Pistoli

- Ne do të sjellim edhe një të tretë. Ai është shoku i tij, inxhinier si ti. Ty të mundonte ndërgjegjia ato kohë për këtë veprim, të kishte hyrë frika dhe kërkove prej tij një këshillë... Ai të tha miqësisht që të heshtje, sepse kjo punë mund të mbaronte më keq.

Afrimi

- Cili është ai?

Pistoli

- Unë do të ta sjell atë tani. Ai pret prapa derës. Të dy bashkë, pastaj do ta vini me shpatulla mbas murit atë armikun e popullit, File Muratin.

Afrimi

- Dhe unë do të lirohem ? Apo jo shoku Pistol?

Pistoli

- Prapë "shoku Pistol" (*përplas duart, thërret*). Të vijë dëshmitari... (*Errësim. Po ajo mizanskenë, por tani përpyekjet e Tomit janë më të ngathta, gati epileptike dhe fjalët e tij janë më të copëtuara*).

Tomit

- Ideologjike... Karakteri... Politika! Çështje karakteri ideopolitik.

Episodi i tretë

(Pistoli me parukë gruaje. daktilografistja. Polici mungon. Aroni dhe e shoqja.)

- Pistoli* - Kjo është një seancë ballafaqimi, në bazë të kodit të procedurës civile. Ju sa kohë keni që nuk bashkëjetoni?
Heshtje
- Pistoli* - Do të përgjigjet ndonjëri apo si?
Aneta - Ai.. ai ka disa muaj që s'ka qenë në shtëpi.
Pistoli - Sa?
Aroni - Katër.
Pistoli - Nuk të pyeta ty...
Aneta - Katër... mund të jetë katër.
Pistoli - Pse ka munguar kaq gjatë? Si e ka shpjeguar?
Aneta - Puna... mundet.
Aroni - Arsyet janë të tjera dhe ajo i di.
Pistoli - Mos ndërhy më, përndryshe të nxora jashtë.
Aroni - Kam të drejtën time. Ajo mund të japë përgjigje që nuk mund të përputhen me të vërtetën.
Pistoli - Dhe cila është e vërteta? Se kjo e vërteta juaj mban pak erë.. (*Heshtje, i drejtohet Anetës*). Fol ti.
Aneta - Ç'të them tjetër? I kam shkrojtur në letër. Në akt padi. Të gjitha.
Pistoli - Unë dua t'i përsërisësh akuzat në praninë e tij.
Aneta - Po ja... Tradhtia bashkëshortore.Nuk mjafton?
Pistoli - Çfarë faktesh ke? E ke kapur në flagrancë? Vetë apo të tjerë?
Aneta - Jo, jo . (*Pas shikimit të rreptë të Aronit*). Por kam dëgjuar shumë thashetheme.. Jo thashetheme, po fjalë. Pastaj edhe ftohja e tij prej shtëpisë...
Aroni - Çfarë fakte të tjera duhen, kur unë ia kam pohuar vetë se dua një tjetër?
Pistoli - Një tjetër! Një femër që me gjithë përpjekjet tona po na

mbetet e panjohur. Pa fytyrë, pa emër... Një fantazmë.

Pauzë

Aroni - Ajo më gjeti një letër në xhep.

Pistoli - Ah, ashtu? Ky qenka një fakt i ri (Netës). Ma jep atë letër?

Aneta - Letrën? (*E hutuar*). Por... unë... nuk e kam...

Pistoli - E ke në shtëpi?

Aneta shikon Aronin si për ndihmë:

Aroni - Ajo e grisi në sytë e mi.

Pistoli - (*Ironik*) Nga xhelozia e madhe! Shiko, shiko...

Aneta - (*Më e vendosur*). E grisa vërtet...

Pistoli - E besoj. Dhe copat e saj i hodhe në nevojtoje. (*Ngrihet*). E di ç'keni ju. Mos na hani kohën kot se nuk kemi kohë të merremi me budallallëqet tuaja... Kjo që po bëni është një komedi e dobët, e dinë të gjithë. Jeni bërë për t'u mëshiruar (*Gruas*). Ti s'ke ndonjë faj, e keqja jote është se i bindesh atij verbërisht. (*Aronit*). Kurse ti... (*befas*) Çështja juaj do të mbyllet.

Aroni - (*E ndërpret*). Zonja gjyqtare, ju s'keni të drejtë të ndërprisni gjykimin. Seancën për pajtim e bëtë, nuk arritët të na bindnit për të bashkëjetuar... Fundja, nëse duhet ne mund të sjellim edhe dëshmitarë...

- *Pistoli e heq paruken. Është ai i zakonshmi-*

Pistoli - (*Gruas*). Ju, dilni jashtë. (*Aronit*). Ti, ulu aty. Ulu! Kërkove dëshmitarë, do të ti sjellim edhe ata mos u bëj merak. Por do të ti sjellim që të dëshmojnë për disa gjëra më të rëndësishme.

Pauzë

Pistoli - Më 24 tetor të këtij viti, në një mjedis familjar ju keni thënë se makina e shtetit tonë ka mbetur në baltë. E pranoni këte?

Aroni - E mohoj kryekëput!

Pistoli - Aty kam qenë i pranishëm edhe unë, por meqë detyra nuk më lejon të vihem në pozitën e dëshmitarit, do t'jua provoj me dëshmitarë të tjerë.

Aroni - Ato fjalë i thatë ju vetë dhe tani doni të m'i vishni mua. Edhe unë kam dëshmitarë.

Pistoli - E prisja një kundërshtim të tillë. Ju jeni një burrë inteligjent, i cili e kupton fare mirë se këto janë fjalë të rrezikshme, ar-

miqësore. Janë apo s'janë të tilla?

Aroni
Pistoli

- Meqë e thoni ju...

- Që të bindesh përfundimisht sa gabim ke bërë, unë do të ballafaqoj tani me dëshmitarin kryesor i cili gjithashtu i ka bërë disa gabime, por ka patur sinqeritetin e duhur që t'i pranojë. Sepse ai është patriot i vërtetë, e kupton se këto gjëra kanë karakter ideologjik dhe politik, ashtu siç shpresoj se do ti kuptosh edhe ti vetë.

Të vijë dëshmitari!

(Errësiirë. Tomi vazhdon përpëlitjet, fjalët e copëtuara. "Po, kanë karakter ideologjik dhe politik..." Ndrriçohet skena)-

Pistoli

- Pas kësaj mund të ikësh.

Aroni

- Ku?

Pistoli

- Ku të doni. Ikni dhe mendohuni. Ku ta dish, partia mund të të japë dorën. Ajo është e gjerë, e dhimbshur si nënë e mirë. Do t'ia lash me punë.

Aroni

- *(Edhe më i hutuar)*. Po gruan? Si?

Pistoli

- *(Cinik)*. Gjeje ndonjë mënyrë tjetër për t'ia larë fajin. Ha, ha, ha... *(Aroni del. I drejtohet Tomit)*. Njerëzit që vuajnë, punojnë më mirë, janë më të bindur.

Njeriu duhet të vuajë, se po qe shumë i kënaqur, bëhet rebel. Më të vështirët nga të gjithë, janë njerëzit e lumtur. Ata nuk pranojnë ta humbasin lumturinë e tyre dhe bëhen të panënshtueshëm... *(shikon përpëlitjet e Tomit)* Mos u përpëlit më kot. Tomi, ti hyre në radhët tona dhe kjo do të thotë se këtej e tutje ke të drejtë të vendosësh për fatin e të tjerëve. Do të ndihesh i fortë, i fuqishëm, zot i të tjerëve... dhe zoti.. i vetes!

Tomi

- *(Si me vete)* Zot i vetes? Zot i vetes? *(Pistoli është zhdukur. Tomi çohet, vjen rotull si somnambul)*. Unë, Tom Vreshtazi, tani qenkam zot i vetes dhe i të tjerëve *(fillon e heq teshat)*. Unë jam i fortë. Jam i pushtetshëm! I plotfuqishëm *(Bën lëvizje gjimnastikore që imitojnë goditje me grusht)*. Dridhuni armiq, ku do të futeni ju tradhtarë të poshtër? Ha, ha, ha...! *(Ka hequr edhe rripin e pantallonave. E mban në dorë, e shikon me sy të zgurdulluar)*. Po ti ç'je? *(E vërtit si kamzhik)*. A, qenke një

rryp. Rryp apo kamzhik? E përse shërben ti more send i mjerë? Për të mbajtur pantallonat që të mos bien dhe të të zbulojnë organet e turpshme? Punë të madhe na bëmë!

(Ulet tek tryeza. Shkruan me rrëmbim. E vë letrën në një vend të dukshëm. Pastaj hyn tek aneksi me perde. gjithnjë me ripin në dorë. Drejt spektatorëve në krizë të plote).

Qetësi! Shëët! Qetësi po ju them. Unë do t'ju tregoj se ky send nuk shërben vetëm për të mbajtur pantallonat. Unë mund ta bëj këtë, sepse tani unë jam zot i vetes!

(Mbyll perden. Errësohet. Muzikë e rëndë. klithëse. Kur ndizen dritat, s'duket asgjë. Ka hyrë Aroni. Ai e merr letrën me një farë shpërfillje, pastaj e lexon me zë të lartë).

Aroni - "Aron. Nëse nuk më pështyve dot sa isha gjallë, ki mëshirë dhe mos më pështy tani që jam në një botë tjetër. S'mund të bëja ndryshe..."

(Aroni hap perden me rrëmbim. Duket trupi i Tomit i varur tek litari. Ai e mbyll prapë. Zë sytë me duar. Bie në gjuhë. Bërtet).

O Zot! Ç'të kemi bërë që na dënon kështu? Ç'të kemi bërë, ç'të kemi bërë që na dënon kështu?

Fund